



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opština Rahovac/Municipality of Rahovec



01 Nr. 01/23

Rahovec, 19.01.2023

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen e parë (1) e cila do të mbahet më **30 janar 2023 (e hënë)**, me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për Transparencë Komunale 2023-2027;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Komunal të Veprimit për të Zhvendosurit dhe Zgjidhje të Qëndrueshme në Komunën e Rahovecit;
5. Shqyrtimi Raportit Financiar për vitin 2022;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim-ndryshimit të Rregullores për Taksa Komunale 01 Nr.80/20 të datës 28.06.2020, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren 01 Nr. 169/21 të datës 26.02.2021;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-01240-0 në zonën kadastrale Retijë;
8. Shqyrtimi i Raporti për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm sipas Planit të Veprimit për vitin 2022;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-05864-0;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-07111-1;
11. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës – P-00251-0;
12. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-03710-0;
13. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-03818-0 dhe P-03819-0;
14. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-02352-0;
15. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Kuvendit për vitin 2022;
16. Shqyrtimi i Raportit të Punës të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2022;
17. Shqyrtimi i Informatës rreth aktiviteteve të KKSB-së për vitin 2022;
18. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2022;
19. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Komitetit për Shëndetësi dhe Përkrahje Sociale për vitin 2022;
20. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Komitetit për Arsimit për vitin 2022;


KRYESITSI I KUVENDIT

Delirim Kafexhiu



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Predsednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRIZEDNIKU OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No. 32 Nr. i faq./Br.str./No.pg. 98
Data/Datum/Date 11 / 1 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës:

PROPOZON

1. Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit që të merret vendim për miratimin e Planit komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme në Komunën e Rahovecit 2023-2025.
2. Pjesë përbërëse e këtij propozimi është Plani komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme në Komunën e Rahovecit 2023-2025.
3. Për zbatimin e këtij propozimi do të kujdeset Zyra Komunale për Kthim dhe Komunitete në Komunën e Rahovecit.
4. Propozimi hyn në fuqi pas miratimit paraprak nga Kuvendi i Komunës.

Me propozim të njoftohen:

- Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,
- Sekretaria e Kuvendit, dhe
- Arkivi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC



KABINETI I Kryetarit të Komunës / OPŠTINSKO / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 15 Nr. i faq./Br.str./No.pg 96

Data/Datum/Date 6 / 1 / 23

RAHOVEC / ORAHOVAC



PLANI KOMUNAL I VEPRIMIT PËR TË ZHVENDOSURIT DHE ZGJIDHJE TË QËNDRUESHME

KOMUNA E RAHOVECIT

ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE
DHE KTHIM

2023-2025

PARATHËNJE

Plani Komunal për Veprim (PKV), konfirmon përkushtimin dhe vullnetin politik të Komunës së Rahovecit për ofrimin e mjedisit të sigurt dhe mundësinë e kthimit të të gjithë qytetarëve, të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës, pa dallim etnie, feje apo përkatësie politike. Konsideratë e veçantë do t'i kushtohet integritetit socio-ekonomik gjatë hartimit të planit të veprimit i cili do t'i përgjigjet aftësive aktuale të familjeve të kthyer në mënyrë që të sigurohet zgjidhja e qëndrueshme e të kthyerve.

ARSYESHMËRIA E PLANIT KOMUNAL TË VEPRIMIT (PKV)

Ky plan veprimi ka për qëllim ta ndihmojë Komunën në përmbushjen e obligimeve të veta në lidhje me procesin e kthimit dhe të ri-integritetit në bazë të Rregullores (QRK) – Nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme dhe Rregullores nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim, në bazë të kërkesës për asistencë për kthim vullnetarë nga personat e zhvendosur dhe vlerësimit të nevojave specifike sipas sistemit të menaxhimit të të dhënave.

1. HYRJE

Institucionet e Kosovës kanë detyrim kushtetues për të krijuar kushtet dhe për të siguruar mjetet e nevojshme për personat e zhvendosur që të kthehen në shtëpitë e tyre në mënyrë të sigurt dhe me dinjitet. I tërë ky proces kërkon bashkëpunim dhe koordinim me institucionet përkatëse që mund të kontribuojnë në suksesin e procesit të kthimit dhe stabilizimit të komuniteteve.

PKV përcakton aktivitetet për kthim të qëndrueshëm dhe zhvillimin e të gjitha komuniteteve, i cili ka ndikim në të gjitha aspektet e jetës (ekonomike, shoqërore dhe institucionale) në të gjitha nivelet.

Në mënyrë që të sigurohet zbatimi i PKV-së, Komuna zotohet që ky plan do të jetë në përputhshmëri të plotë me strategjitë dhe planet tjera zhvillimore komunale, si dhe do të planifikoj dhe ndaj fondet në bazë të kërkesave dhe nevojave të qytetarëve të vet, dhe do të kërkoj fonde në bashkërendim me akterët tjerë për realizimin e këtij plani.

2. KORNIZA LIGJORE

Korniza ligjore e Kosovës riafirmon të drejtën për kthim në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe përvijon garanci gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të komuniteteve. Plani komunal i veprimit bazohet në nenin 156 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës¹ dhe është në pajtim me Ligjin nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë², Rregulloren (QRK) – Nr. 01/2018 për kthimin e personave të

¹ Kushtetuta e Kosovës, Neni 156; <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republike.së.Kosoves.pdf>
² <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2531>

² <http://mzp-rks.org/al/dokumentet/rregullor-p%C3%ABr-kthimin.html>

² Rregullorja e Qeverisë Nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Kthim dhe Komunitete - http://www.kryeministri-ks.net/zck/repository/docs/01_Rreguloreja_Nr.02-2010-alb-eng-ser.pdf

² Rregullorja e Qeverisë Nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Kthim dhe Komunitete - http://www.kryeministri-ks.net/zck/repository/docs/01_Rreguloreja_Nr.02-2010-alb-eng-ser.pdf

zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme³, Rregulloren nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim⁴.

³ <http://mzp-rks.org/al/dokumentet/rregullor-p%C3%ABr-kthimin.html>

⁴ Rregullorja e Qeverisë Nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Kthim dhe Komunitete - http://www.kryeministri-ks.net/zck/repository/docs/01_Rreguloreja_Nr.02-2010-alb-eng-ser.pdf

3. OBJEKTIVAT DHE FUSHËVEPRIMI

Objektivat e identifikuar në këtë dokument, janë zhvilluar në aktivitete konkrete në PKV, në mënyrë që t'i mbulojnë të gjitha fushat e veprimit të Komunës së Rahovecit me qëllim që të adresohen nevojat e të zhvendosurve kosovar të interesuar për kthim në komunën e Rahovecit. Komuna e Rahovecit synon kthimin e qëndrueshëm dhe stabilizimin e komuniteteve, prandaj objektivat e mëposhtme në mënyrë konkrete kontribuojnë në realizimin e këtij synimi:

1. Kthimi i qëndrueshëm i personave të zhvendosur brenda vendit dhe personave të zhvendosur në Serbi dhe Maqedoni;

1.1 Mbështetja e të gjithë personave të interesuar për kthim;

1.2 Menaxhimi i të dhënave në bashkëpunim me MKK-në;

1.3. Ofrimi i strehimit dhe asistencës socio-ekonomike për familjet e zhvendosura sipas kriterëve dhe cënueshmërisë;

1.4 Forcimi i mekanizmave ekzistues të informimit për kushtet dhe kriteret e kthimit, si dhe për të drejtat dhe detyrimet e komuniteteve;

1.5 Dialog ndëretnik në mes të personave të zhvendosur dhe komunitetit pranues, sipas nevojës;

2. Integrimi socio-ekonomik;

2.1 Mbështetja për integrim ekonomik në bazë të vlerësimit të nevojave për jetesë dhe mirëqenie socio-ekonomike në bazë të kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes për asistencë, të përcaktuara me rregullore;

2.2 Krijimi dhe mbështetja e projekteve zhvillimore ekonomike të bazuara në komunitete;

2.3 Monitorimi dhe raportimi

3. Fuqizimi i kapaciteteve komunale për kthim dhe ri-integrim;

4. PASQYRA KOMUNALE

4.1 INFORMATA TË PËRGJITHSHME DHE TË DHËNA DEMOGRAFIKE

Komuna e Rahovecit bënë pjesë në grupin e qyteteve të lashta të Kosovës. Territori i komunës së Rahovecit përfshihet në regjionin e Gjakovës dhe ka një pozitë të mirë gjeografike.

Komuna e Rahovecit, shtrihet në pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik dhe i takon Evropës juglindore. Ky territor përfshin pjesën qendrore dhe jugore të rrafshit të Dukagjinit dhe është i ndarë në tri tërësi ose mikro regjione. E këto janë: rrafshi-luginor, kodrinor dhe malor. Në Veri kufizohet me Komunën e Klinës me distance rreth 45 km, në Verilindje me Komunën e Malishevës rreth 16 km, në Juglindje me komunën e Suharekës rreth 17 km dhe atë të Mamushës, në jug me Komunën e Prizrenit 25 km, dhe në perëndim me komunën e Gjakovës 28 km dhe në largësi nga kryeqendra e Kosovës (Prishtina)



rreth 60 km. Në këtë komunë janë dy zona që kanë karakter të veçantë të mbrojtjes : 1. Manastiri i Zogishtës, dhe 2. Fshati Hoqë e Madhe.

Para konfliktit të vitit 1999, në këtë komunë kanë jetuar një numër më i madh i komuniteteve jo shumicë se sa statistikave aktuale, ku një pjesë e tyre ende mbeten të zhvendosur në Serbi dhe Maqedoni.

Në bazë të regjistrimit të popullsisë nga ana e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) të kryer më 2011, popullsia totale është 56,208⁵.

Popullsia në Komunën e Rahovecit	Gjithsej	Përkatësia etnike									
		Shqiptar	Serb	Turk	Boshnjak	Rom	Ashkali	Egjiptian	Te tjerë	Preferoj të mos përmendjen	Te dhënat nuk janë në dispozicion
Total	56,208	55,166	134	2	10	84	404	299	11	98	0

Tabela 1: Popullsia në komunën e Rahovecit sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës 2011.

4.2 EDUKIMI

Struktura organizative e sistemit arsimor në Komunën e Rahovecit është e organizuar në katër nivele: arsimin parashkollor (fëmijët e moshës 5 - 6 vjeçar), arsimin fillor (klasat I – V), arsimin e mesëm të ulët (klasat VI – IX) dhe arsimin e mesëm të lartë (klasat X – XII/XIII).

Numri i objekteve shkollore është gjithsejtë 42, duke përfshirë edhe çerdhet dhe shkollat e mesme. Në procesin edukativo-arsimor në të gjitha nivelet e shkollimit janë të angazhuar rreth 845 punëtorë, prej të cilëve janë 694 mësime dhënë. Numri i nxënësve është gjithsej 8106

4.3 EKONOMIA DHE MIRËQENIA SOCIALE

Komuna e Rahovecit me tërë historinë e pasur në prodhim të verës dhe token pjellore ka potenciale të mëdha për zhvillim në të ardhmen. Zhvillimi ekonomik në komunën e Rahovecit është i orientuar më së shumti në bujqësi, vreshtari dhe perimtarë. Afro 65% e popullatës është vlerësuar se sigurojnë ekzistencën nga aktivitetet bujqësore. Mesatarja vjetore e të ardhurave për një fermer është përafërsisht 2,500 deri 3,000 €. Komuna e Rahovecit disponon me rreth 50 % të sipërfaqeve të vreshtave të Kosovës si dhe kapaciteteve përpunuese.

4.4 SHËNDETËSIA

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DSHMS-ja) ka dy sektor:

- Sektorin për Shëndetësi dhe
- Sektorin për Mirëqenie Sociale

Komuna e Rahovecit përkatësisht Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale –DSHMS, në Sektorin e Shëndetësisë ka për qëllim të sigurojë dhe zhvillojë sistemin e ofrimit të mbrojtjes parësore shëndetësore sa më kualitative, duke u bazuar në nevojat e popullatës në tërë territorin e komunës sonë.

Institucionet shëndetësore publike në komunën tonë:

⁵ Agjencia e Statistikave të Kosovës Regjistrimi i popullsisë më 2011 | <https://ask.rks.gov.net/rekos-2011>

- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (1-QKMF në qytetin e Rahovecit)
- Qendrat e Mjekësisë Familjare (gjithsej 6-QMF)
- Ambulancat e Mjekësisë Familjare (gjithsej 7-AMF, prej te cilave 1 AMF është në fshatin Hoqë e Madhe dhe 1 AMF është në Lagjen e Epërme në Rahovec) .

5. INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR PERSONAT E ZHVENDOSUR

Komuna e Rahovecit ende vazhdon të ketë persona të zhvendosur përbrenda Kosovës dhe jashtë saj (Serbi dhe Maqedoni) si pasojë e konfliktit të vitit 1999.

Nga numri total (45) i kërkesave të paraqitura që nga viti 2009 që ka në posedim ZKKK-ja (40 Serb dhe 4 Roma, 1 Ashkali) janë të aprovuara nga ana e Komisionit Komunal për Kthim dhe Komisioni Qendror për Rishikim në MKK.

Ndërsa, 10 kërkesat e mbetura janë në proces të shqyrtimit/aprovimit/pritje nga ana e Komisionit Komunal për Kthim (KKK) dhe Komisionit Qendror për Rishikim, të cilat do të reflektohen në PKV për këtë periudhë të planifikimit. Për më tepër komuna do të vazhdojë të procedojë të gjitha aplikacionet që mund të paraqiten tek zyra e ZKKK-së të cilat do të shqyrtohen në vazhdimësi nga mekanizmat lokal dhe ato të nivelit qendror sipas legjislacionit në fuqi.

Që nga viti 2009 deri tani në komunën e Rahovecit janë regjistruar si të kthyer 45 familje me 111⁶ individ.




Tabela 2: Numri i familjeve/individëve të kthyer në komunën e Rahovecit.

6. NEVOJAT DHE SFIDAT E IDENTIFIKUARA

Sfidat me të cilat përballen të kthyerit janë të natyrës së përgjithshme, për të gjitha komunitetet duke përfshirë edhe komunitetin shumicë, si në sferën e punësimit, zhvillimit ekonomik, bujqësisë, çështjet e ndihmës sociale, etj.

Megjithatë, ka edhe nevoja që janë të veçanta për PZH-të dhe të kthyerit, si në vijim: nevoja për krijimin e një sistemi të të dhënave me qëllim të planifikimit dhe përkrahjes adekuate në komunën e Rahovecit si dhe në rajon: në Serbi dhe Maqedoni; nevoja e të dhënave të sakta për PZh-të në Kosovë; fonde për asistencë gjatë procesit të kthimit; nevoja për vlerësim adekuat të fizibilitetit të projekteve për krijimin e të ardhurave; nevoja për zhvillim më të madh ekonomik dhe të mirëqenies sociale; nevojë për infrastrukturë adekuate publike në zonat e largëta rurale; nevojë për përkrahje të mjaftueshme për grupet e cënueshme të të kthyerve: të rinjtë, gratë, personat me aftësi të kufizuara;

⁶Shënime të prezantuara/ofruara nga UNHCR

nevoja për ndarje të tokës; lirimi i pronave të uzurpuara; fuqizimi i marrëdhënieve tregtare mes komuniteteve dhe bizneseve, pra kushtet të cilat mundësojnë një kthim të qëndrueshëm.

7. ZGJIDHJET E MUNDSHME

Për realizimin e suksesshëm të procesit të kthimit, nevojitet një menaxhim i të dhënave konkrete të të zhvendosurve si dhe një planifikim për mbështetje adekuate në planifikimin e nevojave financiare të aktiviteteve të kthimit (mundësia e përfshirjes së Komunës me projekte të vogla të cilat mund t'i bashkë-financoj me MKK-në dhe donatorë të mundshëm). Konkretisht, komuna do të lehtësoj procedurat dhe ofroj mundësitë për kyçe në shërbime publike, qasje në dokumente personale, arsim, shëndetësi etj.; mbështetja e nismave për bashkëveprim ndëretnik; krijimi i kushteve të favorshme për zhvillim ekonomik dhe punësim të barabartë për të gjithë qytetarët e saj; rritja e fondeve për grupet e cenueshme; forcimi i koordinimit në mes të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, veçanërisht në lidhje me zbatimin e projekteve për të zhvendosurit dhe të kthyerit në fushën e arsimit, shëndetësisë, infrastrukturës, bujqësisë, pronës, punësimit dhe mirëqenies, dhe sipërmarrjeve të reja.

8. INTEGRIMI SOCIO-EKONOMIK – KUSHTET JETËSORE

Segmentet ekonomike më të zhvilluara në komunën e Rahovecit janë bujqësia, vreshtaria, blegtoria, industria, hoteleria dhe turizmi.

Mbështetja për integrimin ekonomik do të sigurohet në bazë të vlerësimit të nevojave të kategorive të të kthyerve bazuar në Rregulloren për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme e cila i përgjigjet nevojave dhe aftësive aktuale të familjeve të kthyer dhe adresimin e tyre përmes programeve të integrimit socio-ekonomik. Mbështetja socio-ekonomike duhet të përqendrohet në krijimin dhe fuqizimin e bizneseve të vogla dhe të mesme të bazuara në komunitet si dhe rrjetëzimin e tyre me tregun aktual biznesor.

Për më tepër segmentet ekonomike më të zhvilluara në komunë do të jenë fokus në aftësimin profesional të të kthyerve, me qëllim të përgatitjes për tregun e punës.

9. AKTERET

Në nivel lokal bashkërendimi i aktiviteteve do të udhëhiqet nga ZKKK-ja dhe do të përfshijë një bashkëpunim të ngushtë me departamentet përkatëse siç janë: Arsimi, Shëndetësia, Puna dhe Mirëqenia Sociale, Shërbimet publike, Planifikimi dhe urbanizmi, Gjeodezisë, Kadastrës dhe Pronës dhe departamentet tjera relevante të cilat janë të përfaqësuara në Komisionin Komunal për Kthim (KKK). Në nivel qendror, komuna do të bashkëpunojë ngushtë me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, si institucion përgjegjës për procesin e kthimit dhe të drejtave të komuniteteve, Zyrën për Çështje të Komuniteteve pranë zyrës së Kryeministrit si dhe ministritë tjera relevante.

Komuna gjithashtu do të bashkëpunojë ngushtë me të gjitha organizatat vendore dhe ndërkombëtare që punojnë në fushën e të drejtave të komuniteteve, kthimit, dhe ri-integrimit, si dhe me donatorët e mundshëm.

10. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Kryetari i Komunës e përcakton një komision monitorues, raportues dhe rekomandues prej tre (3) anëtarësh, që do të përcjell procesin e implementimit të PKV-së në mënyrë efektive përmes vlerësimeve periodike (6 mujore). Komisioni do të bashkëpunojë ngushtë gjatë monitorimit dhe vlerësimit edhe me OJQ-të, respektivisht shoqërinë civile.

ZKKK-ja mbikëqyrë dhe raporton për progresin e arritur në fushën e të drejtave të komuniteteve, qasjes së tyre të barabartë në shërbimet komunale, kthim dhe ri-integrim, sipas Rregullores për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim.

ZKKK-ja duhet të raportojë në baza të rregullta vjetore për çështjet e kthimit dhe ri-integrimit të personave të zhvendosur tek MKK-ja.

ZKKK-ja do të shërbejë si Sekretariat për zbatimin e këtij Plani.

PLANI I VEPRIMIT KOMUNAL - RAHOVËC

Aktiviteti	Arritshmëria	Autoritetet përgjegjëse	Korniza kohore	Kushtueshmëria dhe burimi i fondeve	Dokumentet Referente
Objektiva 1: Kthimi i qëndrueshëm i personave të zhvendosur brenda vendit dhe personave të zhvendosur në Serbi, Mal të Zi dhe Maqedoni					
<i>Nën objektivi 1.1: Mbështetja e të gjithë personave të interesuar për kthim</i>					
1.1.1 Vlerësimi dhe rekomandimi i aplikacioneve për asistencë të personave të interesuar për kthim	Të gjitha rastet e paraqitura pranë komisionit	MKK/ZKKK-ja dhe KKK-ja dhe në cilësi të vëzhguesit: shoqëria civile dhe UNHCR.	2022-2025	MKK, Komuna,	Rregullorja nr.02/2010 për ZKKK; Rregullorja (QRK) – NR. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme; Udhëzues për zbatimin e Rregullores (QRK) – nr. 01/2018.
1.1.2 Ndihma në rregullimin e dokumenteve personale dhe të pronës për të zhvendosurit dhe komunitetet;	Të gjitha rastet që kanë nevojë për trajtim	ZKKK/Drejtorja e Administratës/Agjencioni për Regjistrim Civil/Drejtorja për çështje pronësore dhe kadastrës/MKK	2022-2025	Komuna dhe MKK/Donatorët potencial	Rregullorja nr.02/2010 për ZKKK; Rregullorja (QRK) – NR. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme; Udhëzues për zbatimin e Rregullores (QRK) – nr. 01/2018.
<i>Nën objektivi 1.2: Menaxhimi i të dhënave në bashkëpunim me MKK-në;</i>					
1.2 Menaxhimi i bazës së të dhënave për të zhvendosurit	Azhurimi me kohë i të dhënave që do të shërbejnë si mjet për monitorim dhe vlerësim të rasteve.	MKK/ZKKK	2022-2025	Komuna dhe MKK/Donatorët potencial	Rregullorja nr.02/2010 për ZKKK; Rregullorja (QRK) – NR. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme; Udhëzues për zbatimin e Rregullores (QRK) – nr. 01/2018.
<i>Nën objektivi 1.3: Ofrimi i strehimit dhe asistencës socio-ekonomike për familjet e zhvendosura;</i>					
1.3.1 Përkrahja në: strehim dhe banim	10 familje që i plotësojnë kriteret	ZKKK/MKK	2022-2025	Burimi i fondeve: MKK, dhe donatorët potencial	Rregullorja nr.02/2010 për ZKKK; Rregullorja (QRK) – NR. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme; Udhëzues për zbatimin e Rregullores (QRK) – nr. 01/2018.

1.3.2 Ndihmat në ushqim, dhe artikuj jo ushqimor, mobile	10 familje që i plotësojnë kriteret për ushqim dhe artikuj jo ushqimor	ZKKK/MKK	2022-2025	MKK/Komuna dhe donatorët potencial	
1.3.2 Identifikimi i projekteve për koordinim me donator vendor dhe ndërkombëtarë	10 familje për mobile 1 donator potencial i identifikuar 1 projekt i zhvilluar dhe realizuar	Komuna, MKK-EU IOM RRK VI projekti, dhe donatorët	2022-2025	MKK/EU dhe donatorët tjerë potencial	Rregullorja nr.02/2010 për ZKKK; Rregullorja (QRK) – NR. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme; Udhëzues për zbatimin e Rregullores (QRK) – nr. 01/2018.
Nën objektivi 1.4: Forcimi i mekanizmave ekzistues të informimit për kushtet dhe kriteret e kthimit, si dhe për të drejtat dhe detyrimet e komuniteteve;					
1.4.1 Asistencë në informata për PZH,	Të gjithë PZH janë informuar lidhur me të drejtat, procedurat, kriteret dhe obligimet e kthimit dhe ri-integrimit	MKK/ZKKK	2022-2025	MKK-ja, Komuna/ZKKK dhe zyra për informim	Rregullorja nr.02/2010 për ZKKK; Rregullorja (QRK) – NR. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme; Udhëzues për zbatimin e Rregullores (QRK) – nr. 01/2018.
1.4.2 Hartimi i planit operativ për informim për kthim dhe publikime	Plani operativ për informim dhe publikim i finalizuar	ZKKK/MKK	2022-2025	MKK-ja, Komuna/ZKKK	Rregullorja nr.02/2010 për ZKKK; Rregullorja (QRK) – NR. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme; Udhëzues për zbatimin e Rregullores (QRK) – nr. 01/2018.
1.4.3 Organizimi i vizitave shko-dhe- informo dhe shko-dhe-shiko	Sipas nevojës	ZKKK/MKK	2022-2025	Kushteshmëria: 1,000.00 euro Burimi i fondeve: Komuna- 400.00 Euro Donatorët potencial: 600.00 Euro MKK, Komuna dhe donatorët potencial	Rregullorja nr.02/2010 për ZKKK; Rregullorja (QRK) – NR. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme; Udhëzues për zbatimin e Rregullores (QRK) – nr. 01/2018.

1.4.4 Fuqizimi i ekipit për informim dhe publikime për kthim	500 broshura të hartuara/publikuara; 2 debate dhe intervista në media lokale	Komuna	2022-2025	Kushtueshmëria: 500 euro Burimi i fondeve: KK- 200 Euro Donatorët potencial: 300 Euro MKK, Komuna dhe donatorët potencial	
Nën objektivi 1.5: Ofrimi i mundësive për ndarjen e tokës për raste të veçanta sipas Ligjit në fuqi për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës;					
1.5.2 Identifikimi i të kthyerve pa pronë të cilët jetojnë në pronat shoqërore ose në vendbanime joformale para zhvendosjes	5 raste të identifikuar pa pronë	ZKKK/ Drejtoria Komuna e urbanizmit/gjeodezisë dhe kadastrës dhe pronës	2022-2025	ZKKK/Komuna	Ligji Nr. 06/L-092 Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Paluajtshme të Komunës; Ligji Nr. 03/L-164 Për Financimin e Programeve të Veçanta Të Banimit; Rregullorja nr.02/2010 për ZKKK; Rregullorja (QRK) – NR. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme; Udhëzues për zbatimin e Rregullores (QRK) – nr. 01/2018.
Nën objektivi 1.6: Dialog ndëretnik në mes të personave të zhvendosur dhe komunitetit pranues;					
1.6.1 Përgatitja e vizitave shko-dhe-shiko	Sipas nevojës	Kryetari/ZKKK/MKK/ Policia e Kosovës/Përfaqësuesi i komuniteteve/OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare	2022-2025	MKK, Komuna dhe donatorët potencial	Rregullorja nr.02/2010 për ZKKK; Rregullorja (QRK) – NR. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme; Udhëzues për zbatimin e Rregullores (QRK) – nr. 01/2018.
Objektiva 2: Integrimi socio-ekonomik					
Nën objektivi 2.1 Mbështetja për integrim ekonomik në bazë të vlerësimit të nevojave për jetesë dhe mirëqenie socio-ekonomike në bazë të kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes për asistencë, të përcaktuara me rregullore;					
2.1.1 Vlerësimi dhe profilizimi i afësisë të PZH-ve dhe të të kthyerve	10 persona të identifikuar si persona të ndarë sipas profileve	ZKKK/Drejtoria përkatëse (Punës dhe Mirëqenies sociale, etj.)	2022-2025	Komuna dhe donatorët potencial sipas aprovimit të granteve për gjenerim të të ardhurave	Rregullorja nr.02/2010 për ZKKK; Rregullorja (QRK) – NR. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme; Udhëzues për zbatimin e Rregullores (QRK) – nr. 01/2018.

2.1.2 Referimi i të kthyerve në Zyrën për punësim	Të gjitha rastet në nevojë	ZKKK/Zyra për Punësim	2022-2025	Komuna/ZKKK dhe zyra për punësim	Rregullorja nr.02/2010 për ZKKK; Rregullorja (QRK) – NR. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme; Udhëzues për zbatimin e Rregullores (QRK) – nr. 01/2018.
2.1.3 Asistenca për integrimin socio ekonomik	Të gjitha rastet që i plotësojnë kriteret	ZKKK/MKK	2022-2025	MKK dhe donatorët potencial	
Nën objektivi 2.2 Krijimi dhe mbështetja e projekteve zhvillimore ekonomike të bazuara në komunitete;					
2.2.1 Përpilimi i koncept propozimeve për projektet të bazuara në komunitet	4 koncept projekte të përpiluara	ZKKK/Drejtoritë përkatëse/MKK dhe donatorët potencial	2022-2025	Fondet nga MKK/ZKKK dhe donatorët potencial	Plani Zhvillimor i Komunës së Rahovecit; Rregullorja nr.02/2010 për ZKKK; Rregullorja (QRK) – NR. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme; Udhëzues për zbatimin e Rregullores (QRK) – nr. 01/2018.
2.2.2 Angazhimi i komunës për sigurimin e fondeve nga donatorë potencial për projekte të pambuluara nga buxheti komunal	20,000.00 euro shuma e fondeve të siguruara # i projekteve të realizuara	Komuna, MKK dhe donatorët	2022-2025	Fondet nga MKK/ZKKK dhe donatorët potencial	Rregullorja nr.02/2010 për ZKKK; Rregullorja (QRK) – NR. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme; Udhëzues për zbatimin e Rregullores (QRK) – nr. 01/2018.
2.2.3 Ofrimi i trajnimeve për ndërmarrësi	2 trajnime të ofruara	Qendra për Aftësim Profesional/OJQ lokale dhe ndërkombëtare	2022-2025	Fondet nga MKK/ZKKK dhe donatorët potencial	Rregullorja nr.02/2010 për ZKKK; Rregullorja (QRK) – NR. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme; Udhëzues për zbatimin e Rregullores (QRK) – nr. 01/2018.
2.2.4 Zhvillimi i projekteve infrastrukturore në bashkëpunim ndërmjet nivelit qendror dhe lokal.	Projekte infrastrukturore të realizuara	Komuna/Niveli qendror	2022-2025	Fondet nga Komuna/ZKKK dhe donatorët potencial	Rregullores nr.02/2010 për ZKKK; Rregullores (QRK) – NR. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme; Udhëzues për zbatimin e Rregullores (QRK) – nr. 01/2018
Objektiva 3. Fuqizimi i kapaciteteve komunale përgjegjëse në procesin e kthimit dhe re-integrim;					

3.1 Vlerësimi i nevojave për trajnimin e stafit komunal	4 nevojat për trajnim janë identifikuar	ZKKK/Shefi i personelit në komunë/MKK	2022-2025	ZKKK/MKK dhe donatorët potencial	Ligji nr. 03/I-149 për shërbimin civil të republikës së Kosovës; Rregullorja nr.02/2010 për ZKKK; Rregullorja (QRK) – NR. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme; Udhëzues për zbatimin e Rregullores (QRK) – nr. 01/2018.
3.2 Vlerësimi i nevojës për trajnime lidhur me bazën e të dhënave	Sipas nevojës	Komuna dhe MKK	2022-2025	MKK dhe donatorët potencial	Ligji nr. 03/I-149 për shërbimin civil të republikës së Kosovës; Rregullorja nr.02/2010 për ZKKK; Rregullorja (QRK) – NR. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme; Udhëzues për zbatimin e Rregullores (QRK) – nr. 01/2018.



Lendrit Qeli, Prd Gafnd

Shef i ZKKK-së, Rahovec

Janara 2023



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Predsednik Opštine – Municipal Mayor

Nr. i fletës / No. of sheet: 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No. 36 Nr. i faq./Br.str./No.pg 98
Data/Datumi/Date 11 / 1 / 23
P./Z./Pratje/Attachment: VAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës:

PROPOZON

1. Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit që të merret vendim për miratimin e Planit të veprimit për transparencë në Komunën e Rahovecit 2023 - 2027.
2. Pjesë përbërëse e këtij propozimi është Plani i veprimit për transparencë në Komunën e Rahovecit 2023 - 2027.
3. Propozimi hyn në fuqi pas miratimit paraprak nga Kuvendi i Komunës.

Me propozim të njoftohen:

- Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,
- Sekretaria e Kuvendit, dhe
- Arkivi







Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna Rahovec
Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office

KOMUNA E RAHOVECIT

Projekt-Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Rahovecit
2023-2027

2023

Fjala e Kryetarit

Kjo deklaratë ka për qëllim ofrimin e një pikëpamje gjithëpërfshirëse që pasqyron qartazi politikat, procedurat dhe masat tona operative përkitazi me transparencën, gjithëpërfshirjen, kulturën organizative dhe llogaridhënien. Deklarata mbështetet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Strategjinë Vetëqeverisje Lokale dhe aktet tjera komunale rregullative.

Plani i Veprimit për transparencë synon të kontribuojë në ndërtimin e një administrate komunale llogaridhëse dhe transparente, të hapur për qytetarë dhe shoqërinë civile në të gjitha proceset vendimmarrëse. Përmes Planit, do të promovohet koncepti i demokracisë lokale, në mënyrë që politikbërja të bazohet në argumente, fakte dhe të dhëna reale. Plani është dokument strategjik komunal, i hartuar në pajtim me orientimet e përcaktuara nga Strategjinë për Vetëqeverisje lokale dhe aktet juridike përcjellëse të nivelit qendror që promovojnë qeverisjen transparente.

Llogaridhënia dhe transparenca janë parime që përtej informimit, synojnë mekanizma të përfshirjes së qytetarëve në procesin e politikbërjes dhe vendimmarrjes komunale. Për këtë arsye, zotohemi që Komuna e Rahovecit me gjithë sinqeritetin dhe përkushtimin do të rris gatishmërinë, për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive të gjitha kërkesave të qytetarëve për të qenë të angazhuar aktivisht në planifikimin dhe zhvillimin e politikave, për të siguruar që efektet e zbatimit të tyre të japin rezultatet e dëshiruara dhe afektojnë direkt interesin e përgjithshëm të qytetarëve.

Me plan të transparencës, ne do të zbatojmë në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse standardet, parimet, objektivat, metodat dhe mjetet efektive për rritjen e llogaridhënies, inkurajimin e qytetarëve për t'iu bërë pjesë e qeverisjes, si dhe të ndikojmë tek punonjësit për të promovuar sjellje të mirë dhe të përgjegjshme.

Ne vlerësojmë se planifikimi i bazuar është metoda më e mirë e ndërtimit të qëndrueshëm të vizionit zhvillimor. Në funksion të kësaj, shërbimet cilësore komunale dhe administrimi i kërkesave të qytetarëve varet drejtpërdrejtë nga mënyra e shpërndarjes së informatave, sistemet e aplikuara të informacionit, teknikat e konsultimit dhe veprime të tjera përcjellëse të organeve të administratës.

Prandaj, jemi të përkushtuar që jo vetëm të zbatojmë masat e ndërlidhura me informim, por të bëjmë përpjekje për të siguruar praninë e vazhdueshme të qytetarëve dhe grupeve të interesit, me theks të veçantë organizatave të shoqërisë civile, duke përvijuar konceptin qytetarisë aktive dhe ndërtimit të qeverisjes së opinionit publik.

Besojmë që ky plan veprimit për transparencë do të jetë një ndihmesë në rritjen e efikasitetit të shërbimeve, në krijimin e një ambienti më transparent të punës në administratë, rritjen e besimit të qytetarëve ndaj të zgjedhurve të tyre publike, gatishmërisë dhe përkushtimit më të madh, si dhe përpjekjeve për të fuqizuar e përmirësuar sistemin e menaxhimit brenda komunal.

Kryetari i Komunës
Smajl Latifi

Hyrje

Transparenca dhe llogaridhënia janë elementet thelbësore të qeverisjes së mirë në nivelin lokal. Rruga drejt informimit publik efikas duhet të jetë baza e qeverisjes së mirë, ndërkaq, komunikimi efektiv me qytetarët dhe pjesëmarrja e tyre në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të komunës është aspekti kyç që siguron vendimmarrje me bazë të gjerë. Fryma e institucioneve komunale duhet të adoptoj modelet më të avancuara të qeverisjes transparente brenda kornizës ligjore në fuqi.

Transparenca komunale është njëra nga segmentet e qeverisjes e cila monitorohet në vazhdimësi nga qeveria qendrore, por edhe nga akterë të tjerë ndërkombëtar, Komisioni Evropian, organizatat ndërkombëtare, si dhe organizatat joqeveritare. Marrë parasysh nivelin e përgjegjësisë dhe shkallën e decentralizimit të pushtetit lokal në Kosovë, Kushtetuta dhe legjislacioni kanë paraparë të drejtën e autoriteteve qendrore për të ofruar mbështetje dhe mbikëqyrje në faza të caktuara të procesit të avancimit të transparencës dhe zhvillimit të politikave për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje lokale.

Komunat si njësi themelore të vetëqeverisjes lokale janë të obliguara t'i krijojnë mekanizmat e përshtatshëm të informimit publik. Tani, struktura e ueb-faqeve zyrtare të komunave është unike. Përmes tyre është krijuar mundësia për qasje në të gjitha dokumentet me rëndësi publike. Përveç karakterit informues, ato mundësojnë edhe procese administrative dhe linja me ndërfaqe të tjera të cilat shërbejnë për procesin e konsultimit publik. Ndërlidhja e tyre me sistemin e intranetit në komunë, mundëson që qytetarët të parashtrojnë online të gjitha kërkesat e tyre ndaj drejtorive përkatëse në komunë.

Fusha e transparencës komunale ka një strukturë të mirë organizuar të rregullave juridike ligjore dhe nënligjore. Plani i Veprimit për Transparencë synon t'i grupoj përgjegjësitë kryesore të komunave bazuar në këtë rregullativë juridike, për të shërbyer si dokument kornizë në një periudhë afatgjatë.

PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË

Plani i veprimit për transparencë komunale ka për qëllim t'i ofrojë publikut qasje të lehtë në mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave nga organet e komunës, duke përfshirë informim të shpejtë, të dhëna të qasshme, publikimin e të gjitha akteve normative dhe dokumenteve me interes publik, si dhe rritje të mundësive të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Udhëzimi Administrativ Nr.2020/03 për Transparencë në Komuna përcakton obligimin që Komunitat të hartojnë planin katër (4) vjeçar të veprimit për transparencë. Ky plan, kërkon nga komuna të ndërmarrë veprime konkrete në promovimin dhe ofrimin e transparencës së plotë tek : mbledhjet e Kuvendit të Komunës; mbledhjet e komiteteve ; takimet publike; takimet konsultative për projekt-akte; transparencën në planifikimin dhe shpenzimin e buxhetit të komunës; qasje të shpejtë në shërbime elektronike (me sa më pak klikime) dhe fizike; procedura transparente në aktivitetet e prokurimit; procedura transparente të punësimit; përditësimin e vazhdueshëm të aktiviteteve ditore në faqe zyrtare të komunës; përfshirjen aktive të qytetarëve në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe akteve tjera që i konsideron komuna të domosdoshme për konsultim.

Plani i Veprimit për Transparencë mundëson:

- Prezantimi i planifikimit të punëve të organeve të vetëqeverisjes lokale me sistemet e informacionit në mënyrë që puna e organeve të administratës gjatë zhvillimit të politikave të vërtetohen dhe legjitimohen;
- Përfshirjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile në mënyrë aktive dhe të vazhdueshme në hartimin dhe zbatimin e politikave në nivel lokal;
- Rezultatet e punës së komunave të jenë të matshme, cilësore dhe në funksion të interesave të përgjithshme të qytetarëve.

Plani i veprimit për transparencë në mënyrë specifike do të kontribuojë që:

- Komuna të identifikoj me kohë prioritetet për të cilat kërkohet informimi, si dhe përfshirja e qytetarëve apo grupeve të interesit në proces të hartimit të politikave dhe akteve të përgjithshme;
- Të identifikoj metodat, mjetet dhe teknikat për konsultimin e qytetarëve dhe përfshirjen e tyre në procese;
- T'i evitoj praktikatat e zhvillimit të dokumenteve dhe politikave pa respektim të procedurave ligjore lidhur me informimin dhe konsultimin e qytetarëve si dhe të evitoj praktikatat e zhvillimit të dokumenteve dhe politikave me kosto të papërbalueshme;
- Krijimin e një mjedisi të brendshëm transparent dhe llogaridhënës, duke inkurajuar bashkëpërgjegjësi të të gjithë stafit në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe mbikëqyrjen e politikave;
- Mbajtjen e një sistemi dhe përditësim i vazhdueshëm me të dhënat e të gjitha palëve të interesit për të siguruar pjesëmarrjen e qytetarëve në pajtueshmëri me kërkesat dhe standardet ligjore;
- Ndikimin në sjelljet e punonjësve komunal në mënyrë që veprimet e ndërmarra të demonstrojnë ligjshmëri dhe integritet;

Zbatimi i Planit të veprimit për transparencë do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës dhe do të rishikohet periodikisht në përputhje me aktivitetet e komunës. Plani do të përmbledh në mënyrë të qartë transparencën e organeve komunale, publikimin e akteve nënligjore, rregulloret komunale, dokumentet strategjike, vendimet e kryetarit, njoftimet për aktivitetet e komunës (ekzekutivit dhe kuvendit të komunës), takimet publike, planifikimin dhe shpenzimet buxhetore të komunës, prokurimin publik, zbatimin e standardeve të konsultimit publik, qasjen në dokumentet publike etj.

Transparenca si parim i qeverisjes së mirë

Në një sistem demokratik funksional, informimi dhe përfshirja duhet të jenë segment vital i administrimit publik. Transparenca është komponentë kryesore e qeverisjes demokratike, e cila kërkon një hallkë të gjerë të veprimeve institucionale, si në procesin e hartimit të politikave ashtu edhe në fazën e zbatimit dhe raportimit. Rëndësia e transparencës ndikon në aspekte të shumta duke përfshirë qëndrueshmërinë ekonomike, financiare, qeverisjen e mirë, si dhe në sistemin e përgjithshëm të administratës shtetërore. Parimi i publicitetit dhe transparencës supozojnë se çdo kush ka të drejtë të dijë arsyet e nxjerrjes së një vendimi të caktuar apo veprimi të administratës. Përmes këtij parimi mundësohet hapja e administratës para shoqërisë, informimi për punën e saj mund të bëhet në mënyrë të ndryshme dhe në vëllim të ndryshëm, parim që mund të kufizohet vetëm në rastet e caktuara në legjislacionin e secilit vend. Të qenurit i hapur dhe transparent janë gjithashtu instrumente të nevojshme për shtetin e së drejtës, barazinë para ligjit, dhe përgjegjshmërinë. Si rregull i përgjithshëm, sjellja e administratës publike duhet të jetë transparente dhe e hapur, megjithëse të dhënat personale nuk duhet t'i lejohen palëve të treta.

Transparenca është një nga çështjet më me peshë në procesin e demokratizimit të shteteve dhe qeverisjes së mirë. Këtë e mundësojnë mekanizmat dhe iniciativat e qeverisjes së hapur, të cilat bëjnë që përfitimet e transparencës të jenë në shumë aspekte, përfshirë: qeverisje më e mirë, vendimmarrje më cilësore, besim më të madh publik, ulje të korrupsionit dhe shërbime publike më efektive. Transparenca përfshin rregullat mbi të drejtat e krijimit, ruajtjes, qasjes dhe përpunimit të informacionit, të cilat mund të shfrytëzohen gjatë proceseve të vendimmarrjes, por edhe për nevoja të informimit të përgjithshëm. Për më tepër, në kuptim më të gjerë transparenca nuk është vetëm informim, por përfshinë një varg procesesh dhe veprimesh të bazuara në: informacion, komunikim, pjesëmarrje, angazhim, ndërtim të konsensusit për zgjidhjen e problemeve, raportim dhe llogaridhënie.

Korniza ligjore për transparencë

Në pajtueshmëri me Kushtetutën e Kosovës janë miratuar një numër i madh i ligjeve dhe akteve nënligjore, që rregullojnë fushën e transparencës. Ligji për Vetëqeverisje Lokale është aprovuar në vitin 2008 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe bën pjesë në grupin e ligjeve me karakter vital për shtetin. Përmbajtja e këtij ligji reflekton parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, duke paraparë mekanizma të veçantë të informimit, pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të të drejtave të qytetarëve, e në veçanti të drejtave të komuniteteve joshumicë. Me këtë ligj është përcaktuar që kuvendi i komunës të miratojë rregulloren komunale që promovon transparencë të organeve legjislativë, ekzekutive dhe administrative të komunës, duke e rritur pjesëmarrjen e opinionit në marrjen e vendimeve në nivel lokal dhe duke lehtësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të komunës. Përveç kësaj, me anë të një numri të konsiderueshëm të akteve nënligjore janë definuar edhe procedurat e zbatimit të instituteve të shumta juridike për transparencë, janë përcaktuar zyrtarët përgjegjës, format dhe teknikat për transparencë, si dhe afatet procedurale. Në përgjithësi, kuadri juridik normon obligime për organet e administratës shtetërore në fushën e transparencës, ndërsa në veçanti për organet e pushtetit, përmes akteve si në vijim:

- Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale;
- Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike;
- Ligji Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Ligji Nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë;
- Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative;
- Ligji Nr.04/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për menaxhimin [e financave publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 03/L-211](#);
- Ligji Nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve;
- Ligji Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës
- Rregullore (QRK) Nr. 27/2018 për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun;
- Rregullore Nr. 04./2012 për Evidencën Zyrtare të Kërkesave për Qasje në Dokumente Publike;
- Rregullore (QRK) Nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik;
- Rregullore Nr. 02/2012/MF për Tarifatat në qasje në dokumente publike;

- Hiqet kjo rregullore Rregullore Nr. 01/2012 për Kodin e Etikës për Zyrtarët e Komunikimit me Publikun;
- Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.03/2020 për Transparencën në Komuna;
- Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna;
- Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 01/2019 për Monitorimin e Kuvendeve të Komunave Përmes Pajisjeve të Teknologjisë Informative “Teleprezencave”;
- Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.01/2021 për Funkcionimin e Qendrave të Shërbimeve të Qytetarëve në Komunë;
- Udhëzim Administrativ Nr.01/2015 për Ueb-faqet e Institucioneve Publike
- Rregullore (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës;
- Rregullore Nr.01/2020 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemën e Grantit të Përfundimit Komunal;
- Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna;

Aktet komunale:

- o Statuti i komunës;
- o Rregullore komunale për transparencë;
- o Rregullore komunale për përdorimin e gjuhëve;
- o Akte të tjera ligjore dhe nënligjore që ndërlidhen me fushën e transparencës.

Qasja strategjike për fuqizimin e transparencës

Në nivel qendror janë zhvilluar një numër strategjish të cilat parashohin objektiva me synim reformën e administratës shtetërore. Ndër strategjitë kryesore në fushën e qeverisjes së mirë, transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në institucionet e administratës janë:

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim, 2022-2030
- Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026;
- Strategjia për Rregullim më të Mire 2017-2021
- Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave 2017-2021
- Strategjia për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023;
- Agjenda për Reforma Evropiane;
- Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKMSA)
- Strategjitë e tjera sektoriale.

Dokument specifik me ndikim në transparencën komunale është Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026. Kjo strategji ka 5 objektiva kryesore përmes së cilave përcaktohen caqet afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit të pushtetit lokal në Kosovë. Në objektin e tretë të saj, strategjia parasheh *forcimin e partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezive*. Bazuar në problemet e identifikuara, në planin e veprimit të kësaj strategjie parashihen aktivitetet konkrete të masave, që përfshijnë zhvillimin e politikave efektive për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve, respektivisht:

- Politikat lokale për nxitjen e aktivizimit qytetar;
- Politikat për nxitjen e punës vullnetare të studentëve dhe nxënësve;
- Politikat për funksionalizimin e qendrave rinore nëpër fshatra;
- Politikat për funksionalizimin e këshillave të fshatrave;
- Politikat për përfshirjen dhe angazhimin e pensionistëve në jetën publike;
- Politikat për angazhimin e personave me aftësi të kufizuara;
- Politikat për nxitjen e pjesëmarrjes së grave si dhe kategorive sociale të pambrojtura;
- Politikat lokale për trajtimin e fëmijëve të rrugës;

- Politikat lokale për krijimin e rrjeteve sociale, ekonomike, rinore, sportive dhe kulturore.¹

Strategjia parasheh po ashtu masa konkrete në krijimin e platformave që fuqizojnë transparencën, e në veçanti përmes qeverisjes elektronike. Qeveria elektronike siguron që lehtëson komunikimin në mes të grupeve të interesit me autoritetet publike, derisa ajo forcon administratën përmes: kursimit të kohës në ofrimin e shërbimeve, uljes së kostos operative, rritjes së efikasitetit, ruajtjes së memories institucionale dhe rritjes së llogaridhënies.

Andaj, masat e tilla të ndërhyrjes janë të rëndësishme, për faktin se përmirësojnë komunikimin me qytetarë, krijojnë hapësirë për politikbërje të qëndrueshme, zbatim efikas të tyre, si dhe plotësojnë obligimet e Kosovës në raport me kriteret e kërkuara nga Bashkimi Evropian

Mekanizmat ligjorë për pjesëmarrje dhe zbatim të parimit të transparencës

Qeverisja lokale në Kosovë promovon fuqishëm parimet e transparencës, llogaridhënies dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje. Mënyra e parë dhe më e thjeshtë në të cilën transparenca mund të ndihmojë në ofrimin e paanësisë është duke lejuar publikun të luajë një rol të rëndësishëm në garantimin që rregullat të zbatohen në mënyrë të drejtë dhe korrekte. Qytetarët nuk mund të jenë askund më afër me shtetin se përmes organeve të pushtetit lokal. Komunitat janë adresa më e afërt për të kërkuar që shërbimet dhe resurset shpërndahen në mënyrë të drejtë, të barabartë dhe në pajtim me nevojat sistematike të tyre.

Numri më i madh i taksave dhe tatimeve që mbledhen nga shteti, u shpërndahen komunave për ushtrimin e kompetencave ligjore. Taksat për të cilat qytetarët paguajnë në baza periodike janë burime vetanake të komunave, të cilat shpenzohen për shërbimet e ofruara. Planifikimi i shpenzimit të tyre bëhet me anë të buxhetit komunal, që është dokument kryesor vjetor që mbledh të gjitha projektet investive me interes publik. Gjatë përgatitjes së buxhetit, komunitat ligjërisht obligohen të mbajnë konsultime me qytetarët, bizneset, grupet e interesit dhe shoqërinë civile. Prandaj, qeverisja e mirë komunale do të zinte vend vetëm nëse planifikimi i mjeteve buxhetore, politikave të tjera, shpenzimit të tyre dhe mënyra e shpërndarjes së investimeve publike do të mbështetej në opinionin e qytetarëve, përmes formave të shumta të përfshirjes direkte të tyre.

Në mënyrë që transparenca të jetë pjesë përbërëse e politik bërjes në nivel lokal, Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka përcaktuar një numër të shumtë të instrumenteve juridike për pjesëmarrje të qytetarëve në jetën publike ku bëjnë pjesë:

- Takimet publike gjithëpërfshirëse me qytetarë;
- Konsultimet për projekt-aktet dhe dokumente të politikave;
- Informimi dhe konsultimi përmes e-qeverisjes;
- Bashkëpunimi me shoqërinë civile;
- E drejta për qasje në dokumentet publike.
- Komitetet konsultative;
- Iniciativat qytetare, peticionet dhe referendumat lokale;

Të gjitha këto forma kanë bazën e tyre juridike, procedurale, mjetet dhe format e zbatimit të tyre. Efekti i tyre në përmirësimin e qeverisjes lokale vërehet përmes rritjes së transparencës, krijimit të qytetarisë aktive dhe forcimit të dialogut social. Edhe pse të shumta, aplikimi i tyre ndryshon nga njëra komunë në tjetrën, për çka tregojnë statistikën e shumta të dala nga raportet e monitorimit të institucioneve të ndryshme publike dhe jopublike. Gjithashtu, jo të gjitha janë të zbatueshme për shkaqe juridike, por edhe praktike.

Objektivat e Planit të Veprimit për transparencë

¹ Qeveria e Republikës së Kosovës: "Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026", Prishtinë, 2016, fq. 32

Objektivi kryesor i Planit të Veprimit për Transparencë Komunale është “të siguroj qeverisje të hapur për qytetarë, gjithëpërfshirje në procesin e planifikimit dhe zhvillimit të politikave, si dhe qeverisje transparente dhe llogaridhënëse”.

Objektivat specifike janë:

- Sigurimi i një kornize të qartë të planifikimit të organizuar, ku përcaktohen rolet e të gjithë pjesëmarrësve përgjegjës për transparencë komunale.
- Fuqizimi i mekanizmave lokal të demokracisë direkte, për të krijuar një publik të interesuar për çështje publike;
- Avancimi i mekanizmave të informimit në mënyrë që qytetarët të dëgjohen dhe të inkurajohen për të qenë aktiv në proceset vendimmarrëse.
- Krijimi i një sistemi efektiv qeverisës, në të cilin parim kryesor i projektimit të politikave është baza e informacionit.
- Ndërtimi i partneritetit të mirëfilltë me shoqërinë civile, në të gjitha fazat e menaxhimit të organeve komunale.

Fazat e zhvillimit të Planit të Veprimit për Transparencë Komunale

Zhvillimi i Planit të Veprimit për Transparencë duhet të kalojë në disa faza si në vijim:

- 1) **Faza Paraprake** – Kryetari i komunës themelon grupin e punës. Përbërja e grupit punës duhet të jetë shumësektoriale dhe të udhëhiqet nga Zyra për Informim në bashkëpunim me zyrën ligjore të komunës. Procedurat e hartimit zhvillohen në pajtim me rregullat në fuqi për procedurat e hartimit të akteve komunale.
- 2) **Faza e vlerësimit të prioritetëve** – gjatë kësaj faze, kryesuesi së bashku me grupin punës analizojnë dokumentacionet e mbledhura (legjislacionin dhe aktet nënligjore të zbatueshme në punën e administratës së komunës; dokumentet strategjike të komunës mbi bazën e të cilave priten të zhvillohen aktet juridike të komunës, planet komunale, dokumentet e tjera të politikave për të cilat duhet të zhvillohen konsultime publike dhe të sigurohet prania e qytetarëve. Mbi bazën e analizës së gjendjes aktuale dhe planeve afatshkurtëra, afatmesme dhe afatgjate, duhet të përcaktohen prioritetet dhe të bëhet renditja e veprimeve për secilin aktivitet.
- 3) **Faza e përcaktimit të aktiviteteve dhe propozimit të masave** – kjo fazë përfshin kategorizimin e prioritetëve sipas periudhave të zhvillimit, renditjen e aktiviteteve, metodave dhe mjeteve të veprimit, afatet kohore, organet/zyrtarët përgjegjës, koston financiare.
- 4) **Faza e mbikëqyrjes dhe raportimit të planit të veprimit për transparencë** - përfshin mbikëqyrjen, regjistrimin dhe raportimin e rregullt të aktiviteteve që zhvillohen sipas Planit të veprimit për transparencë. Raportimi mundëson që informacionet e mbledhura të përdoren në marrjen e vendimeve që përmirësojnë zbatimin e objektivave të Planit të Transparencës Kryesuesi i grupit Punës merr pjesë në grupin punës për hartimin e planit vjetor të punës së komunës.
- 5)

Metodologjia e vlerësimit dhe përcaktimit të aktiviteteve të transparencës

Vlerësimi i aktiviteteve të transparencës do të thotë renditja e veprimeve në Plan sipas prioritetëve, duke mundësuar që komuna të jetë e hapur dhe bashkëpunuese me qytetarë në të tri fazat kyçe të menaxhimit: 1) Planifikim; 2) Zbatim; 3) Raportim.

Prioritetet përcaktohen duke marrë për bazë rëndësinë e proceseve, përkatësisht: Natyrës së veprimtarisë që do të ndërmerret nga organi përkatës i komunës; Llojeve të dokumenteve të politikave për të cilat kërkohet përfshirja e qytetarëve; Fushëveprimin të akteve juridike të planifikuara për hartim; Ndikimit të tyre ekonomik dhe social; Peshës financiare të politikës së propozuar; Periudhës kohore të veprimit; Shtirjes gjeografike; etj.

Pas përcaktimit të aktiviteteve grupi punës cakton prioritetet dhe metodat e veprimit të cilat duhet të jenë pjesë përbërëse e planit të veprimit, të cilat janë të ndryshme varësisht se për cilën fazë të menaxhimit bëhet fjalë.

Mbikëqyrja e zbatimit të Planit të Veprimit për Transparencë

Zbatimi i Planit të Veprimit për Transparencë do të mbikëqyret në vazhdimësi me mekanizma përkatës, do të rishikohet periodikisht dhe do të azhurohet në përputhje me ndryshimet ligjore, institucionale, procedurale dhe të personelit, në varësi të ndikimeve nga mjedisi i jashtëm apo i brendshëm i Komunës.

Mbikëqyrja e vazhdueshme në zbatim është e rëndësishme për t'u siguruar se masat e parapara janë efektive dhe ndikojnë në cilësinë e politik-bërjes, si parakusht i ligjshmërisë së procesit vendimmarrës. Gjithashtu, mbikëqyrja duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë sjellë vendimmarrje cilësore, efikase dhe efektive, me kosto reale dhe të përballueshme.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur. Me qëllimi të sigurimit të zbatimit të Planit të Veprimit për Transparencë, krijohet mekanizmi për mbikëqyrje dhe raportimin e këtij plani, si në vijim:

Grupi punues - emërohet me vendim të kryetarit të komunës dhe është përgjegjës për:

- Hartimin e Planit të Veprimit për Transparencë Komunale;
- Grupi është njëherësh siguruar i zbatimit të Planit dhe garanton që në baza periodike Plani Vjetor i Punës së Komunës të ndërlihet me aktivitetet dhe masat e përcaktuara në Planin Vjetor të Veprimit për Transparencë;
- Kryesuesi i grupit Punues merr pjesë në grupin punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së komunës.
- Propozon masa të nevojshme për zbatimin e plotë të masave të propozuara në Planin e Veprimit për Transparencë;
- Mbikëqyrë zbatimin e masave për përmirësimin e transparencës;
- Raporton tek kryetari për zbatimin e Planit të Veprimit për Transparencë;

Plani i Veprimit për 'Transparencë Komunele

Objektivat	Aktivitetet	Treguesit e matjes	Afati kohor	Njësia/personi përgjegjës	Mënyra e njoftimit / zbatimit	Dokumentet referuese	Kolonë raportimi
Transparenca e kuvendeve të komunave							
Informimi i rregullt i qytetarëve dhe grupeve të interesit për aktivitetet dhe vendimet e Kuvendit të komunës dhe komiteteve	Publikimi i njoftimeve, sigurimi i materialeve të nevojshme, hapësirës për pjesëmarrjen publikut dhe përfaqësuesit e mediave të shkruara/elektronike në takimet e Kuvendit të komunës dhe komiteteve	1) Numri i njoftimeve të shpallura në gjuhët zyrtare për mbledhje të kuvendit në ueb faqe zyrtare të komunës ; 2) Numri i njoftimeve të shpallura në gjuhët zyrtare për mbledhje të komiteteve në ueb faqe zyrtare të komunës.	1) Njoftimi shtatë (7) ditë pune para mbledhjeve të rregullta Kuvendit; 2) Njoftimi 3 ditë pune para mbledhjes së jashtëzakonshme; 3) Tërthja brenda ditës për mbledhje urgjente.	Kryesuesi i kuvendit të Komunës; Kryesuesi i Komitetit përkatës; Sekretaria e Kuvendit; Zyra për informim.	Përmes ueb-faqes zyrtare; Shpalljeve publike; Formave të tjera të informimit.	- Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; - Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna; - Statuti i Komunës; - Rregullorja komunale për transparencë.	
	Transmetimi në kohë reale i mbledhjeve të kuvendit të komunës	Numri i mbledhjeve të kuvendit të transmetuara drejtpërdrejtë	Në vazhdimësi	Sekretaria e kuvendit; Zyrtari i IT-së; Zyra e informimit.	Përmes ueb-faqes zyrtare; Rrjetëve sociale; Youtube; Mediave lokale.	- Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; - Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna; - Statuti i Komunës	
	Publikimi i akteve të kuvendit të komunës	1) Numri i akteve të aprovuara; 2) Numri i akteve të publikuara në gjuhët zyrtare	Pas afatit 15 ditor të shqyrtimit të ligjshmërisë nga ministria përgjegjëse për qeverisje lokale	Kryesuesi i kuvendit; Sekretaria e kuvendit; Zyra për informim.	Ueb-faqja e komunës; Gazeta Zyrtare e Kosovës.	Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; Rregullore (MAPL) Nr. 02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës; Rregullorja komunale për përdorimin e gjuhëve.	

	Publikimi i Planit të punës së kuvendit të komunës	Plani i publikuar në gjuhët zyrtare në ueb-faqen zyrtare të komunës	Fillimi i muajit Janar	Kryesuesi i kuvendit; Sekretaria e kuvendit; Zyra për informim.	Ueb-faqja e komunës;	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna; Rregullorja komunale për përdorimin e gjuhëve.
	Publikimi i raportit të punës së kuvendit të komunës	Raporti vjetor i publikuar në gjuhët zyrtare	Deri më 31 janar për vitin paraprak	Kryesuesi i kuvendit; Sekretaria e Kuvendit Zyra për informim;	Ueb-faqja e komunës; Platforma të tjera sociale.	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna Rregullorja komunale për përdorimin e gjuhëve.
	Publikimi i profileve të anëtarëve të kuvendeve të komunave	Biografite e anëtarëve të kuvendit dhe të dhënat kontaktuese të publikuara;	Me rastin e marrjes së mandatit;	Kryesuesi i kuvendit të komunës; Anëtarët e kuvendit të komunës; Sekretaria e Kuvendit; Zyra për informim.	Ueb-faqja e komunës;	Udhëzim Administrativ (MAP) Nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike; Rregullorja komunale për përdorimin e gjuhëve.

	Publikimi i të dhënave për përbërjen e komiteteve të kuvendit dhe funksioneve të tyre	1) Të dhënat e përfaqësuesve në komitete të publikuara; 2) vendimet për themelimin e komiteteve të publikuara; 3) Përgjegjësitë e komiteteve të përshkruara në ueb-faqe.	Sipas kohës së themelimit dhe funksionalizimit;	Kryesuesi i kuvendit të komunës; Kryesuesi i komitetit përkatës; Sekretaria e Kuvendit; Zyra për informim.	Ueb-faqja e komunës	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna; Udhëzim Administrativ (MAP) Nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike.
	Themelimi i komiteteve konsultative	Numri i komiteteve konsultative të themeluara; Numri i kërkesave të parashtruara për themelimin të komiteteve.	Iniciativë e kuvendit të komunës apo pas parashtrimit të kërkesës / ose me rastin e përfundimit të mandatit të komitetit	Kuvendi i kuvendit të komunës		U.A. 01/2016 për procedurën e themelimit, organizimin dhe kompetencat e komiteteve konsultative në komuna
Transparenca e Kryetarit të Komunës / Përfshirja e qytetarëve/ Qasja në dokumentet publike / Informimi publik						
Informimi i rregullt i qytetarëve dhe grupeve të interesit për aktivitetet dhe vendimet e kryetarit të komunës	Publikimi i akteve të kryetarit të komunës	Lista e akteve të aprovuara e publikuar	Në vazhdimësi	Zyra për informim; Zyra e Kryetarit	Ueb-faqja e komunës	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;
	Publikimi listës së pronave të planifikuara për dhënie në shfrytëzim për vitin e ardhshëm, pas miratimit në Kuvend të Komunës	Lista e pronave e planifikuar për dhënie në shfrytëzim, e publikuar	Deri me 31 dhjetor të vitit paraprak	Zyra e Kryetarit; Sekretaria e kuvendit; Drejtoria e pronës Zyra për informim.	Ueb-faqja e komunës; Gazeta Zyrtare e Kosovës	Ligji Nr.06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;

	Mbajja e se paku dy takimeve publike me qytetare brenda vitit	2 takime të mbajtura gjatë vitit	Takimi i parë në gjashëmujorin e parë të vitit; Takimi i dytë në gjashëmujorin e dytë të vitit	Zyra e Kryetarit; Zyra për informim.	Njoftimi përmes ueb-faqes së komunës; Shfrytëzimi i platformave online të komunikimit; Takime të drejtpërdrejta;		Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;		
	Numri i takimeve konsultative tjera në kuadër të lagjeve, vendbanimeve dhe lokacioneve tjera.	Numri i takimeve për të cilat është plotësuar kushti i njoftimit 14 ditë dhe gjuhët zyrtare; Numri i takimeve për të cilat kërkesat dhe rekomandimet e dhëna nga publiku janë evidentuar dhe publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës, brenda 15 ditëve pas përfundimit të takimit.	Njoftimi i shpallur 14 ditë para takimit në gjuhët zyrtare	Zyra e Kryetarit; Zyra për informim.	Njoftimi përmes ueb-faqes së komunës; Shfrytëzimi i platformave online të komunikimit; Takime të drejtpërdrejta;		Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;		

	Shqyrtimi i kërkesave/iniciativave dhe peticioneve të qytetarëve	1) Numri i kërkesave, iniciativave qytetare dhe peticioneve të parashtruara tek Kryetari; 2) Numri i iniciativave kërkesave, iniciativave qytetare dhe peticioneve të shqyrtuara brenda 60 ditësh; 3) Numri i njoftimeve të publikut brenda 15 ditësh për kërkesat, iniciativat qytetare dhe peticionet e parashtruara.	Në vazhdimësi	Kuvendi i komunës; Kryetari i komunës.		Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;
Inkurajimi i qytetarëve për pjesëmarrje në proces të hartimit të politikave dhe dokumenteve në nivel lokal	Mbajtja e takimeve me qytetarë për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB)	Numri i takimeve me qytetarët për KAB	Para datës 30 Qershor	Komiteti për Politikë dhe Financa; Kryesuesi i Kuvendit; Kryetari i komunës; Drejtorja për Buxhet dhe Financa; Drejtoritë tjera.	Njoftimi përmes ueb-faqes së komunës, apo shpalljeve të tjera; Takime të drejtpërdrejta; Konsultimet me shkrim; Konsultimet elektronike; Platforma qeveritare për konsultime publike; Format tjera të përcaktuara në nenin 10 të U.A. për standardet minimale të konsultimit publik;	Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna. Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna

Përfshirja e hershme e publikut në procesin e planifikimit të punëve të kryetarit të komunës	Projekt-Plani i ekzekutivit për vitin e ardhshëm kalendarak i publikuar për konsultim me qytetarë	Deri në fund të muajit dhjetor	Zyra për informim; Zyra e Kryetarit;	Ueb-faqja e komunës; Platforma Qeveritare për Konsultime Publike; Forma të tjera të vlerësuara nga komuna	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna; Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsulimit Publik në Komuna
Përfshirja e hershme e publikut në procesin e planifikimit të punëve të kuvendit të komunës	Projekt-Plani i kuvendit të komunës për vitin e ardhshëm kalendarak i publikuar për konsultim me qytetarë	Deri në fund të muajit dhjetor	Kryesuesi i Kuvendit të komunës; Sekretaria e kuvendit; Zyra për informim.	Ueb-faqja e komunës; Platforma Qeveritare për Konsultime Publike; Forma të tjera të vlerësuara nga komuna	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna; Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsulimit Publik në Komuna
Mbajtja e konsultimeve me qytetarë për projektbuxhetin e komunës nga ekzekutivi i komunës	Konsultimet publike për projektbuxhet, të mbajtura nga kryetari i komunës / ekzekutivi	Para datës 1 shtator	Kryetari i komunës; Drejtoria për Buxhet dhe Financa; Drejtoritë tjera.	Njoftimi përmes ueb-faqes së komunës, apo shpalljeve të tjera; Takime të drejtpërdrejta; Konsultimet me shkrim; Konsultimet elektronike; Publikimi në Platformën qeveritare për konsultime	Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsulimit Publik në Komuna; Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;

						publike; Format tjera të përcaktuara në nenin 10 të U.A. për standardet minimale të konsultimit publik.				
Mbajtja e konsultimeve me qytetare për projektbuxhetin e komunës nga Kuvendi i Komunës	Konsultimet publike për projektbuxhetin, të mbajtura nga Kuvendi i Komunës	Para datës 30 shtator	Kryesuesi i kuvendit të komunës; Sekretaria e Kuvendit; Drejtoria për Buxhet dhe Financa;	Kryesuesi i kryesisë së komunës, apo shpalljeve të tjera, Takime të drejtpërdrejta; Konsultimet me shkrim; Konsultimet elektronike; Publikimi në Platformën qeveritare për konsultime publike; Format tjera të përcaktuara në nenin 10 të U.A. për standardet minimale të konsultimit publik.	Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna; Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;					
Mbajtja e konsultimeve me qytetare për Planin Zhvillimor Komunal, Harata Zonale dhe Planin Rregullativ	PZH/K, HZ dhe Planin Rregullativ të konsultuara me publikun	Në vazhdimësi	Zyra e Kryetarit; Kryesuesi i grupit punues për hartimin e	Publikimi i procesverbaleve dhe raporteve në Ueb-faqja e komunës	Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të					

					projekt dokumentit; Drejtoria e Urbanizimit; Zyra për informim;		Konsultimit Publik në Komuna;	
Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së kryetarit/ekzekutivit	Diskutimi i raportit të kryetarit në kuvendin e komunës	Raportet e paraqitura për diskutim në kuvendin e komunës	Njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës	Kryetari i komunës; Sekretaria e kuvendit	Inkorporimi në rend dite; Diskutimi në kuvend	Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale;		
	Dorëzimi i raporteve tremujore financiare në kuvendin e komunës dhe publikimi në ueb-faqen zyrtare	1) Raportet e paraqitura për diskutim në kuvendin e komunës; 2) Raportet e publikuara në ueb-faqe	1) Tremujori 4 para datës 31 Janar; 2) Tremujori 1 para datës 30 Prill; 3) Tremujori 2 para datës 31 Korrik; 4) Tremujori 3 para datës 31 Tetor	Ekzekutivi; Drejtoria e Financave Zyra për informim.	Inkorporimi në rend dite; Diskutimi në kuvend; Publikimi në ueb-faqe.	Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;		
	Publikimi i raportit përfundimtar financiar	Raporti i publikuar	Jo më vonë se me 31 Mars të çdo viti kalendarik	Kryetari i komunës; Ekzekutivi; Drejtoria e Financave Zyra për informim.	Ueb-faqja zyrtare e komunës	Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;		
	Publikimi i listës së subjekteve përfutese nga kategoria e subvencioneve	Lista e përfutësve të subvencioneve, e publikuar;	Pas miratimit të listës nga ana komisionit vlerësues	Zyra e informimit Drejtoria përkatëse. Drejtoria e	Ueb-faqja zyrtare e komunës; platformat e tjera sociale	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;		

					Financave				
	Prezantimi, diskutimi në kuvendin e komunës si dhe publikimi i Raportit të Performancës Komunale	Raporti i Performancës Komunale i prezantuar dhe i diskutuar në kuvendin e komunës Raporti i Performancës Komunale i publikuar në ueb faqen e komunës. (Pas publikimit në ueb faqen e MAPL	<u>Gjatë vitit (ka zakonisht vonesa, nuk mund të saktësohet një datë konkrete)</u>	Kryesuesi i kuvendit të komunës; Sekretaria e Kuvendit; Koordinatori i performances Zyra për informim.	Ueb-faqja e komunës;	Rregullore Nr.01/2020 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemën e Grantit të Performancës Komunale			
	Diskutimi i raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit në Kuvendin e Komunës	Raporti i inkuorpuar në rend të ditës dhe i diskutuar në KK; Raporti i publikuar në ueb faqen e komunës	Pas publikimit nga ZKA	Kryesuesi i kuvendit; Kryetari i komunës; Zyra për informim.	Inkuorporimi në rend dite; Diskutimi në kuvend; Publikimi në ueb-faqe	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;			
Sigurimi i transparencës në procedurat e prokurimit publik	Publikimi i Planit të Prokurimit për vitin fiskal	Plani i prokurimit i publikuar në ueb-faqe	Pas miratimit dhe shpalljes së ligjit vijtor për ndarjet buxhetore	Zyra për prokurim; IT Zyra e informimit	Ueb-faqja e komunës; E-prokurimi	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;			
	Publikimi i Raportit vijtor të zbatimit të Planit për prokurim publik	Raporti i prokurimit i publikuar	Jo me vone se 31 janar, për vitin paraprak	Zyra për prokurim; Zyra e informimit	Ueb-faqja e komunës	Ligji i Prokurimit Publik; Udhëzimi Administrativ të MAP-it për mirëmbajtjen e faqeve elektronike të institucioneve publike;			

							Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik; Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë	
	Publikimi i gjitha aktiviteteve të prokurimit në ueb-faqen e komunës	Numri i aktiviteteve të prokurimit të publikuara në	Në vazhdimësi	Zyra për prokurim; Zyra e informimit.	Ueb-faqja e komunës; E-prokurimi	Ligji i Prokurimit Publik; Udhëzimi Administrativ të MAP-it për mirëmbajtjen e faqeve elektronike të institucioneve publike; Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik; Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë		
	Krijimi i strukturave përgjegjëse komunale për koordinimin dhe zbatimin e standardeve minimale të konsultimit publik	Zyrtari përgjegjës për konsultim publik, i caktuar me vendim të kryetarit		Kryetari i komunës;		Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna;		
Ngritja e cilësisë së konsultimeve të politikave dhe akteve të komunës përmes zbatimit të	Përgatitja e planit të veçantë për të gjitha propozimet e akteve nënligjore dhe politikave lokale, të cilat i nënshtrohen procesit të konsultimit publik gjatë vitit	Plani i veçantë i hartuar	Muaji dhjetor për vitin vijues	Zyrtari përgjegjës për konsultim publik; Njësitë organizative të komunës	Inkorporimi i aktiviteteve të planit vjetor të punës së komunës në planin e veçantë për konsultime	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna;		

standardeve minimale të konsultimit publik në nivel lokal	Informimi me kohë për dokumentet, projekt-aktet, mënyrat dhe format e konsultimit, vendin dhe afatet e konsultimit publik	1. Numri i akteve/dokumenteve për të cilat kërkohet konsultimi publik; 2) Numri i njoftimeve të shpallura për konsultime publike; 3) Bashkëngjitja projekt-propozimit, dokumentin konsultues që përmban afatet e konsultimit, memorandumet shpjeguese dhe adresën për pranimin e komenteve	Të paku tetë (8) ditë dhe maksimum katërbëdhjetë (14)	Zyrtari përgjegjës për konsultim në koordinim me zyrtarin përgjegjës për hartim të projekt-propozimit	Ueb-faqja e komunës; Rrjetet sociale; Media lokale etj.	Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna;
	Pjesëmarrja e publikut në grupet punuese	Numri i grupeve punuese të themeluara; Numri i grupeve punuese që përfaqësojnë qytetarët/shoqëritë civile	Përfshirja e tyre në grupet punuese	Kryetari i komunës; Organi propozues	Njoftimi përmes ueb-faqes/ thirrjeve publike/ Përfshirjes në aktet themeluese	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.03/2020 për Transparencë
	Hapja e menuse/rubrikës të veçantë me të dhënat e procesit të konsultimit publik	Menuja/Rubrika e krijuar në ueb-faqe; Vegëza/ikona e integruar në ueb-faqe për Platformën e Qeverisë për konsultime publike.		Zyra e Informimit	Në koordinim me MAPL-në dhe Zyren për Qeverisje të Mirë	Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna;
	Mbledhja/shqyrtimi i komenteve/propozimeve gjatë procesit të konsultimit publik dhe përgatitja raportit për rezultatet e konsultimit publik	1. Numri i komenteve të parashtruara; 2) Raporti për rezultatet e konsultimit publik i hartuar dhe publikuar.	Së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë dhe jo më shumë se tridhjetë (30) ditë kalendarik për projekt propozimin që nga dita e përfundimit të	Zyrtari përgjegjës për hartim të projekt-propozimit në bashkëpunim me grupin punues dhe zyrtarin përgjegjës për konsultime	Publikimi në ueb-faqe i formularit standard për konsultimet publike i; Komentet e pranuar përmes zyrtarit përgjegjës;	Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna;

			afajit për paraqitjen e propozimeve dhe vërejtjeve me shkrim	publike	Publikimi i dokumentacionit për konsultim në ueb-faqen e komunës dhe platformën qeveritare të konsultimeve publike.		
Garantimi i plotë i të drejtave për qasje në dokumentet publike	Shqyrtimi i rregullt i kërkesave për qasje në dokumente publike	1) Numri i kërkesave të parashtruara nga palët; 2) Numri i kërkesave të shqyrtuara për të cilat palët kanë marrë përgjigje	(7) ditë nga dita e pranimit të kërkesës nga kërkuesi	Zyra për informim / Zyrtari përgjegjës për qasje në dokumentet zyrtare; Qendra për Shërbim të qytetarëve Njësia përgjegjëse për ofrimin e qasjes	Pranimi përmes zyrtarit përgjegjës për konsultime publike. Shqyrtimi nga organi kompetent;	Ligji Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike	
	Mbajtja e evidencës zyrtare, në formë të regjistrit ose ngjashëm, përkritazi me kërkesat, veprimet, procedurat dhe vendimet, lidhur me realizimin e të drejtave të personave fizik dhe juridik, në qasje në dokumente dhe informata zyrtare.	Regjistri me të dhënat zyrtare, i përditësuar dhe publikuar;	Përditësohet çdo tre (3) muaj	Zyra për informim/Zyrtari përgjegjës për qasje në dokumentet zyrtare/	Ueb-faqja e komunës	Ligji Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike	

	Hartimi dhe publikimi i raportit për qasje në dokumentet publike	1) Raporti vjetor i hartuar dhe dorëzuar në Agjencinë për informim dhe privatësi; 2) Raporti i publikuar në ueb-faqe	Jo më vonë se 31 janar	Zyrtari përgjegjës për qasje në dokumentet zyrtare	Ueb-faqja e komunës	Ligji Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike
	Publikimi i Komizës Afatmesme Buxhetore (KAB)	KAB i publikuar në ueb-faqen e komunës	Pas miratimit në Kuvendin Komunal	Kryesuesi i Kuvendit të Komunës; Sekretaria e Kuvendit; Drejtorja e Financave Zyra e Kryetarit; Zyra për informim.	Ueb-faqja e komunës	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna
	Publikimi i buxhetit vjetor	Plani buxhetor i publikuar në ueb-faqen e komunës	Pas miratimit në kuvendin e komunës	Zyra e Kryetarit Drejtorja e Financave Zyra për informim;	Ueb-faqja e komunës	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;

Përmbushja e kritereve të ueb-faqes zyrtare, lehtësimi i marrjes së shërbimeve dhe informimi i rregullt për qytetarë	Publikimi i procesverbalet nga mbledhjet e takimeve të kuvendit të komunës dhe Komiteteve obligative	Procesverbalet e mbledhjeve të kuvendit të komunës të publikuara në ueb faqen e komunës Procesverbalet e mbledhjeve të komiteteve obligative të publikuara në ueb faqen e komunës	Pas miratimit në kuvendin e komunës Pas miratimit në mbledhjet pasuese të komiteteve obligative	Kryesuesi i kuvendit; Kryesuesi i komitetit obligativ; Sekretaria e kuvendit; Zyra për informim;	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;
	Publikimi i Strategjive dhe dokumentet tjera të politikave në nivel lokal	Strategjitë dhe dokumentet tjera të politikave në nivel lokal të miratura publikohen në ueb faqe	Pas miratimit në kuvendin e komunës	Kryesuesi i kuvendit; Sekretaria e kuvendit; Drejtorja përkatëse; Zyra për informim;	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;
	Publikimi i Planit Zhvillimor Komunal, Hartat Zonale dhe Planet Rregulluese	PZHK, HZ dhe PR të publikuara në ueb faqen e komunës	Pas miratimit në kuvendin e komunës	Kryesuesi i kuvendit; Sekretaria e kuvendit; Drejtorja përkatëse; Zyra për informim;	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;
	Publikimi i procedurave në marrjen e shërbimeve të ofruara nga drejtoritë dhe njësitë organizative të komunës	1) Numri i shërbimeve që ofron institucioni për publikun; 2) Numri i procedurave dhe kushteve të përfitimit të tyre dhe afati i detyrueshëm për të marrë përgjigje për shërbimin e kërkuar të publikuara në gjuhët zyrtare; 3) Lista e shërbimeve	Në vazhdimësi	Drejtorja e Administratës Zyra për informim	Udhëzimi Administrativ (MAP) Nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike; Udhëzimi Administrativ (MAP) Nr.03/2020 për Transparencë;



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Rahovec

Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKT-PLANIN E VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË KOMUNALE 2023-2027



INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Duke duke u bazuar në Ligjin numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe Nenit 6 pika 1.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Zyra për Informim në bashkëpunim me Sekretarinë e Kuvendit Komunal të Rahovecit, bën njoftimin për:

KONSULTIM PUBLIK

Për Projekt-Planin e Veprimit për Transparencë Komunale 2023-2027

Me 02.11.2022, është publikuar njoftimi për mbajtjen e konsultimit për Projekt-Planin e Veprimit për Transparencë Komunale 2023-2027. Njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës, facebookun e komunës dhe Platformën e Konsultimeve Publike. Në të njëjtën ditë janë njoftuar përmes emailit drejtorët e shkollave dhe përfaqësuesit e OJQ-ve që veprojnë në territorin e komunës së Rahovecit, ndërsa përmes rrjetit social viber janë njoftuar kryetarët e fshatrave-lagjeve të komunës dhe përfaqësuesit e OJQ-ve.

1. Publikimi në uebfaqe: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/11/Njoftim-publik-Plani-i-Transparences.pdf>
2. Publikimi facebook: <https://www.facebook.com/rahoveckomuna/posts/pfbid02AVGLnkhTKGFGNcR9AaxuV1Q2r562WmTxmmchakvy2W8D6xLPYmpRAsFuph3EiThal>
3. Publikimi në Platformën e Konsultimeve Publike: <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41592>

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKT-PANIN E VEPRIMIT PËR TRANSPARENÇË KOMUNALE 2023-2027

Me 15.11.2022, në uebfaqe zyrtare dhe në facebookun e komunës, është publikuar rikujtimi i njoftimit për mbajtjen e konsultimit publik, në të njëjtën ditë përmes emailit rikujtimi i njoftimit u është dërguar, drejtorëve të shkollave, OJQ-ve sportive dhe OJQ-ve kulturore. Rikujtimi i njoftimit OJQ-ve sportive, OJQ-ve kulturore dhe kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve u është dërguar edhe përmes rrjetit social viber.

KONSULTIMI PUBLIK

Më datë: 16.11.2022 mbahet konsultimi publik në sallën e Kuvendit Komunal. Të pranishëm kanë qenë zyrtarë komunal, kryetarët e këshillave të fshatrave, drejtorë të shkollave, përfaqësues të OJQ-ve, dëshmi janë listat e nënshkrimeve.

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në veçezën në facebook: <https://www.facebook.com/rahoveckomuna/posts/pfbid0pm53iAhax22MA1YZCYSNVT9Utrr4WfU19rhoz2V21xbZSrfRV2gkLWyzSwrhGWPRl>

Në ueb faqe: <https://kk.rks.gov.net/rahovec/news/200049286-2/>

Konsultimi publik filloi në orën 10:00.

Konsultimin e shpalli të hapur Zyrtarja për Informim, e cila në pika të shkurtëra prezantoi Planin e veprimit për transparencë komunale, i cili ka për qëllim t'i ofroj publikut qasje të lehtë në mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave nga organet e komunës, duke përfshirë informimin e shpejtë, të dhëna të qasshme, publikimin e të gjitha akteve normative dhe dokumenteve me interes publik, si dhe rritjen e mundësive të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse.



Blerta Gashi- Përhëndetje të gjithëve,
mirë se keni ardhë, sot para jush do të

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKT-PLANIN E VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË KOMUNALE 2023-2027

prezentojmë Planin e Veprimit për Transparencë Komunale 2023-2027

Plani i Veprimit për Transparencë mundëson:

- Prezantimi i planifikimit të punëve të organeve të vetëqeverisjes lokale me sistemet e informacionit në mënyrë që puna e organeve të administratës gjatë zhvillimit të politikave të vërtetohen dhe legjitimohen;
- Përfshirjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile në mënyrë aktive dhe të vazhdueshme në hartimin dhe zbatimin e politikave në nivel lokal;
- Rezultatet e punës së komunave të jenë të matshme, cilësore dhe në funksion të interesave të përgjithshme të qytetarëve.

Plani i veprimit për transparencë në mënyrë specifike do të kontribuojë që:

- Komuna të identifikoj me kohë prioritetet për të cilat kërkohet informimi, si dhe përfshirja e qytetarëve apo grupeve të interesit në proces të hartimit të politikave dhe akteve të përgjithshme;
- Të identifikoj metodat, mjetet dhe teknikat për konsultimin e qytetarëve dhe përfshirjen e tyre në procese;
- T'i evitoj praktikatat e zhvillimit të dokumenteve dhe politikave pa respektim të procedurave ligjore lidhur me informimin dhe konsultimin e qytetarëve si dhe të evitoj praktikatat e zhvillimit të dokumenteve dhe politikave me kosto të papërbalueshme;

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKT-PLANIN E VEPRIMIT PËR TRANSPARENÇË KOMUNALE 2023-2027

- Krijimin e një mjedisi të brendshëm transparent dhe llogaridhënës, duke inkurajuar bashkëpërgjegjësi të të gjithë stafit në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe mbikëqyrjen e politikave;
- Mbajtjen e një sistemi dhe përditësim i vazhdueshëm me të dhënat e të gjitha palëve të interesit për të siguruar pjesëmarrjen e qytetarëve në pajtueshmëri me kërkesat dhe standardet ligjore;
- Ndikimin në sjelljet e punonjësve komunal në mënyrë që veprimet e ndërmarra të demonstrojnë ligjshmëri dhe integritet;



Zbatimi i Planit të veprimit për transparencë do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës dhe do të rishikohet periodikisht në përputhje me aktivitetet e komunës.

Plani do të përmbledh në mënyrë të qartë transparencën e organeve komunale, publikimin e akteve nënligjore, rregulloret komunale, dokumentet strategjike, vendimet e kryetarit, njoftimet për aktivitetet e komunës (ekzekutivit dhe kuvendit të komunës), takimet publike, planifikimin dhe shpenzimet buxhetore të komunës, prokurimin publik, zbatimin e standardeve të konsultimit publik, qasjen në dokumentet publike etj.

Transparenca si parim i qeverisjes së mirë

Në një sistem demokratik funksional, informimi dhe përfshirja duhet të jenë segment vital i administrimit publik. Transparenca është komponentë kryesore e qeverisjes demokratike, e cila kërkon një hallkë të gjerë të veprimeve institucionale, si në procesin e hartimit të politikave ashtu

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKT-PLANIN E VEPRIMIT PËR TRANSPARENÇË KOMUNALE 2023-2027

edhe në fazën e zbatimit dhe raportimit. Rëndësia e transparencës ndikon në aspekte të shumta duke përfshirë qëndrueshmërinë ekonomike, financiare, qeverisjen e mirë, si dhe në sistemin e përgjithshëm të administratës shtetërore. Parimi i publicitetit dhe transparencës supozojnë se çdo kush ka të drejtë të dijë arsyet e nxjerrjes së një vendimi të caktuar apo veprimi të administratës. Përmes këtij parimi mundësohet hapja e administratës para shoqërisë, informimi për punën e saj mund të bëhet në mënyrë të ndryshme dhe në vëllim të ndryshëm, parim që mund të kufizohet vetëm në rastet e caktuara në legjislacionin e secilit vend. Të qenurit i hapur dhe transparent janë gjithashtu instrumente të nevojshme për shtetin e së drejtës, barazinë para ligjit, dhe përgjegjshmërinë. Si rregull i përgjithshëm, sjellja e administratës publike duhet të jetë transparente dhe e hapur, megjithëse të dhënat personale nuk duhet t'i lejohen palëve të treta.

Transparenca është një nga çështjet më me peshë në procesin e demokratizimit të shteteve dhe qeverisjes së mirë. Këtë e mundësojnë mekanizmat dhe iniciativat e qeverisjes së hapur, të cilat bëjnë që përfitimet e transparencës të jenë në shumë aspekte, përfshirë: qeverisje më e mirë, vendimmarrje më cilësore, besim më të madh publik, ulje të korrupsionit dhe shërbime publike më efektive.

Transparenca përfshin rregullat mbi të drejtat e krijimit, ruajtjes, qasjes dhe përpunimit të informacionit, të cilat mund të shfrytëzohen gjatë proceseve të vendimmarrjes, por edhe për nevoja të informimit të përgjithshëm. Për më tepër, në kuptim më të gjerë transparenca nuk është vetëm informim, por përfshinë një varg procesesh dhe veprimesh të bazuara në: informacion, komunikim, pjesëmarrje, angazhim, ndërtim të konsensusit për zgjidhjen e problemeve, raportim dhe llogaridhënie.

A ka dikush ndonjë koment rreth këtij Plani?

Nëse jo ju faleminderit për pjesëmarrjen tuaj!

Konsultimi përfundoi në orën: 10:30

**PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKT-PLANIN E VEPRIMIT PËR
TRANSPARENCË KOMUNALE 2023-2027**

Blerta Gashi

Zyrtare përgjegjëse për koordinimin e konsultimeve publike

THE UNIVERSITY OF CHICAGO



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Zyra për Informim

Data/Date:	13.12.2022
Nga/Od/From	Grupi punues
Për/Za/To:	Smajl Latifi, kryetar i Komunës
CC	Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Rahovecit, Defrim Kafexhiu
Tema/Subjekat/Subject	Raporti për ecurinë e hartimit të Projekt-Planit për Transparencë Komunale 2023-2027- komentet dhe trajtimi i tyre nga grupi punues

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në komuna me theks nën 5. Zbatimi i standardeve të konsultimit publik dhe nën 17 Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

Me 13.10.2022, kryetari i komunës, Smajl Latifi ka formuar grupin punues për hartimin e Projekt-Planit për Transparencë Komunale 2023-2027.

-Grupi punues është në këtë përbërje: Blerta Gashi, kryesuese; Qemajl Krasniqi, anëtar; Skender Hamza, anëtar; Dafina Gashi, anëtare; Mirsad Shala, anëtar; Senad Mullavda, anëtar; Ekrem Bytyqi, anëtar; Petrit Haxhijaha, anëtar; Përfaqësuese nga SHL "Kosova".

Takimet

-**Me 21.10.2022**, është mbajtur takimi i **parë** i grupit punues i udhëhequr nga kryesuesja e grupit, Blerta Gashi dhe në pjesëmarrje të të gjithë anëtarëve tjerë. U prezantua Plani i cili veç përmes MAPL, Asociacionit dhe kolegjiut të zyrtarëve të informimit ishte punuar në disa punëtori ku i ishte dhënë forma finale.

KONSULTIMI PUBLIK

Konsultimi publik u hap më 02.11.2022.

Publikimi në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe Platformën e Konsultimeve Publike

Plani u publikua në këtë link në faqen zyrtare: <https://kk.rks-gov.net/rahoec/category/konsultime-publike-al/plane-konsultime-publike/>

Njoftimi për konsultim publik <https://kk.rks-gov.net/rahoec/wp-content/uploads/sites/23/2022/11/Njoftim-publik-Plani-i-Transparences.pdf>

Në Platformën e Konsultimeve Publike <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41592>

Publikimi në facebook:

<https://www.facebook.com/rahoeckomuna/posts/pfbid02AVGLnkhTKGEGNcR9AaxuV1Q2r562WmTxmmehakvy2W8D6xLPYmpRAsFuph3EiThal>

KONSULTIMI PUBLIK ME QYTETARË

Më datë: 16.11.2022 mbahet konsultimi publik në sallën e Kuvendit Komunal. Të pranishëm kanë qenë zyrtarë komunal, kryetarët e këshillave të fshatrave, drejtorë të shkollave, përfaqësues të OJQ-ve, dëshmi janë listat e nënshkrimeve.

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në vegëzën: <https://www.facebook.com/rahoeckomuna/posts/pfbid0pm53iAhax22MA1YZCYSNVT9Utr4WfU19rhoz2V21xbZSrfRV2pkLWyzSwrhGWPRl>

Në ueb faqe <https://kk.rks-gov.net/rahoec/news/200049286-2/>

Konsultimi publik filloi në orën 10:00.

Konsultimin e shpalli të hapur Blerita Gashi-Zyrtare për Informim

Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
1. Nuk pati asnjë koment	
2.	
3.	
4.	
5.	

Komentet – Janë dhënë gjithsej 0 komente

Tema	Zyra	Pjesëmarrës	Vendi Data	Komentet	1.Njoftimi 2.Lajmi 3.Procesverbali
Projekt-Plani për Transparencë Komunale 2023-2027	Zyra për Informim Zyra e Kuvendit	F 0 M 7 T 7	Salla e Kuvendit	0 komente	1. https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/11/Njoftim-publik-Plani-i-Transparences.pdf 2. https://www.facebook.com/rahoveckomuna/posts/pfbid0pm53iAhax22MA1YZCYSNVT9Utrr4WfU19rhoz2V21xbZsSrfRV2gkLWyzSwrhGWPRl 3. https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/12/PROCESVERBAL-I-KONSULTIMIT-PUBLIK-PER-PROJEKT-PLANIN-E-VEPRIMIT-PER-TRANSPARENCE-KOMUNALE-2023-2027.pdf

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

1. Vendimi për caktimin e grupit punues për hartimin e planit
2. Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik
3. Listat e nënshkrimeve të anëtarëve në takimet e mbajtura
4. Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik
5. Lista e zyrtarëve pjesëmarrës në konsultimin publik

Blerita Gashi

Zyrtare për Informim

Zyrtare për menaxhimin e Platformës për Konsultime Publike



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahotac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Dr./No 30 Nr. i faq./Br.str./No.pg 97
Data/Datum/Date 11 / 1 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 11, nenit 13 dhe nenit 58 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008”), nenit 12, nenit 74 paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit i:

PROPOZON

Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Taksa Komunale 01 Nr. 80/20 e datës 29.06.2020, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren 01 Nr. 169/21 të datës 26.02.2021

Neni 1

Neni 7 paragrafi 1 pika 18 largohet nga teksti bazik i Rregullores për Taksa Komunale.

Neni 2

Neni 10 paragrafi 1 i Rregullores bazike, pas pikës 15 shtohet pika 16, me tekstin si në vijim:

16. Referencat për Operatorët Ekonomik për projekte të përfunduara - Taksa 50€.

Neni 3

Neni 11 paragrafi 1 pika 4 dhe 24 largohen nga teksti bazik i Rregullores për Taksa Komunale.

Neni 4

Neni 17 paragrafi 4 i Rregullores bazike, shuma “600€” zëvendësohet me shumën “500€”.

Neni 17 i Rregullores bazike, pas pikës 8 shtohet pikat 9, me tekstin si në vijim:

9. Dhënia e vërtetimit për taksa afariste – Taksa 5€.

Neni 5

Neni 20 i Rregullores bazike, pas fjalës “tokës” i shtohet fjala “(pronës)”.

Neni 6

Neni 21 paragrafi 1 i Rregullores bazike, Nr. 0899 shuma “500€” zëvendësohet me shumën “1000€”.

Neni 7

Neni 24 paragrafi 1 pika 7 e Rregullores bazike, riformulohet me tekstin si në vijim:

Vërtetimet sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHk) (lloji i destinimit të tokave të tjera).

Neni 8

Neni 27 i Rregullores bazike ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

1. Taksat e Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë të përcaktuara sipas udhëzimeve Administrative, për Tarifat e Produkteve Kadastrale të Ofruara nga Zyrtat Kadastrale Komunale dhe Tarifat për Shërbimet e Gjeodetëve dhe Kompanive Gjeodete të Licencuara sipas Udhëzimit Administrativ MMPH – Nr. 11/19 për ndarjen e ndërtesës dhe të pjesës së ndërtesës dhe Udhëzimit Administrativ MMPH – Nr. 12/19 për ndarjen dhe regjistrimin e parcelës

Nr.	Kategoria	Taksa
NDËRRIMI I KULTURAVE TË PARCELAVE		
1	Përgatitja e raportit për ndërrimin e kulturës së një parcele pa matje gjeodezike	10€
PUNËT E VEÇANTA GJEODEZIKE		
2	Bartja - piketimi në terren i të dhënave nga planet urbanistike për objekt individual	1.00€ për m ²
3	Bartja – piketimi në terren i të dhënave nga planet urbanistike për objekte banimi kolektiv apo afarist	1.50€ për m ²
4	Identifikimi i njësive kadastrale në zyrë	10€
5	Identifikimi i njësive kadastrale në terren	30€
6	Konsulta profesionale	10€ për një orë
DHËNIA E INFORMATAVE NGJA SISTEMI I INFORMACIONEVE KADASTRALE TË TOKAVE TË KOSOVËS NGJA ZKK		
7	Vertetim që personi nuk posedon pronë.	3€
8	Certifikata e pronësisë (deri në dhjetë faqe shënime të shtypura)	4€
9	Certifikata e pronësisë (mbi dhjetë faqe shënime të shtypura)	20€
10	Kopja e planit	4€
11	Kopje në formatin A3 me ortofoto (bardhë e zi)	4€
12	Kopje në formatin A3 me ortofoto (kolor)	5€
13	Historiati për një njësi kadastrale	20€
BAZA GJEODEZIKE		
14	Pikat trigonometrike: Koordinatat Y, X, H, me përshkrim	5€
15	Pikat lidhëse: Koordinatat Y, X, H, me përshkrim	4€
16	Pikat poligonale: Koordinatat Y, X, H, me përshkrim	3€
17	Pikë e nivelimit: Koordinatat Y, X, H, me përshkrim	5€
18	Pikat në linjë: Koordinatat Y, X, H	2€
19	Pikat e detajit Y, X,	1€
TË DHËNAT NË FORMËN DIGJITALE		
20	Parcela në format digjital (shpfile, dwg, gml, ili) deri në 1 ha-sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar)	10€
21	Parcela në format digjital (shpfile, dwg, gml, ili) mbi 1 ha deri 2 ha- sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar)	20€
22	Parcela në format digjital (shpfile, dwg, gml, ili) mbi 2 ha deri 5 ha- sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar)	40€

23	Parcela në format digjital (shpfile,dwg, gml, ili) mbi 5 ha- (sipas kërkesës së palës, pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar)	60€
24	5. Ndërtesa në format digjital (shpfile, dwg, gml, ili) sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar)	5€
25	6. CD—kompakt disku	0.50€
26	7. Kontrollimi dhe rregjistrimi në rregjistrer të të dhënave nga tereni – për njesi kadastrale	20€

2. Udhëzimi Administrativ (MEA) NR. 09/2020 për tarifat e shërbimeve për regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme.
3. Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 05/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ (MEA) Nr. 09/2020 për tarifat e shërbimeve për regjistrimin e të drejtave e pronave të paluajtshme.

Nr.	Shërbimi	Taksa
Regjistrimi i të drejtës së pronësisë në bazë të vlerës së transaksioneve		
1	Për vlerën e transaksionit deri në 10.000 €	30€
2	Për vlerën e transaksionit prej 10.000 € e deri në 50.000 €	50€
3		
4	Për vlerën e transaksionit prej 50.000 € e deri në 100.000 €	70€
5	Për vlerën e transaksionit prej 100.000 € e deri në 200.000 €	90€
7	Për vlerën e transaksionit prej 200.000 € e deri në 500.000 €	120€
13	Për vlerën e transaksionit mbi 500.000 €-e deri në 1.000.000€	240€
14	Për vlerë e transaksionet mbi vlerën mbi 1.000.000€	500€
15	Për vlerën e kontratës-transaksionit që është vërtetuar para vitit para vitit 1999	50€
16	Lirohen nga pagesa rastet kur keni të bëjmë me reregjistrim të pronave të paluajtshme në kadastrë	
Tarifa e regjistrimit të pronësisë në bazë të kontratë mbi dhuratën		
30	Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratë së dhurimit për qdo anëtar të ngushtë të familjes është:	30€
31	Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratë së dhurimit për personin që nuk është anëtar i familjes dhe që nuk i është caktuar vlera e pronës tarifa është:	80€
32.	Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës për dhurimin e pronës së paluajtshme, në të cilën është caktuar vlera e pronë dhe dhuratmarrës nuk është anëtar i familjes zbatuhet tarifa sipas nenit 5 të këtij Udhëzimi Administrativ (09/2020)	
Tarifa e regjistrimit të pronësisë apo të drejtave tjera sendore në bazë të titullit juridik të organeve administrative dhe gjyqësore		
30	Tarifa për regjistrimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën e paluajtshme apo të drejtave tjera sendore në bazë të vendimit të organit administrativ apo gjyqësor për çdo person është:	30€

Tarifa për regjistrimin e bashkëpronësisë apo pronësisë së përbashkët		
35.	Tarifa për regjistrimin e të drejtës në bashkëpronësi apo pronësi të përbashkët për bashkëpronarin apo pronarin e përbashkët është:	30€
36.	Tarifa për regjistrimin e të drejtës në pronësi të përbashkët për bashkëshortët për një titull juridik është:	30€
37.	Tarifa për regjistrimin e njësive kadastrale si pjesë e ndërtesës për njësi është:	25€
38.	Tarifa për regjistrimin e njësive kadastrale të krijuar nga ndarja apo bashkimi për njësi është:	20€
39.	Lirohet nga tarifa për regjistrimin e pronësisë së përbashkët të ndërtesave kolektive në bashkëpronësi.	
40.	Lirohet nga tarifa për regjistrimin e hapësirave të përbashkëta si njësi të veçanta.)	
Tarifa e regjistrimit të pronësisë në bazë të trashëgimisë dhe të shkëputjes së bashkësisë familjare		
37.	Tarifa për çdo trashëgimtar për regjistrimin e pronësisë në bazë të trashëgimisë është:	10€
38.	Tarifa për çdo trashëgimtar për regjistrimin e pronësisë në bazë të trashëgimisë, e cila rrjedh nga testamenti është:	20€
39.	Tarifa për regjistrimin e pronësisë në bazë të shkëputjes së bashkësisë familjare për çdo anëtarë të familjes që bëhet pronar është:	20€
Tarifa e regjistrimit të ndarjes së bashkëpronësisë apo pronësisë së përbashkët		
38	Tarifa për regjistrimin e pronësisë në bazë të ndarjes nga bashkëpronësia apo pronësia e përbashkët për secilin bashkëpronar që bëhet pronarë individual është:	30€
39	Lirohet nga tarifa për regjistrimin e ndarjes nga bashkëpronësia sipas nenit 6 parag. 3 dhe 4 i Udhëzimit Administrativ Nr. 12/19 për Ndarjen dhe Regjistrimin e Parcelës.	
Tarifat e regjistrimit të pronësisë në bazë të ndërrimit/këmbimit të pronës së paluajtshme		
	Tarifa për regjistrimin e pronësisë në bazë të ndërrimit këmbimit të pronës së paluajtshme për secilin pronar	40€
Regjistrimi i hipotekave		
38	Kërkesë (kredia) në vlerë deri në 30000 €	20€
40	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 30.000 € e deri në 50.000 €	30€
41	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 50.000 € e deri në 100.000 €	60€
42	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 100.000 € e deri në 200.000 €	90€
43	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 200.000 € e deri në 500.000 €	120€
46	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 500.000 € e deri në 1.000.000 €	240€
52	Kërkesë (kredia) në vlerë prej mbi 1.000.000€	400€
Tarifat për modifikimin dhe fshirjen e hipotekës		
	Tarifa për modifikimin e hipotekës së regjistruar është:	10€
- 5) Taksa komunale për bllokimin e rrugëve sekondare, ku bëhet diferencimi kur bëhet për nevojat e personave fizik apo juridik;
- 6) Taksa komunale për shfrytëzimin e përkohshëm të objekteve komunale ku bëhet një kategorizim i përgjithshëm për këtë qëllim. Komunitat, merrte parasysh specifikat e objekteve që kanë, mund të bëjnë një kategorizim me të hollësishëm për shfrytëzimin e këtyre objekteve.
- 7) Taksa komunale për shfrytëzimin afatgjatë të pronës së paluajshme komunale si pasojë e

dhenie se pronës komunale në shfrytëzim. Edhe këtu trajtimi është i përgjithshëm dhe Komunitat mund të bëjë një trajtim më specifik, bazuar në pronat që i kanë.

- 8) Taksa komunale për qëndrim në institucionet parashkollore të fëmijëve;
- 9) Taksa komunale për mbajtjen kafsheve shtëpiake; dhe
- 10) Taksa komunale për kullosa.

1. Gjobat

Bazuar në dispozitat e Ligjit për Kundërvajtje, *Model Rregullorja* ka përcaktuar veprimet që konsistojnë kundërvajtje dhe ka përcaktuar gjoba, që ndërlidhen me mos pagesën e taksave komunale në afat të përcaktuar në këtë Rregullore. Lartësia e gjobave të përcaktuara janë në kuader të kufijve që përcakton ky Ligj dhe mendohet se janë proporcionale me veprimet. Po ashtu, mundësia e pagesës së gjobës brenda një afati të shkurtër në vlerë prej 50% të gjobës së shqiptuar, synon eliminimin e procedurave ankimore lidhur me gjobat, të cilat janë të garantuara për palët.

2. Transparenca dhe efektiviteti

Për dallim nga shumë Rregullore Komunale, *Model Rregullorja* nuk ka paraparë që taksat e përcaktuara nga niveli qendror të jenë pjesë integrale të saj. Këto taksa janë listuar në Shtojcën Nr. 2 të këtij modeli dhe është paraparë që ky dokument të jetë i gjallë, nëpërmjet mekanizmit të përditësimit nga një vendim i Kryetarit të Kuvendit. Po ashtu, të gjitha taksat komunale janë listuar në Shtojcën Nr. 1 të *Model Rregullore* dhe kjo do të jetë ndihmesë për zyrtarët teknik që zbatojnë keto dispozita.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/169 Nr ifaq/Br.sht/Na pa 01

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (a) dhe (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 10 paragrafi 2 pika 2.3, nenit 12, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.1 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Propozimit të Kryetarit të Komunës me 02 Nr.052/21 të dt. 09.02.2021, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt. 26.02.2021 miraton këtë:

RREGULLORE

Për

Ndryshimin dhe Plotsimin e Rregullores për Taksa Komunale 01 Nr. 80/20 e datës 29.06.2020

1. Kuvendi i Komunës së Rahovecit miraton Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin Rregullores për Taksa Komunale 01 Nr. 80/20 të datës 29.06.2020.
2. Nenit 30 të Rregullores së cekur në pikën 1 i shtohet paragrafi 7 me tekstin si në vijim:

30.7. Të gjitha Bashkësitë Fetare dhe OJQ-të që operojnë në Komunën e Rahovecit lirohen nga pagesa e taksës komunale mbi parkimin e automjeteve të parapara në paragrafin 3 të këtij neni.

3. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për Taksa Komunale do të jetë pjesë e tekstit bazë të Rregullores në fuqi.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për Taksa Komunale hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Të njoftohen:

- MAPL, dhe
- Arkivi.

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01-Nr.169/21

Data: 26.02.2021





P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e rregullt e kuvendit komunal të Rahovecit, e mbajtur më **28.12.2022 (E mërkure)** me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit **z. Defrim Kafexhiu**. Konstatoi se ka kuorum për mbajtjen e mbledhjes..

Kryesuesi – Fillimisht, përshëndetje për të gjithë. I nderuar nënkryetar i komunës **z. Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të kuvendit komunal, drejtorë të drejtorive komunale, media, të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit, kjo është seanca e dymbëdhjetë (12) për këtë vit kalendarik. Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me 16 dhjetor, për këtë seancë ka përgatitur këtë

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi i raportit mbi realizimin e planit për vitin 2022 si dhe informatë mbi Planin vjetor të prokurimit publik 2023;
4. Shqyrtimi i Raportit të Punës të Kryetarit të Komunës për vitin 2022;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për Planin e Punës të Kryetarit të Komunës së Rahovecit për vitin 2023;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për Planin e Punës të Kuvendit Komunal për vitin 2023;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për Planin e Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2023;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për Planin e Vlerësimit të Rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për Planin e Transportit Rrugor 2022 – 2027;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për Planin e Mobilitetit Urban 2022 – 2027;
11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2023;
12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e Simbolit Përkujtimor të Gjenocidit në Kosovë;
13. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.263/22, i datës: 25.01.2022, për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
14. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen në interes të përgjithshëm të parcelës P-01041-1 – në zonën kadastrale Xërxë;
15. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 338/22 i datës 29.06.2022 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër;
16. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 341/22 i datës 29.06.2022 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;

17. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit mbi regjistrimin dhe vlerësimin e dëmeve në amvisëri, ekonomi familjare dhe biznese, të shkaktuara nga vërshimet e shiut me datë 17 shtator 2022;

18. Informatë rreth gjendjes në terren pas të reshurave të fundit në territorin e komunës së Rahovecit.

Pikat shtesë;

~ *Plotësim-ndryshimi i vendimit 01 Nr.264/22 i datës 25.01.2022 për themelimin e Komitetit për Komunitete;*

~ *Plotësim-ndryshimi i vendimit Nr.392/22 i datës 25.11.2022 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.*

Kryesuesi – Para rendit të ditës e kemi edhe një pikë shtesë, dhënien e betimit të anëtares më të re të kuvendit, Dafina Gashi.

Dafina Gashi – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. “Unë Dafina Gashi, betohem se do t’i kryej me nder, besnikëri, paanime, me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat, do t’i ushtroj autorizimet e mia si anëtare e kuvendit të komunës së Rahovecit, në mënyrë që të sigurohet kushtet për jetë të qetë për të gjithë”

Burim Krasniqi – Përshëndetje kryesues, nënkryetar, drejtorë, kolegë asambleistë. Pika 9 dhe 10, Transporti Rrugor dhe Plani i Mobilitetit nuk konsideroj që kanë vend në një seancë me kaq shumë pika (18) sepse me 28 dhjetor të aprovet plani i transportit dhe i mobilitetit për vitin 2022-2027 nuk ka logjikë, na kthehet pas, duhet të jetë 2023-2027. Propozoj të tërhiqen këto dy pika për seancën e radhës në janar.

Përparim Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë. Burim, janë afate ligjore që nuk mundemi t’i ikimi. Kemi pyetur edhe në MPL, vendimi që merret në datë të caktuar, llogaritet si vit paraprak, vendimi llogaritet prej sot.

Burim Krasniqi – Para 4-5 muajve MPL n’a ka kthyer një vendim sepse e kemi llogaritur 2022, kanë thënë që duhet 2023, sepse 2022-ta mbyllet. Planet duhet të jenë 2023-2027. Kryesues, të kërkoj ta vendosësh propozimin në votim.

Përparim Krasniqi – Burim, je gabim. Nuk ka qenë viti 2022, por 2021. MPL ka kërkuar të jetë 2022-2027 (periudha 5 vjeçare).

Kryesuesi – Propozimin e Burim Krasniqit po e vendosim në votim, për largimin e pikave 9 dhe 10 nga rendi i ditës, kush është për?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë pikat shtyhen për seancën, meqenëse kemi shumë volum në këtë seancë (me 14 vota për, 13 kundër).

Kemi edhe dy pika shtesë nga ekzekutivi;

~Plotësim-ndryshimi i vendimit 01 Nr.264/22 i datës 25.01.2022 për themelimin e Komitetit për Komunitete;

~Plotësim-ndryshimi i vendimit Nr.392/22 i datës 25.11.2022 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Kush është për?... Me shumicë unanime shtohen edhe këto dy pika në rend dite.

Rumir Zhuniqi – Faleminderit kryesues. Një njoftim; Pas dhënies së dorëheqjes nga Besmire Bytyqi (shefja e grupit të asambleistëve të AAK-së), AAK-ja do të përfaqësohet nga Hasan Përboqi. Drejtoreshës së re i urojmë suksese në emër të grupit.

Kryesuesi – Atëherë i urojmë suksese Hasanit dhe Besmires. Po e vendosim miratimin e rendit të ditës në votim, kush është për?... Me shumicë unanime miratohet rendi i ditës për seancën e sotme.

1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi – A ka dikush diqka rreth procesverbalit?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë unanime aprovet procesverbali i mbledhjes së kaluar.

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Siç e dini në disa vendbanime të komunës së Rahovecit ka pasur vërshime dhe dëme të mëdha. Jam i informuar që komuna ka formuar komisionin për vlerësimin e dëmeve. Kam disa kërkesa nga shumë qytetarë. Disave prej tyre nuk iu kanë kompenzuar dëmet, ku qëndron problemi?... Pse disa bujqë nuk janë kompenzuar për dëmet nga vërshimet, dëmi është faktik, dhe çka do të ndodh më pas?

Burim Krasniqi – E kam të njëjtën çështje që e kam ngritur në seancën e fundit, për Drejtorinë e Urbanizmit. Fjala është për gërmimin ose fillimin e procedurave për marrjen e gurit mbi rrugën Rahovec-Suharekë. Bujqit dhe banorët e asaj zone kanë shprehur shqetësim të madh. Me 18.12.2018, Drejtoria e Urbanizmit me vendimin 266 jep një përgjigje dhe në fund thotë: Zona sipas PZHK-së është e destinuar si zonë me prioritet për bujqësi dhe pyje, jo prej marrje të gurit. Përkundër kësaj, me 21.04.2019, kompania në fjalë ka arritur të sigurojë një pëlqim prej Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për nxjerrje dhe shfrytëzim të gurit. Me 15.02.2020 ka qenë një parashtesë për kundërshtim që 61 banorë të zonës me nënshkrim iu kanë drejtuar komunës dhe kanë kërkuar që mos të lejohet gërmyesi. Përgjigja ishte kjo: Duhet theksuar se kjo parashtesë nuk është hartuar në formën e duhur ligjore dhe është mjaftë e pakuptueshme si dhe është e pa noterizuar te noteri. Në anën tjetër e kemi një vendim që Drejtoria e Urbanizmit e ka lejuar kompaninë të marrë gurin e thyer dhe është në kundërshtim me vendimin e vet që thotë që zona është e destinuar për pyje. Vendimi i fundit thotë që nuk lejohet vendosja e makinerisë, por nuk e ndalon marrjen e gurit. Si e shih komuna skenarin e kësaj çështje?... Nëse është nevoja e një vendimi të asamblesë komunale për moslejimin apo lejimin e shkeljes së PZHK-së, vendose në asamble dhe e votojmë.

Fahrije Lushi – Faleminderit kryesues, të nderuar gjithë të pranishmit. Me 29 mars 2021 nga ky kuvend është nxjerrë një vendim për subvencionimit dhe mbështetjen e të gjitha grave dhe nënave të komunës tone, pa marrur parasysh se ku lindin ato, jo vetëm në QKMF në Rahovec. Çka nëse kryetari nuk i ka subvencionuar të gjitha gratë brenda saj periudhe?... Nga ky vit është sjellë një propozim i ri që nënat dhe gratë që lindin në QKMF në Rahovec, do të subvencionohen me nga 300euro, ky vendim është mirë që nuk e ka marrë mbështetjen sepse dikush edhe për qejf mund të shkojë për lindje jashtë Rahovecit. Kërkoj nga kryetari sqarim.

Kryetari – Përshëndetje për kryesuesin, nënkryetarin, drejtorët, anëtarët e kuvendit. Nuk isha këtu nga fillimi, më vjen keq që dy pika të rendit të ditës janë hequr, ato janë plane që i kanë kaluar të gjitha procedurat dhe janë dokumente të rëndësishme. Burimi ka paraqitur shqetësimin e një gërmyesi. Ka skaduar ajo kontratë d.m.th nuk është i njëjti operatorë, ndërkohë është paraqitur dikush tjetër të operojë në atë zonë dhe urbanizmi jonë e ka lëshuar një vendim që e ka përcaktuar përkatësinë e pronës. Operatori ka vazhduar me punën e tij, të nxjerrë licencën prej Këshillit të Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe ka ardhur një moment kur ai ka kërkuar leje pune-ndërtimi, kuptohet Drejtoria ia ka refuzuar kërkesën. Vendimi është i këtij viti që aty nuk mund të opertohej tutje, as me shpime as me vendosje të makinerive. Ajo mund të bëhet edhe zonë ndërtimore, por jo e dedikuar për gërmyesi sepse konsiderohet e papërshtatshme për veprimtari të tilla. Ky vendim do të zbatohet edhe në atë moment kur bëhet ndonjë vendim tjetër të ri, për të cilin nuk ka asnjë argument. Kjo është situata reale.

Vendimi i subvencionimit të lehonave vlen për një vit dhe është në përgjegjësinë e kryetarit të komunës t'i subvencionojë gratë të cilat lindin në Rahovec dhe në i subvencionojmë me 300euro. Qeveria e Republikës së Kosovës i subvencionon që lindin kudo në Kosovë. Megjithatë në maternitetin e Rahovecit ka kushte të mira, ka raste që edhe prej Malishevës vijnë të lindin në Rahovec. Subvencionimi do të vazhdojë edhe në vitin e ardhshëm me kompetencë të kryetarit të komunës duke u mbështetur në ligj.

Burim Krasniqi – Janë 3 vendime të Drejtorisë së Urbanizmit në periudha të ndryshme kohore; 266 (18.12.2018), 296 (18.12.2019), 09 (17.01.2022). Vendimi i parë thotë: Kjo zonë është e destinuar me prioritet për bujqësi dhe

pyje. Vendimi i dytë: Vërtetimi i lëshuar vlen për shfrytëzimin për investimin e shfrytëzimit të gurit dhe nuk përdoret për qëllime të tjera. Vendimi i tretë: Refuzohet kërkesa e kompanisë, për dhënien e pëlqimit për vendosjen e makinerisë për thermosje dhe separim, jo edhe makinerisë për gjermim, i bie që kjo nuk e ndalon gjermimin. Nga inspektoriati, kërkoj verifikimin se është duke vazhduar shpimi apo jo?

Albnor Mullabazi – Faleminiderit kryesues. I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë, asambleistë. Burim, më 22.10.2022 ka qenë Inspektoriati i Agjencisë Pyjore në komunën e Rahovecit. Ka dalur në terren dhe i ka marrur lëndët. Vërtetimi i 2019-tës tregon gjendjen e tokës sipas PZHK-së. Komuna e Rahovecit nuk lëshon leje, të gjitha këto procedura i kryen Agjencioni Pyjor. Personi në fjalë ka marrë leje mjedisore në Ministri të Mjedisit. Inspektoriati ka dalur në terren dhe ka vërtetuar që edhe kjo leje mjedisore është lëshuar gabimisht. Vendimi i 2022, ka ardhur pas kërkesës për vendosjen e makinerisë, nuk ka qenë kërkesa për ushtrim të veprimtarisë. Të njëjtën e kemi refuzuar.

Fahrije Lushi – Fjalët që kryetari i përmendi: agjitacionet, mashtrimet e propagandat, asnjëherë LDK në kuvend nuk i ka bërë. Në anën tjetër, nuk është në karakterin tim personal të jem kundër atyre grave që kryetari me kompetencë të tij i subvencionon. Por, çka nëse ajo grua është nga Ratkoci ose Malësia e vogël dhe detyrohet të lind në Gjakovë? A është edhe ajo taksapaguese e komunës së Rahovecit?

Kryetari – Unë e përdora termin “gratë që kanë gjendje të zakonshme, të mirë shëndetësore” dhe kanë mundësi të shkojnë për lindje në maternitetin në Rahovec, mirë është të shkojnë aty. Për raste tjera të lindjes që mund të jetë e komplikuar, atëherë ato mund të shkojnë edhe diku tjetër. Qëllimi i vendimit për subvencionim ka të bëjë me atë që ta forcojmë maternitetin në Rahovec dhe nuk bëhet fjalë as për ndarje as për diskriminim të grave. Burim Krasniqi po i përgjigjem: Është një kërkesë për vendosjen e makinerive, nuk e dijmë a janë makineri për gjermim, hulumtim, minim, apo pajisje për thyerje. Por, fakti që vendimi taksativisht thotë që: Nuk keni të drejtë të vendosni pajisje aty. Përndryshe, drejtori Albnor Mullabazi e tha qartë që është pronë që menaxhohet nga Agjencioni Pyjore e Republikës së Kosovës.

Sejfullah Sejfullahu – Përshëndetje kryesues, kryetar, drejtor, të gjithë. Ne si Krushe jemi mbi 7 mijë banorë, investime janë bërë pak. Po dalim te heqja e kodeve nga qeveria për dy investime që kanë pasur të ndodhin. Pa hyrë në detaje, e kam një propozim: Në Krushë të Madhe ka vend të mjaftueshëm, t’i përdorim të gjitha mekanizmat, kryetarin, Visarin, Avdullah Hotin, Yllza Hotin dhe ta bëjmë një kërkesë, ta ndërtojmë një stadium në Krushë të Madhe, që derisa të bëhet zgjidhja për stadiumin e qytetit, klubet e Rahovecit le të vijnë t’i zhvillojnë ndeshjet në Krushë (10km larg). Në fund, stadiumi i mbetet Krushës.

Vlora Vuçiterna – Çmega – Përshëndetje për të gjithë. Rreth lindeve të grave në Rahovec: Kryetar, si mendon t’i inkurajosh gratë të lindin në maternitetin e Rahovecit përderisa ky maternitet nuk i plotëson kushtet. Gjinekologë joçdoherë ka të pranishëm, Neunatolog nuk ka dhe mos të harrojmë që kemi të bëjmë me dy jetë dhe jo vetëm me jetën e nanës.

Edona Kryeziu – Përshëndetje i nderuar kryetar. Kryesues, faleminiderit për mundësinë e fjalës. Të nderuar të pranishëm, sot, dua ta ngrisë shqetësimin e disa prej banorëve të fshatit Xërxë te qendra grumbulluese të frutave dhe perimeve ish matrks. Problemi është rreth çështjes së rrugës, gjendje e vështirë dhe është një rrugë mjaftë e frekuentuar. Keq e përjetojnë fëmijët që e shfrytëzojnë këtë rrugë si alternativë më të shkurtër për të shkuar në shkollë. Kërkesë e banorëve është që të bëhet rregullimi sa më i shpejtë i mundshëm i asaj rruge dhe pastrimi kanalit aty afër.

Kryetari – Fakti është ky, Krusha e Madhe e meriton stadiumin, palestrën sportive dhe shumë investime tjera. Investime ka pasur, por nuk i kemi zgjidhur të gjitha shqetësimet e banorëve sa i përket investimeve. Vitet 2020-2021 kanë qenë vitet e pandemisë me shumë sfida. Viti 2022 është i ngarkuar me pasojat e pandemisë, me agresionin Rus, me ngritjen e çmimeve etj ... Sa i përket stadiumit në Krushë, komuna mund të bëjë diçka, nuk mund të bëjë stadium me standarde shumë të larta, por mund ta bëjë një stadium të përshtatshëm për lojë. Vlora, është e

vërtetë që ende nuk kemi Neunatolog. Poashtu është e vërtetë që në janar kemi të drejtë të hapim konkurs për rritje të personelit shëndetësor në komunën tonë. Materniteti pas renovimit është në gjendje shumë më të mirë, përkundër asaj që ka nevojë për kuadro. Lindjet që ndodhin aty deri më tani rezultojnë të suksesshme dhe nuk e di për ndonjë situatë problematike që ka ndodhur. Përsëri po them, i inkurajoj gratë që të lindin në maternitetin në Rahovec, kurse neve na mbetet që secilën ditë t'i krijojmë kushtet sa më të përshtatshme dhe sigurtë.

Sa i përket investimeve, do t'i rrijmë gati kësaj pune dhe do të kërkojmë që Rahovecit t'i rikthehen projektet e reja.

Leonard Morina – Faleminderit kryesues. Përhëndetje për të gjithë. Një pyetje për drejtorin e arsimit; Në vitin 2020 është nënshkruar një kontratë për një pako pedagogjike (furnizimi ka qenë për 3 vite, deri 2023). Te plani i prokurimit e vërejtja që janë ndarë 20.000euro edhe për vitet e ardhshme për paket pedagogjike, nëse në 2020 ka qenë 10.700euro, tani për 5 vite parashihen 20.000. Te kjo kontratë, për 5 vite parashihet ditari personal, listat e kontrollit dhe planet ditore. Sipas kësaj gjendje i bie që për 5 vite do të shkojmë në mënyrë “shabllon” me ditar personal dhe me listë të kontrollit. A do të ketë lëvizje Drejtoria e Arsimit?

Eqrem Spahiu – Faleminderit kryesues, përhëndetje për të gjithë. Kryetar, ne si Operushë kemi problem me ujë për pastrim (nuk po flas për ujë të pijshëm), nuk kemi ujë në fshatin Operushë, a do të ketë diçka për vitin 2023?

Kryetari – E vërtetë është e hidhur dhe nuk mund ta lë pa e thënë. Qeveria e Kosovës, Ministria e Ekonomisë nuk e ka dhënë asnjë cent për KRU Gjakovën për këtë vit për investime kapitale. Ju e dini që kompetencë për nisjen, menaxhimin dhe mbylljen e procedurave që kanë të bëjnë me furnizim të ujit të pijshëm i ka KRU Gjakova. Ne kemi një memorandum mirëkuptimi dhe në momentin kur KRU Gjakova ka mjete, ne jemi të gatshëm t'ia ofrojmë 49%, që realisht nuk e kemi obligim ligjor, por vetëm t'i ndihmojmë qytetarëve. Njëjtë vlenë për Operushën, Zaqishtin, Hoçën e Madhe, Senocin dhe Drenocin. Ky është pozicioni jonë parimor. Në parim i kam mbetur borxh për përgjigje Rasim Fazliut, do ta merr me shkrim edhe nga Drejtori i Bujqësisë. Të gjitha procedurat të cilat lidhen me krijimin e komisioneve, me daljen e tyre në terren, me evidentimin e dëmeve të shkaktuara në bujqësi, infrastrukturë publike, biznese, amvisëri, janë kryer me kohë nga ana jonë. Me dëmet në bujqësi kemi anomali, sepse ka dalur një udhëzim administrativ pas njëzet e sa ditësh që kanë ndodhur vërshimet dhe ky udhëzues ka nxjerrë situatë të një lufte të madhe juridike me komisionin e ankesave. E dini që 200 vetë janë përfitues dhe ata kanë filluar t'i marrin mjetet, por edhe 300 të tjerë janë të refuzuar, ka prej atyre që janë refuzuar e që janë në kufij në një zonë. Këtë situatë e kemi adresuar në mënyrën më serioze të mundshme, dje ka shkuar ankesa e fundit për 32 tjerë që janë refuzuar. Pra, jemi përfitues por kemi shumë të refuzuar. Presim përgjigje dhe informacione të kthyer nga ankesat që i kemi bërë në bashkëpunim me zyrën ligjore.

Avni Morina – Faleminderit kryesues. I nderuar kryetar, nënkryetar, anëtarë të kuvendit, drejtorë. Një përgjigje për çështjen e pakos pedagogjike. Do ta bëjmë zgjerimin e kësaj pakoje edhe për klasët e gjashta deri në klasën e dymbëdhjetë. Ky zgjerim do të bëhet prej fillimit të vitit 2023. Kjo pako pedagogjike iu shërben prej edukatorëve deri te klasët e dymbëdhjeta dhe përmban: Planet ditore, listat e kontrollit, ditarët personal, instrumentet e vlerësimit dhe elementet tjera, që janë material i nevojshëm dhe i duhur për mësimdhënësit. Pakoja 10.000euro e kemi shpenzuaq për Pakon pedagogjike prej klasës 0-5 (parafillor-klasa 5). Këto 20.000euro tjera i kemi tash për një vit (2023), sepse na duhet pakoja pedagogjike për të gjithë mësimdhënësit dhe për të gjitha ciklet.

Kryesuesi – Përhëndetje për kryetarin, nënkryetarin, anëtarët e kuvendit, drejtorë të drejtorive. Po e mbyllim një vit të parë kalendarik me plotë sfida para vetës. Si kryesues jam krenar për atë që kam dhënë në kuvend, ndoshta edhe jomjaftueshëm duke marrë parasysh potencialin që e kemi. Faleminderit për diskutimet, debatet dhe produktivitetin e treguar brenda asamblesë. Për këtë vit kalendarik, kuvendi komunal po e mban seancën e 12-të, poashtu ka mbajtur edhe 11 mbledhje të KPF-së, 5 të Komunitetit të Komuniteteve, 3 mbledhje të Komitetit për Arsim dhe 3 të Komitetit për Shëndetësi. Në këto 12 seanca të rregullta të kuvendit pa e përfshirë seancën e sotshme, kuvendi ka miratuar 85 vendime. Ju falenderoj të gjithëve për bashkëpunimin dhe ju ftoj për reflektim kundrejt kërkesave, propozimeve dhe kritikave që vijnë nga anëtarët e kuvendit. Kohëve të fundit ishim pjesë e një debati që për

mendimin tim ka qenë i panevojshëm dhe pa ndonjë të arritur, ku tentimi i faturimit i përgjegjësisë te niveli qëndror është i paqëndrueshëm dhe irrelevant sidomos kur të vie prej asamblesë komunale. Koha do ta dëshmojë që zotimet publike nga qeveria qëndrore do të finalizohen, duke përfshirë kodet (Stadiumin e Qytetit dhe Qendrën Multifunkionale). Në emrin tim, iu uroj një fundvit të bukur dhe fillimvit të mbarë për të gjithë. I uroj veteranët e luftës, familjet e dëshmorëve dhe të gjithë atyre që dhanë kontribut që ne sot këto festa t'i festojmë të lirë. Urime 2023-ta. Vazhdojmë me pauzë deri në orën 13:00 ...

Kryesuesi – Po vazhdojmë me seancën. Një lutje për shefat e grupeve që t'i rrijnë gati anëtarëve të tyre të partisë, që të mos vonohen në mbledhje.

Hasan Përboqi – Faleminderit kryesues. Në emër të grupit të asambleistëve të aleancës, kërkojmë rikthimin dy pikave që janë larguar nga rendi i ditës (pika 9 dhe 10). Ne si grup e konsiderojmë që këto pika janë larguar pa arsye të qëndrueshme, por vetëm që dikujt i “teket”.

Kryesuesi – Faleminderit Hasan. Pavarësisht formës së mëhershme të largimit të këtyre dy pikave, ka marrë mbështetjen e kuvendit. Arsyeja ka qenë volumni i madh i rendit të ditës.

Lirigzon Kastrati – Faleminiderit. Propozuesi i këtyre dy pikave është shefi i grupit të asambleistave të LDK-së, i cili me plotë arsye e tha që këto pika duhet të shtyhen në seancën e radhës duke kërkuar trajtim të veçantë të pikave në fjalë.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues. Mendoj që ka qenë mungesë komunikimi mes vete. E kam mbështetur në formën e asaj që ka shumë pikë për diskutim sot. Përndryshe, në çoftëse komuna dëmtohet në performance në mos aprovimin e këtyre dy pikave, atëherë është dëm ta bëjmë një gjë të tillë.

Kryetari – Më vjen keq që prej fillimit e thash që është bërë keq që janë larguar atë dy pika. Arsyeja më e bazuar është që janë dy plane që i kanë kaluar të gjitha procedurat, madje në njërin prej planeve në debat publik ka qenë edhe shefi i grupit të LDK-së dhe ka dhënë kontributin e tij në Planin e Mobilitetit. E kuptoj që rendi i ditës është voluminoz, por është edhe raporti i performances që e poenton kuvendin e komunës dhe komunën e Rahovecit.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar. Atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë me 16 vota “për” këto dy pika rikthehen në rend të ditës. Si asamble komunale duhet t'i shmangemi situatave të tilla dhe të mos mundohemi t'i përsërisim.

3. Shqyrtimi i raportit mbi realizimin e planit për vitin 2022 si dhe informatë mbi planin vjetor të prokurimit publik 2023:

Astrit Mullabazi - Sa i përket planifikimit paraprak të prokurimit për 2023 dhe duke pasur parasysh që komuna ka aprovuar buxhetin për vitin 2023, duke u mbështetur në nenin 8-të paragrafi 1 të ligjit të prokurimit; Sa i përket planifikimit paraprak, duhet të dorëzohet me shkrim tek zyrtari kryesor administrativ i autoritetit kontraktues apo te kryetari i komunës, jo më larg se 30 ditë para fillimit të vitit fiskal. Me datë 30.11.2022 është bërë planifikimi paraprak i prokurimit për vitin 2023 dhe ia kemi dërguar kryetarit të komunës. Ky planifikim përfshin furnizimet, shërbimet dhe punët që do të realizohen gjatë vitit 2023. Planifikimi përfundimtar i prokurimit për 2023 sipas ligjit të prokurimit publik bëhet 15 ditë pas miratimit të buxhetit në nivel qëndror. Sa i përket raportit vjetor për kontratat e nënshkruara publike, raporti nuk është final për shkak raporti final dërgohet në KRPP (Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik) jo më larg se 30 janari i vitit 2023. Gjithsej procedurat e prokurimit për vitin 2023 janë 63. Vlera e tyre e parashikuar është 14.890.732euro.

Vlora Vuçiterna – Çmëga – Faleminderit. Deshta të ndërlidhem te plani i prokurimit 2023, specifikisht te kontratat për furnizim me uniforma të stafit shëndetësor dhe teknik. E kam pak të paqartë sa puntorë shëndetësor bashkë me stafin i ka QMF, sepse duke e ditur që vlera e një uniforme kushton 10-20euro, nuk besoj që komuna jonë i ka 1000 puntorë në total meqenëse kontrata parasheh 10.000euro. Nga ana tjetër, parashihet kontratë me vlerë 15.000euro për furnizim të laboratorit me material shpenzues dhe duke pasur parasysh çmimin e lartë të reagjentëve mund ta kuptojmë sesa i ulët do të jetë numri i analizave që do të bëhen në QKMF. Pyetje ime është rreth asaj që a i jepni

tendësi të njëjtë si furnizimit të uniformave, si materialit shpenzues në QKMF?. Te kontrata për karrika stomatologjike, parashihet një kontratë në vlerë 24.000euro, ndërsa vitin e kaluar ka qenë vetëm 6700euro. Sipas çmimit të tregut me këtë vlerë mund të blihet 5-6 karrika stomatologjike. Më konkretisht ku parashihen të shpërndahen këto karrika?.

Lirigzon Kastrati – Një pyetje - sqarim nga menaxherin e prokurimit, po i shoh disa kode këtu “Riparimi i shkollave” “Furnizimi dhe montimi i dyerve në shkolla” “Furnizimi dhe rregullimi i xhamave”. Pse janë të ndara në kode dhe qka përfshihet këtu?

Astrit Mullabazi – Kodet ndahen në 3 kategori sipas ligjit të prokurimit; Furnizime, shërbime, punë. Sa i përket furnizimit me xhama dhe rregullimi i tyre është tender dhe kompani e veçantë, kurse riparimi nëpër shkolla është te kodi “punë” që ka të bëjë me ndërtimin e fushave sportive, riparimi i oborreve të shkollave etj... Sa i përket Vlorës, çdo drejtori te zyra e prokurimit e ka përcjellë veçmas planifikimin për 2023 dhe brenda atij planifikimi janë për bërë punët. Sa i përket Drejtorisë së Shëndetësisë për rekuizita e material, më së shumti të përgjigjet drejtoresha.

Kryetari – Vlorë, shëndetësia ka një numër të caktuar të punëtorëve (154), numri i punëtorëve mund të rritet. Pse janë të planifikuar 10.000euro për uniforma, kjo nuk d.m.th që shpenzohen poaq. Ne kemi kërkesa për 3-4 karrika stomatologjike, pse në këtë vit më pak, e në vitin e ardhshëm më shumë?. Sepse mundësitë më të mëdha i kemi vitin e ardhshëm, buxheti për mallra dhe shërbime rritet.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar. Nëse nuk ka diskutues tjetër, vazhdojmë me pikën e katërt;

4. Shqyrtimi i Raportit të Punës të Kryetarit të Komunës për vitin 2022;

Kryetari – Faleminderit. Raporti është publik, mund ta merrni në web-faqe zyrtare të komunës. Në raport janë zotimet, prioritetet, synimet, qëllimet, raportet e zyrave të kryetarit si dhe raportet e të gjitha drejtorive përfshirë edhe Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim. Besoj që keni pasur kohë ta lexoni raportin, unë i mirëpres çfarëdo që vlerësoni, vërejtje dhe sugjerime.

Lirigzon Kastrati – Faleminderit kryesues. Dëshiroj të flas në fokus të veçantë për prioritetet dhe synimet për vitin 2023 si dhe sfidat gjatë kësaj periudhe. Tek pjesa e prioriteteve, kryetari i komunës i ka përsëritur vazhdimisht. Projektet a duhen të jenë projekte të reja apo vazhdimësi, kryetar?. Siç po shihet kryetari i ka përdorur disa projekte jogjithëpërfshirëse. As në raportet e vitit 2020-21-22 nuk ka pasur ndonjë projekt konkret për fshatrat Hoçë e Vogël, Brestoc dhe konsideroj që qytetarët e këtyre fshatrave janë diskriminuar dhe janë lënë anash. Në fund një pyetje për kryetarit të na tregojë se cilat prioritete ka arritur t’i përfundoj në dy vitete e fundit specifikisht dhe cilat synime ka arritur që t’i bëjë prioritete?

Kryetari – Faleminderit Lirigzon. Sa kohë të jem kryetar, pjesa e qëllimeve dhe prioriteteve nuk do të ndryshojë asnjëherë. Por, ti duhet t’i lexosh raportet e drejtorive, aty specifikohet se cilat projekte konkrete janë realizuar në Hoçë të Vogël dhe Brestoc. Një koment për qytetarët e komunës së Rahovecit; Nga 84 premtimet e programit tim qeverisës, 16 janë përmbushur plotësisht në 6mujorin e parë, 16 janë gjysmë të përmbushura dhe 27 janë të filluara, 24 janë ende të pafilluara. Në 6 mujorin e dytë, sigurusht që do ta shtojmë numrin e zotimeve dhe premtimeve të mbajtura. E keni edhe raportin e institutit GAP dhe do ta shihni që në republikën e Kosovës, nuk ka kryetar që shkallën e realizimit të premtimeve e ka më të lartë. Mund ta lexoni raportin në detaje.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për Planin e Punës të Kryetarit të Komunës së Rahovecit për vitin 2023;

Kryetari – Jemi të ndërgjegjshëm dhe të vetëdijshëm për ecurinë dhe angazhimin e punëve dhe sfidave, pamjaftueshmërisë së buxhetit etj... Në çdo fundvit është bërë tashmë praktike (edhe performanca e kërkon) të diskutojmë rreth projekt-planin e punës së kryetarit të komunës dhe qeverisë komunale për vitin vijues. Ky plan i punës ka qenë në diskutim publik dhe tani është me të gjitha procedurat e përfunduara. Kuvendi duhet t’ia jep miratimin kryetarit të komunës që më pas në 2023 të funksionalizohet me punë.

Sejfullah Sejfullahu – Kryetar, sa herë jemi diskutuar, po thua që viti 2022 ka qenë me probleme. Ju si kryetar, qka keni planifikuar për vitin 2023 diçka që e dallon prej vitit 2022, mos të jetë rutinë çdo herë.

Smajl Latifi – Faleminderit. Ndryshimin digjital me një kontratë të re për gjithë komunën e Rahovecit. Kontratat që nuk kanë funksionuar për shkak të rritjes së çmimeve ose për shkak të pritjes së subvencionimit nga Qeveria, do t'i pastrojmë ose do t'i detyrojmë të punojnë. Në planin e punës ka qenë edhe fillimi i ndërtimit të sheshit qëndror, por nuk është faji ynë sepse lënda në OSHP ka qëndruar dy muaj. Në 2023 e kemi fillimin e pandalshëm të sheshit qëndror. Rruga 4 korsi do të ketë një dinamik tjetër, do të nisin së ndërtuari shumë shkolla. Lajm i mirë është që parashihet të ndërtohet Qendra për Inovacion Kultur dhe Arte (në mars do të shpallet procedura e prokurimit). rrugë, Do të ketë ndërtim të rrugëve - rrugicave dhe trajtim të ujërave të zeza. Do të filloj të ndërtohet projekti i madh i përbashkët mes Qeverisë dhe Komunës – Zona Ekonomike. Janë hapur kodet për kolektorin në Krushe, në Xërxë dhe Ratkoc. Kompleksi sportive do të përmbyllet, AMF në lagjen e epërme do të përfundojë, do të përfundoj Sheshi në Qendër, gjithashtu edhe Sheshi i Republikës dhe shumë projekte që kanë nisur më herët do të përfundojnë.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar. Nëse edhe dikush nuk ka diçka për të thënë, atëherë po e vendosim në votim. Kush është për?... Me shumicë unanime aprovohet edhe propozim-vendimi për Planin e Punës të Kryetarit të Komunës për vitin 2023.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për Planin e Punës të Kuvendit Komunal për vitin 2023;

Skender Hamza – Faleminderit kryesues. Përshëndetje për kryetarin, nënkryetarin, drejtorët dhe gjithë kuvendarët. Para jush e keni draft-planin e punës së kuvendit për vitin 2023, të cilin e kemi përgatitur ne si Zyrë e Kuvendit në bashkëpunim me kryesuesin. Plani në fillim e ka pjesën tekstuale dhe më pastaj tabelarët me pika të rendit të ditës për 12 mbledhje ka 12 muaj të vitit. Ky draft-plan ka qenë në diskutim publik nga data 15.11.2022-15.12.2022. Me datë 29.11.2022 është mbajtur diskutimi publik qytetarë në këtë sallë ku pjesëmarrja për fat të keq ka qenë joeknaqshme. Me datë 12.12.2022 me ndihmën e OSBE-së kemi mbajtur një punëtori në restorant “Natyra”-Fortesë, ku kanë qenë të ftuar ekzekutivi, KPF-ja, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, kryesuesja e Komitetit për Shëndetësi dhe kryesuesja e Komitetit për Arsim. Në atë punëtori janë diskutuar disa propozime duke i përfshirë në draft-planin e punës 2023. Nëse keni ndonjë vërejtje ose propozim, jemi në dispozicionin tuaj për plotësime.

Kryesuesi – Faleminderit Skender. Faleminderit për përgatitjen e këtij draft-plani si Sekretari e Kuvendit. Një kritikë për anëtarët e ftuar në tryezën e cila është organizuar për diskutim për planin e punës së kuvendit, pjesëmarrja e tyre ka qenë e zbehtë. Atëherë Sekretaria e Kuvendit e ka edhe një propozim për ta vendosur në diskutim këtu në seancë rreth planit të punës.

Skender Hamza – Faleminderit kryesues. Ne si Sekretari e kemi një propozim rreth procesverbalit. Për momenti ky që është, nuk është procesverbal por është transkriptë (fjalë për fjalë). Me shumicën e komunave që kemi kontakte, të gjitha e kanë procesverbalin d.m.th thelbin e asaj që diskutohet. Kërkojmë mbështetjen tuaj që edhe ne ta praktikojmë procesverbalin ashtu siç duhet dhe secilit kuvendarë do t'ia bashkangjesim edhe linkun e seancës.

Sejfullah Sejfullahu – Jo rreth procesverbalit, por rreth kujdesit më të shtuar të juristave të komunës – Zyrës ligjore, që MAPL-ja mos t'i kthej vendimet e votuara në kuvend, të kemi kujdes më tepër.

Kryesuesi – Si kuvend komunal i komunës së Rahovecit jemi shumë më mirë se komunat tjera sa i përket kthimit të ligjshmëris nga autoriteti mbikëqyrës dhe poashtu besoj që Zyra Ligjore gjatë hartimit të vendimeve të kujdeset më shumë.

Hasan Përboqi – Atëherë rreth propozimit të Sekretarisë, ne si grup e përkrahim këtë propozim sepse të gjithë jemi dëshmitarë këtu që po bëhen diskutime të shumta dhe ndonjëherë ka ndërhyrje gjatë diskutimeve nga ai që e ka fjalën dhe nuk është e lehtë të shkruhet fjalë për fjalë transkripta.

Kryesuesi – Faleminderit. Atëherë edhe unë pajtohem me këtë propozim dhe patjetër e vendosim në votim. Në rastet specifike në çështje të caktuara mund të bëni kërkesë në Sekretari për transkriptë. Kush është për?... Atëherë me shumicë votash koorporohet edhe ky propozim në planin e punës së kuvendit. Si të tillë po e vendosim në votim

për të gjashtë të rendit të ditës. Kush është “për”?... Me shumicë unanime miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

7.Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për Planin e Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2023;

Nënkryetari – Faleminderit i nderuar kryesues, drejtorë, të nderuar asambleistë. Para vetës e keni planin e KKSB-së në të gjitha procedurat e përfunduara dhe kërkohet miratim formal, sa për dijeni kryesuesi i këtij këshilli është vetë kryetari i komunës.

Kryesuesi – Faleminderit nënkryetar. A ka dikush prej anëtarëve diçka për të thënë?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e shtatë e rendit të ditës.

8.Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për Planin e Vlerësimit të Rrezeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera;

Përparim Krasniqi – Faleminderit kryesues, përshëndetje kryetar, përshëndetje për të gjithë. Faleminderit për rikthimin e dy pikave që kanë qenë të obligueshme për afatet ligjore që na presin. Sa i përket planit të rrezikut të komunës së Rahovecit, nuk do të zgjatëm shumë, është një dokument që për herë të parë është në komunën e Rahovecit duke angazhuar edhe ekspert të jashtëm për rregullimin e këtij dokumentacioni.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor. Nëse dikush prej anëtarëve nuk ka ndonjë diskutim rreth kësaj çështjeje, atëherë po e vendosim në votim. Kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e tetë.

9.Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për Planin e Transportit Rrugor 2022 – 2027;

Përparim Krasniqi – Para vetës e keni dokumentin e planit të transportit rrugor 2022-2027 si dhe planin e mobilitetit, dallimi në mes këtyre dy planeve është sepse plani i mobilitetit ka të bëjë me pjesën më të madhe të zonës urbane të qytetit, ndërsa plani i transportit rrugor lokal ka të bëjë me rrethinën e komunës së Rahovecit në tërësi.

Kryesuesi – Faleminderit. A ka dikush ndonjë pyetje rreth Planit të Transportit Rrugor?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e nëntë.

10.Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për Planin e Mobilitetit Urban 2022 – 2027;

Përparim Krasniqi – Plani i Mobilitetit është një dokument shumë i rëndësishëm i komunës së Rahovecit, ka afatin 5 vjeçarë. Për sugjerime do t’iu jemi mirënjohës.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor. A ka dikush diçka rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Me 16 vota “për” miratohet edhe pika e dhjetë e rendit të ditës.

11.Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2023;

Saranda Sallteku – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Në bazë të ligjit për vetëqeverisje lokale si dhe statutit të komunës së Rahovecit, kryetari i komunës i propozon kuvendit miratimin e vendimit, me të cilin i lejohet kryetarit që në interes të qytetarëve në emër të mbulimit të shpenzimeve të varrimit të vitit 2023, të lidh marrëveshje me të gjitha bashkësitë fetare në komunën e Rahovecit. Pakoja e shërbimeve primare do të definohet në marrëveshje të re dhe nuk mund të jetë kosto më të lartë se 220 euro. Gjithashtu në KPF nënkryetari e ka përmendur të shtohet edhe një paragraf që në rast se varroset ndonjë veteran i UÇK-së, të shtohen plus 200 dhe i bie 420euro.

Rasim Fazliu – Faleminderit drejtoresh për prezantimin. E kemi mirëpritur këtë punë çdo herë, sepse është një prej punëve më të qëlluara që është bërë ndonjëherë, duke iu dalur në ndihmë qytetarëve në momentet më të vështira. Desha të ndalem te pika 2, ndoshta e ke gabim, ku thotë: Pakoja e shërbimeve primare do të definohet në marrëveshje të re dhe ajo nuk mund të jetë kosto më të lartë se (me numra është 00.00) e në anën tjetër 200euro. Ky është dokument zyrtar dhe duhet të jetë i shkruar drejtë dhe mirë.

Sinan Kryeziu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. E përgëzojmë Drejtoreshën e Shëndetësisë për këtë iniciativë, gjithashtu e përkrahim çdo herë.

Kryesuesi – Atëherë nëse dikush nuk ka ndonjë diskutim tjetër, po e vendosim në votim bashkë me propozimin që e bëri drejtoresha dhe me vërejtjen nga z. Rasim. Kush është për?... Me shumicë unanime miratohet propozim-vendimi për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2023.

12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e Simbolit Përkujtimor të Gjenocidit në Kosovë;

Kryetari – Faleminderit. Jemi njëra ndër komunat që e kemi përjetuar rëndë dhe e kemi plagë të hapur gjenocidin serbë në Kosovë. Ka ardhur koha ta miratojmë këtë simbol i cili na përkujton që në këto troja ka pasur gjenocid dhe ka ushtruar dikush gjenocid. Nuk dyshoj që me unanimitet aprovet.

Hasan Përboqi – Ne si grup i asambleistave të Aleancës e përkrahim në plotni miratimin e llogos unike (lulëkuqja me katër petale), e që me votën tonë si kuvendarë do të jetë edhe simboli i përkujtimit të gjenocidit serb të ushtruar ndaj shqiptarëve të pafajshëm në Kosovë. Meqë jemi afër 15 janarit (dita e shënimit të gjenocidit serb në Kosovë), miratimi i këtij simboli nga kuvendi komunal i Rahovecit, është mënyra më e mire për ta përquar mesazhin se përballë krimit dhe gjenocidit të ushtruar nga armiku shekullor serb ndaj shqiptarëve, ne jemi të bashkuar.

Sejfullah Sejfullahu – Faleminiderit. Si vendas i një vendi ku ka ndodhur gjenocidi (Krushë e Madhe), e përkrahim në plotni dhe shpresojmë që në të ardhmen institucionet ndërkombëtare dhe vendore të bëjnë më shumë se sa llogoja.

Kryesuesi – Faleminiderit Sejfullah. Nëse dëshiron të deklarohet edhe dikush prej grupeve tjera?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është për?... Me shumicë unanime aprovet propozim-vendimi për miratimin e simbolit përkujtimor të gjenocidit në Kosovë.

13. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.263/22, i datës: 25.01.2022, për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;

Hasan Përboqi – Faleminderit kryesues. Kemi pasur lëvizje brenda grupit parlamentar. Shefja e grupit që ka qenë edhe anëtare e KPF-së është bërë drejtoresh, si obligim ligjor e kemi edhe zëvendësimin e anëtares. Anëtare të re në KPF, e propozojmë zonjën Shqipe Kryeziu.

Kryesuesi – Faleminiderit Hasan. Atëherë Shqipe Kryeziu (AAK) është e propozuar për anëtare e KPF-së. Si të tillë po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë unanime aprovet edhe propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e KPF-së.

14. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen në interes të përgjithshëm të parcelës P-01041-1 – në zonën kadastrale Xërxë;

Afrim Oruqi – Faleminiderit kryesues. I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë drejtor, të nderuar kuvendarë. Sipas ligjeve në fuqi, para jush keni propozimin e kryetarit të komunës për shpalljen me interes të përgjithshëm të parcelës 1041-1 në Xërxe, me pronar Hysni Vehbi Thaqi me sipërfaqe prej 14 ari e 72m katror. Qëllimi i shpalljes së interes të përgjithshëm është këmbimi i pronës publike me private.

Kryesuesi – Faleminiderit drejtor. A ka dikush diçka rreth kësaj qështje?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Me 17 vota për aprovet edhe pika e 14 e rendit të ditës.

15. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 338/22 i datës 29.06.2022 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër;

Erhan Morina – Faleminderit kryesues. I nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë, anëtarë të kuvendit. Para jush keni materialin për plotësim-ndryshimin e vendimit Nr.338/22 të datës 29.06.2022 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme. Kërkohej që pika 2.1/2.5/2.7/2.8 të shfuqizohen nga vendimi bazik, ndërsa pikat tjerat të mbesin të pandryshueshme. Arsyetimi është se në këtë zonë kadastrale ka pasur kërkesë për këmbim të parcelave dhe si pasojë e kësaj ne si drejtori, nuk kemi mundur të vazhdojmë të procedojmë më tutje këtë vendim.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor. Nëse dikush nuk ka diçka rreth kësaj pike?... Atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Me 20 vota “për” aprovet edhe pika e 15 e rendit të ditës.

16. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 341/22 i datës 29.06.2022 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;

Erhan Morina- Para jush keni materialin për plotësim-ndryshim të vendimit me nr.341/22 të datës 29.06.2022 për krijimin e komisionit i cili ndërlidhet me vendimin paraprak.

Kryesuesi – Faleminderit. Nëse nuk ka dikush diçka për të thënë?... Po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë unanime miratohet edhe pika e 16-të e rendit të ditës.

17. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit mbi regjistrimin dhe vlerësimin e dëmeve në amvisëri, ekonomi familjare dhe biznese, të shkaktuara nga vërshimet e shiut me datë 17 shtator 2022;

Erhan Morina – Në këtë pikë të rendit të ditës po paraqesim raportin e dëmeve që kanë ndodhur me 17 shtator të këtij viti, si pasojë e të reshurave të shiut. Bëhet fjalë për dëme në ekonomi familjare, amvisëri dhe biznese. Rregullorja nr.17/2015 obligon që raportet e dëmeve t'u nënshtrohen kuvendit për miratim para se të dërgohen në qeveri. Vendet më të prekura nga këto vërshime janë: Fshati Ratkoc, Celinë, Fortesë, Krushë e Madhe dhe Radostë. Gjithsej janë vlerësuar 333 ekonomi familjare dhe amvisëri me vlerë të dëmeve rreth 1.1192.509euro. Të prekura nga vërshimet kanë qenë edhe 10 biznese me vlerë të dëmeve 77.285 euro.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor. A ka dikush prej anëtarëve të kuvendit ndonjë gjë rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë unanime aprovohet edhe pika e 17-të.

18. Informatë rreth gjendjes në terren pas të reshurave të fundit në territorin e komunës së Rahovecit.

Besmire Bytyqi – Faleminderit kryesues. I nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë, asambleistë. Pas kërkesës të shefit të grupit të LDK-së z. Burim Krasniqi në KPF, ne e kemi sjellur informatën. Komuna e Rahovecit në gjysmën e parë të muajit dhjetor është përfshirë me të reshura të dendura të shiut duke krijuar situata pak të vështira për qytetarët. Që nga vërshimet e muajit shtator, që si pasojë komuna jonë u godit nga dëmet e konsiderueshme, kemi ndërmarrë menjëherë veprime konkrete në pastrim dhe hapje të kanaleve-përrockave në tërë territorin e komunës sonë. Duhet ta cekim edhe intervenimin që është bërë nga FSK-ja në hapjen dhe pastrimin e lumit Bellaja. Njësia e zjarrëfiksëve ka pranuar vetëm tre raste të raportuara (intervenimeve të lehta).

Kryesuesi – Faleminderit drejtoresh. A ka dikush diçka rreth kësaj informate, nëse jo, kalojmë te pika e radhës.

19. Plotësim-ndryshimi i vendimit 01 Nr.264/22 i datës 25.01.2022 për themelimin e Komitetit për Komunitete;

Hasan Përboqi – Faleminderit kryesues. Pasi që zonja Shqipe Kryeziu ka kaluar si anëtare e rregullt e KPF-së, si zëvendësim propozojmë zonjushën Dorentina Sopjani (AAK).

Lirigzon Kastrati – Më e udhës do të ishte që fillimisht të shfuqizohet ky vendim, më pas të miratohet i riu që dërgohet në MAPL.

Kryesuesi – Sidoqoftë ndryshimet janë në të njëjtën seancë dhe nuk besoj që renditja është aq e rëndësishme. Atëherë vendi në Komitetin për Komunitete plotësohet nga Dorentina Sopjani dhe si të tillë po e vendosim në votim. Kush është për?... Me shumicë unanime aprovohet edhe plotësim-ndryshimi për KK.

20. Plotësim-ndryshimi i vendimit Nr.392/22 i datës 25.11.2022 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Përparim Krasniqi – Faleminderit kryesues. Në seancën e kaluar është marrë një vendim për formimin e komisionit për dhënie të ofertave dhe zbatimin për pronë të paluajtshme të komunës, fjala është për ankandin të deponisë ilegale të mbeturinave, mirëpo për shkak që Nora Boshnjaku është anëtare dhe nuk mund të jetë në këtë komision, ajo është anëtare në komisionin e ankesave. Për këtë arsye duhet ta bëjmë plotësim-ndryshimin dhe kryetari i komunës duhet ta propozoj dikë tjetër.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor. Atëherë Nora Boshnjaku largohet nga ky komision, për t'ia liruar vendin një propozimi tjetër që tani do ta bëjë kryetari.

Kryetari – E propozoj Besmire Bytyqin.

Kryesuesi – Atëherë Besmire Bytyqi është përfaqësuese nga ekzekutivi i komunës në këtë komision në vend të Nora Boshnjakut. Si të tillë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë unanime aprovohet edhe plotësimi i vendimit për këtë komision. Me këtë pikë, po përfundon edhe rendi i ditës, në ora 16:00 në restorant “Bjeshka” jeni të ftuar për darkën e fundvitit. Urime festat.

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

K R Y E S U E S I

Defrim Kafexhiu



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Rahoveci
Skupština Opštine Orahovac/Municipality Assembly Rahovec



Komiteti për Komunitete

RAPORTI PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2022

Lënda: Raporti i Kryesuesit të Komiteteve për Komunitete

Për: Komitetin për Politik dhe Financa dhe Kuvendin Komunal

Gjatë këtij viti janë mbajtur gjithsejtë gjashtë takime

Takimi i parë 1 është mbajtur me datën 02.03.2022 .

11	vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit konform periudhës së zbatimit të kontratës	jetë e barabartë me të paktën 10% të vlerës së kontratës. Sigurimi i ekzekutimit do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës". Për dy projekte në vijim, zyra e prokurimit nuk e kishte kërkuar vazhdimin e sigurimit të ekzekutimit të kontratave, krahas vazhdimit të realizimit të kontratave të cilat ende nuk kanë përfunduar si: ● Për projektin "Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve në fshatin Ratkoc", me vlerë të kontratës 46,292€, siguria e ekzekutimit të kontratës kishte validitet deri më datën 16.11.2019 ndërsa përfundimi i punëve sipas kontratës ishte paraparë më datën 20.11.2020, dhe si e tillë nuk ishte vazhduar deri në kohën e kryerjes së auditimit; dhe ● Për projektin "Rregullimi i shtretërve të lumenjëve dhe proçkave", me vlerë të kontratës 765,095€, siguria e ekzekutimit të kontratës kishte validitet deri më datën 4.12.2020 ndërsa përfundimi i punëve sipas kontratës ishte paraparë më datën 06.12.2021 dhe si e tillë nuk ishte vazhduar deri në kohën e kryerjes së auditimit. Shkaku i një dukurie të tillë, ish-in vonesat në realizimin e kontratave përkatësisht mungesa e komunikimit, në mes të menaxherëve të kontratave dhe zyrës së Prokurimit.	brenda kornizës kohore të përcaktuar në kontrata dhe se sigurimi i ekzekutimit duhet të ketë vlefshmëri në raport me periudhën e pëmbushjes së kontratës ashtu siç parashihet në ligj.	do të zbatohet. Për kontratat që u kanë kaluar afatet e sigurimit të ekzekutimit të kontratave, do t'u vazhdojen sigurimet (për ato kontrata të cilat janë aktive dhe kanë kaluar afatet e sigurimit të ekzekutimit).	menaxherët e kontrata ve.		
12.	Çështja C2 - Mos nënshkrimi i planit të menaxhimit të kontratës nga palët kontraktuese	Sipas nenit 81 të LP, autoritetet kontraktuese janë të obliguara të përgatisin planin për menaxhim të kontratës. Plani i Menaxhimit të Kontratës (më tutje PMK) është dokument i cili do të përditësohet bazuar në mbikëqyrjen e punëve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në kontratën origjinale. PMK duhet të përdoret së bashku me rregullat e miratuara për menaxhimin e aktiviteteve të kontratës, të nxjerra nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Plani i menaxhimit të kontratave nuk ishte nënshkruar nga palët kontraktuese për projektet: "Ndërtimi i AMF-se në lagjen e epërme", "Renovimi i objektit të vjetër të QKMF-së në Rahovec"; "Rregullimi i kanaleve të kullimit të tokave bujqësore"; "Ndërtimi i rrugëve lokale në komunën e Rahovecit" faza e dytë Lot 1; dhe "Ndërtimi i rrugëve lokale në komunën e Rahovecit" faza e dytë Lot 2. Kjo kishte ndodhur për shkak se menaxheri i kontratës nuk e kishte vlerësuar të nevojshme nënshkrimin pasi ato plotësohen sipas tyre në sistem.	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët projekteve të kontribuojnë që plani i menaxhimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga palët kontraktuese me qëllim të pëmbushjes së detyrave kontraktuale.	Ky rekomandim deri në fund të vitit do të jetë i zbatuar. Pas aprovimit të PMK në sistem nga AK dhe OE ato do të nënshkruhen dhe kopjet fizike do të dorëzohen në zyrën e prokurimit	Zyra e Prokurimit, Menaxherët e Kontratave	I zbatuar	

13.	Çështja B7 - Mangësi në regjistrimin e pasurisë	Rregullorja nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare, në nenin 6, përcakton që, "Pasuritë kapitale duhet të regjistrohen në SIMFK, ndërsa pasuritë jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e-pasuria."	Sipas rishikimit të regjistrit të përgjithshëm të pasurive, kemi vërejtur se katër pagesa në shumë prej 72,223€ (pasuri kapitale mbi 1000€) nuk ishin regjistruar në SIMFK, si dhe katër pagesa (pasuri nën 1000€) në shumë prej 20,786€, nuk ishin regjistruar në e-pasuria. Përveç kësaj, për pasuritë nën 1000€ nuk ishte llogaritur zhvlerësimi vijtor.	Kryetari duhet të sigurojë se do të regjistrohen të gjitha pasuritë mbi dhe nën 1000€ në shtuaret përkatëse, në mënyrë që vlera e pasurive të prezantohet e plotë dhe e saktë në përputhje me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.	Konsiderojmë se gjatë vitit fiskal 2022, do të zbatohet plotësisht ky rekomandim.	Drejtori a për Zhvillim Ekonomik, Zytari për regjistrimin e pasurisë	Pjesërisht i zbatuar	
14.	Çështja B8 - Menaxhimi jo i duhur i arkëtueshmeve	Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, në nenin 16 përcakton se, Organizata Buxhetore duhet të raportoj llogaritë e Arkëtueshme në mënyrë të drejtë dhe të saktë. Bazuar në testet e kryera, për të arkëtueshmet nga taksat për ushtrimin e veprimtarisë rezultoi se, në katër raste shuma e prezantuar në listën e të arkëtueshmeve nuk përputhet me kartelën financiare të biznesit që dëshmon për borxhin e prezantuar. Kjo mospërputhje është për shumën 20,569€, e cila kishte rrjedhur si pasojë e një gabimi teknik me rastin e hartimit të listës së të arkëtueshmeve.	Sipas zyrtarit të pasurisë, mos regjistrimi i katër pagesave mbi dhe nën 1000€ ka ndodhur si rezultat i defektit në softuerin e Komunës dhe si rezultat i kësaj kanë mbetur të pa regjistruara. Po ashtu, mos llogaritja e zhvlerësimit për pasuritë nën 1000€ ka ndodhur për shkak të skadimit të kontratës së softuerit e-pasuria.	Kryetari duhet të sigurojë, se janë ndërmarrë veprimet adekuate për një zgjidhje të përbashkët me Agjencionin Kosovar të Privatizimit lidhur me obligimet për Ndërmarrjet Shogërore nën menaxhimin e tyre dhe ish ndërmarrjeve shogërore. Po ashtu, të ndërmerrren të gjitha masat ligjore për arkëtimin e të arkëtueshmeve nga të gjithë pronarët e pronave.	Gjatë vitit 2022, komuna do të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura ligjore për inkasimin e të hyrave, përkatësisht zvogëlimin e llogarive të arkëtueshme.	Drejtori a për Buxhet dhe Financa, Zytari Kryesor Financiar Zyra e Tatimit në Pronë, Drejtori a për Ekonomik, Zhvillim dhe Turizëm	Pjesërisht i zbatuar	



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality of Rahovec



Datë 28.6.2022

Takim i Grupit Punues për Zbatimin e Rekomandimeve të ZKA-së

PROCESVERBAL

Në raportin e ZKA-së janë paraqitur gjithsej 14 rekomandime për vitin 2021.

Çështja A1

Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve:

Do të zbatohet ky rekomandim sepse pagesat për kategori të shpenzimeve do të bëhen nga kodet adekuate (subvencione dhe transfere) dhe jo nga kategoria investime kapitale.

Përgjegjës për zbatimin e këtij rekomandimi do të jenë Drejtoria për Buxhet dhe Financa,

Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe drejtoria për Shëndetsi dhe Mirëqenie Sociale.

Konsiderojmë se deri në fund të vitit fiskal 2022 do të zbatohet ky rekomandim.

Çështja A2

Përdorimi jo adekuat i procedurës së prokurimit:

Ky rekomandim është pjesërisht i zbatueshëm për arsye të emergjencave ekstreme që mund të vijnë në Gjatë vitit fiskal 2022 rrespektivisht në fund të vitit 2022 ky rekomandim do të jetë pjesërisht i zbatuar.

Përgjegjës për zbatimin e këtij rekomandimi do të jetë Zyra e Prokurimit.

Çështja A3

Mangësi në procesin e vlerësimit të aplikacioneve për subvencionimin e OJQ-ve:

Rekomandim i zbatuar tashmë.

Përgjegjës për zbatim është DKRS dhe Komisioni për Perzgjedhjen e OJQ-ve përfituese.

Çështja B1

Nënshkrimi i kontratave pa mbulueshmëri financiare:

Gjatë vitit fiskal 2022 rrespektivisht në fund të vitit 2022 ky rekomandim do të jetë i zbatuar.

Përgjegjës do të jetë ZKF, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë të cilat kanë projekte 3-vjeçare.

Çështja B2

Zotimi i mjeteve jo sipas rregullave financiare:

Zbatimin e rregullorës financiare me nr.01/2013, gjatë vitit 2022, vlersojmë se edhe ky rekomandim, nëse jo plotësisht, pjesërisht do të zbatohet.

Përgjegjës për zbatim do të jetë Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyra e Prokurimit.

Çështja B3

Mos pagesa e faturave brenda afatit ligjor:

Konsiderojmë se edhe ky rekomandim, nëse jo plotësisht, pjesërisht do të zbatohet gjatë këtij viti.

Përgjegjës për zbatim do të jenë Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyra e Prokurimit.

Çështja C1

Pagesa shtesë +30%, në mungesë të shtimit të pozicionit/ artikullit:

Gjatë vitit fiskal 2022 rrespektivisht në fund të vitit 2022 ky rekomandim do të jetë i zbatuar.

Zyra e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet Dhe Financa, Drejtoria për Shëndetsi dhe mirëqenie Sociale do të jenë përgjegjës për zbatimin e këtij rekomandimi.

Çështja B4

Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë:

Kemi arritur përmirsim të dukshme sa i përket azhurnimit të të dhënave në evidentimin të tatimit në pronë për vitin 2022, si rezultat i komunikimit të vazhdueshëm në mes Komunës dhe Departamentit të tatimit në pronë. Konsiderojmë se edhe ky rekomandim do të jetë i zbatuar.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyra e Tatimit në Pronë janë përgjegjës për zbatimin e këtij rekomandimi.

Çështja B5

Ankesa lidhur me vlerësimin jo të duhur të pronave:

Besojmë që gjatë këtij viti fiskal do të rritet komunikimi dhe bashkpunimi me departamentin e tatimit në pronë (besojmë që do të rregullohet Softveri për përpunimin e të dhënave të tatimit në pronë dhe do të kemi të dhëna të sakta në qdo kohë) atëherë ky rekomandim deri në fund të vitit fiskal do të jetë i zbatuar.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyra e Tatimit në Pronë janë përgjegjës për zbatimin e këtij rekomandimi.

Çështja B6

Vonesa në realizimin e projekteve:

Deri në fund të vitit fiskal ky rekomandim do të jetë pjesërisht i zbatuar dhe në vitet në vazhdim do të jetë tërësisht i zbatuar.

Përgjegjës për zbatim janë ZKF, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë të cilat kanë projekte 3-vjeçare.

Çështja A4

Mos-vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit konform periudhës së zbatimit të kontratës:

Deri ne fund të vitit 2022 ky rekomandim do të jete i zbatuar sepse për të gjitha kontratat që kanë kaluar afatet e sigurimit të ekzekutimit të kontratave dhe do ti vazhdojm sigurimet (për te gjitha ato kontratave të cilat jan aktive dhe kan kalu aftet e sigurimit të ekzekutimit).

Përgjegjes për zbatim Zyra e Prokurimit, Menaxherët e Kontratave.

Çështja C2

Mos nënshkrimi i planit të menaxhimit të kontratës nga palët kontraktuese:

Ky rekomandim deri në fund të vitit do të jetë i zbatuar.

Pas aprovimit te PMK ne sistem nga AK dhe OE ato do te nenshkruhen dhe kopjet fizike do te dorëzohen në zyrën e prokurimit Ky rekomandim deri në fund të vitit do të jetë i zbatuar.

Zyra e Prokurimit, Menaxherët e Kontratave.

Çështja B7

Mangësi në regjistrimin e pasurisë:

Konsiderojm se gjatë vitit fiskal 2022, do të zbatohet plotësisht ky rekomandim.

Përgjegjës për zbatim të këtij rekomandimi do të jetë Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Zyrtari për regjistrimin e pasurisë.

Çështja B8

Menaxhimi jo i duhur i të arkëtueshmeve:

Gjatë vitit 2022, komuna do ti nderrmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore , për inkasimine e të hyrave, përkatësisht zvoglimin e llogarive të arketushme. Andaj konsiderojm se ky rekomandim pjeserisht do të zbatohet.

Përgjegjës për zbatim do të jetë Drejtoria e Financave, ZKF, Zyra e Tatimit në Pronë, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Turizëm.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality of Rahovec

Datë 7.9.2022

Takim I Grupit Punues për Zbatimin e Rekomandimeve të ZKA-se

PROCESVERBAL

Në këtë takim në prezencë të kryetarit u diskutuan masat që janë marrur në funksion të zbatimit të rekomandimeve të ZKA-së.

U raportua për secilin rekomandim veç e veç nga anëtarët e komisionit për zbatimin e rekomandimeve.

Grupi punues do të mbledhet përsëri në fund të muajit shtator dhe do të percjellë ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

Konkluzionet e dalura nga ky takim:

Vazhdimi i sugurimit të kontratave.

Regjistrimi i pasurisë nën 1000 euro.

Kryetari mbetet i përkushtuar të i përmbushë të gjitha zotimet e dhëna në planin e zbatimit të rekomandimeve për vitin 2022.

Ne raportin e ZKA-së janë paraqitur gjithsej 14 rekomandime për vitin 2021.

Çështja A1

Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve:

Do të zbatohet ky rekomandim sepse pagesat për kategori të shpenzimeve do të bëhen nga kodet adekuate (subvencione dhe transfere) dhe jo nga kategoria investime kapitale.

Përgjegjës për zbatimin e këtij rekomandimi do të jenë Drejtoria për Buxhet dhe Financa,

Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe drejtoria për Shëndetsi dhe Mirëqenie Sociale.

Konsiderojmë se deri në fund të vitit fiskal 2022 do të zbatohet ky rekomandim.

Çështja A2

Përdorimi jo adekuat i procedurës së prokurimit:

Ky rekomandim është pjesërisht i zbatueshëm për arsye të emergjencave ekstreme që mund të vijnë në Gjatë vitit fiskal 2022 rrespektivisht në fund të vitit 2022 ky rekomandim do të jetë pjesërisht i zbatuar.

Përgjegjës për zbatimin e këtij rekomandimi do të jetë Zyra e Prokurimit.

Çështja A3

Mangësi në procesin e vlerësimit të aplikacioneve për subvencionimin e OJQ-ve:

Rekomandim i zbatuar tashmë.

Përgjegjës për zbatim është DKRS dhe Komisioni për Perzgjedhjen e OJQ-ve përfituese.

Çështja B1

Nënshkrimi i kontratave pa mbulueshmëri financiare:

Gjatë vitit fiskal 2022 rrespektivisht në fund të vitit 2022 ky rekomandim do të jetë i zbatuar.

Përgjegjës do të jetë ZKF, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë të cilat kanë projekte 3-vjeçare.

Çështja B2

Zotimi i mjeteve jo sipas rregullave financiare:

Zbatimin e rregullorës financiare me nr.01/2013, gjatë vitit 2022, vlersojmë se edhe ky rekomandim, nëse jo plotësisht, pjesërisht do të zbatohet.

Përgjegjës për zbatim do të jetë Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyra e Prokurimit.

Çështja B3

Mos pagesa e faturave brenda afatit ligjor:

Konsiderojmë se edhe ky rekomandim, nese jo plotesisht, pjesërisht do të zbatohet gjatë këtij viti.

Përgjegjës për zbatim do të jenë Drejtoria për Buxhet Dhe financa, Zyra e Prokurimit.

Çështja C1

Pagesa shtesë +30%, në mungesë të shtimit të pozicionit/ artikullit:

Gjatë vitit fiskal 2022 rrespektivisht në fund të vitit 2022 ky rekomandim do të jetë i zbatuar.

Zyra e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet Dhe Financa, Drejtoria për Shëndetsi dhe mirëqenie Sociale do të jenë përgjegjës për zbatimin e këtij rekomandimi.

Çështja B4

Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në prone:

Kemi arritur përmirsim të dukshme sa i përket azhurnimit të të dhënave në evidentimin të tatimit në pronë për vitin 2022, si rezultat i komunikimit të vazhdueshëm në mes Komunës dhe Departamentit të tatimit në pronë. Konsiderojmë se edhe ky rekomandim do të jetë i zbatuar.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyra e Tatimit në Pronë janë përgjegjës për zbatimin e këtij rekomandimi.

Çështja B5

Ankesa lidhur me vlerësimin jo të duhur të pronave:

Besojmë që gjatë këtij viti fiskal do të rritet komunikimi dhe bashkpunimi me departamentin e tatimit në pronë (besojmë që do të rregullohet Softveri për përpunimin e të dhënave të tatimit në pronë dhe do të kemi të dhëna të sakta në qdo kohë) atëherë ky rekomandim deri në fund të vitit fiskal do të jetë i zbatuar.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyra e Tatimit në Pronë janë përgjegjës për zbatimin e këtij rekomandimi.

Çështja B6

Vonesa në realizimin e projekteve:

Deri në fund të vitit fiskal ky rekomandim do të jetë pjesërisht i zbatuar dhe në vitet në vazhdim do të jetë tërësisht i zbatuar.

Përgjegjës për zbatim janë ZKF, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë të cilat kanë projekte 3-vjeçare.

Çështja A4

Mos-vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit konform periudhës së zbatimit të kontratës:

Deri në fund të vitit 2022 ky rekomandim do të jetë i zbatuar sepse për të gjitha kontratat që kanë kaluar afatet e sigurimit të ekzekutimit të kontratave dhe do të vazhdojmë sigurimet (për të gjitha ato kontratave të cilat janë aktive dhe kanë kaluar afatet e sigurimit të ekzekutimit).

Përgjegjës për zbatim: Zyra e Prokurimit, Menaxherët e Kontratave.

Çështja C2

Mos nënshkrimi i planit të menaxhimit të kontratës nga palët kontraktuese:

Ky rekomandim deri në fund të vitit do të jetë i zbatuar.

Pas aprovimit të PMK në sistem nga AK dhe OE ato do të nënshkruhen dhe kopjet fizike do të dorëzohen në zyrën e prokurimit. Ky rekomandim deri në fund të vitit do të jetë i zbatuar.

Zyra e Prokurimit, Menaxherët e Kontratave.

Çështja B7

Mangësi në regjistrimin e pasurisë:

Konsiderojmë se gjatë vitit fiskal 2022, do të zbatohet plotësisht ky rekomandim.

Përgjegjës për zbatim të këtij rekomandimi do të jetë Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Zyrtari për regjistrimin e pasurisë.

Çështja B8

Menaxhimi jo i duhur i të arkëtueshmeve:

Gjatë vitit 2022, komuna do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore, për inkasim dhe të hyrave, përkatësisht zvogëlimin e llogarive të arkëtueshme. Andaj konsiderojmë se ky rekomandim pjesërisht do të zbatohet.

Përgjegjës për zbatim do të jetë Drejtoria e Financave, ZKF, Zyra e Tatimit në Pronë, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Turizëm.



RAPORT I KUVENDIT KOMUNAL TË RAHOVECIT (JANAR- DHJETOR 2022)



JANAR 2023

2	HYRJJE.....
2	QËLLIMI I RAPORTIT.....
3	FUNKSIONIMI I KUVENDIT TË KOMUNËS SË RAHOVECIT.....
3	KOMITETET E KUVENDIT TË KOMUNËS.....
4	KOMITETI PËR KOMUNITETE.....
5	KOMITETET KONSULTATIVE.....
5	MBLEDHJET E KUVENDIT TË KOMUNËS DHE KOMITETEVE.....
14	KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA.....
15	DËGJIMET BUXHETORE PËR VITIN 2021.....
17	MONITORIMI I MBLLEDHJEVE.....
17	RAPORTIMI I KRJETARIT TË KOMUNËS.....
18	NJOFTIMET PËR MBLLEDHJE DHE MATERIALET PËRCJELLESE.....
18	ÇESHTJET E DISKUTUARA NË KUVEND- AKTET E KUVENDIT TË KOMUNËS.....
18	GËSHËKIMI I AKTEVE NË UEB-FAQEN ZYRTARE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT.....
19	SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISE SË AKTEVE.....
19	RISHQYRTIMI I AKTEVE LIGJORE TË EVIDENTUARAARAErtor! Bookmark not defined.
21	PËRFUNDIM.....

HYRJE

Të nderuar Kuvendar/e të Komunës të Kuvendit Komunal të Rahovecit,

Bazuar në ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe Statutin e Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës: 29.03.2017, në Planin e Punës së Kuvendit të Komunës dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit, kemi kënaqësinë të paraqesim para jush raportin dymbëdhjetë mujor lidhur me aktivitetet, punët, angazhimet dhe arritjet e Kuvendit të Komunës së Rahovecit përgjatë periudhës janar- dhjetor 2022.

Në sistemin e vetëqeverisjes lokale të Republikës së Kosovës, komuna është njësi themelore e vetëqeverisjes me ç'rast i gjithë territori i Kosovës është i ndarë në 38 komuna.

Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës janë organet kryesore të komunës dhe që të dyja zgjedhën veç e veç dhe me vota të drejtpërdrejta të qytetarëve të komunës, të cilat janë obliguara të ushtrojnë kompetencat në mënyrë ligjore dhe transparente, duke siguruar edhe pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.

Ky sistem promovon sjelljen demokratike, transparente dhe llogaridhënien e organeve të komunës si dhe garanton një kontroll të ndërsjellë ndërmjet organeve komunale.

Në kuadër të organeve të Komunës së Rahovecit, Kuvendi është organi më i lartë vendimmarrës, i cili ushtron funksionin e tij në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, Planin e Punës së Kuvendit të Komunës, Rregulloren e Punës së Kuvendit.

QËLLIMI I RAPORTIT

Përmes këtij raporti jemi munduar të krijojmë një pasqyrim të qartë për qytetarët, lidhur me aktivitetet e të zgjedhurve të tyre. Ky raport ka për qëllim që të rrit transparencën dhe llogaridhënien e Kuvendit të Komunës së Rahovecit karshi qytetarëve.

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

- Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (Konsultativ)
- Komiteti për Arsim (Konsultativ)
- Komiteti i Komuniteteve (i përhershëm)
- Komiteti për Politikë dhe Financa (i përhershëm)

Komitetet e Kuvendit të Komunës së Rahovecit

- Komitetet ndihmëse të cilat kanë për qëllim shqyrtimin e hollësishëm të politikave, dokumenteve strategjike, vendimeve dhe rregulloretve të komunës nga njëra anë, si dhe mbikqytjen e veprimtarive të degës ekzekutive në anën tjetër.
- Andaj, Kuvendi i Komunës, themelon komitete tjera, të cilat e ndihmojnë atë në përmbushjen e këtyre obligimeve dhe ushtrimin e këtyre kompetencave.

KOMITETET TJERA TË KUVENDIT

- Komiteti për Komunitete
- Komiteti për Politikë dhe Financa,

Kuvendi i Komunës ka komitetet obligative sic janë:

KOMITETET E KUVENDIT TË KOMUNËS

Kuvendi i Komunës së Rahovecit është organi më i lartë vendimmartës i komunës, i cili funksionon në bazë të legjislationit për vetëqeverisjen lokale në Republikën e Kosovës Nr.03/L-040, Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës: 29.03.2017, dhe Planit të Punës së Kuvendit të Komunës. Kuvendi duhet të mbajë së paku 10 mbledhje në vit, 5 (pesë) prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmuorin e parë të vitit. Ky është kriteri minimal i specifikuar, i cili kërkohet të respektohet, ndërsa komunave u është lënë mundësia të përshatnin numrin e mbledhjeve varësisht nga nevojat.

FUNKSIONIMI I KUVENDIT TË KOMUNËS SË RAHOVECIT

KOMITETI PËR POLITIK DHE FINANCA

Komiteti për Politikë dhe Financa është organi kryesor i Kuvendit të Komunës, i cili shqyrton paraprakisht të gjitha çështjet që parashihen të shqyrtohen në Kuvendin e Komunës. Kështu, Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e:

- Të gjitha politikave,
- Dokumenteve fiskale dhe financiare,
- Planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik,
- Komizës vjetore buxhetore afatmesme,
- Planit vjetor të prokurimit,
- Rregullores vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat,
- Planit vjetor të punës për auditimin e brendshëm,
- Planit buxhetor vjetor, afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, si dhe
- Marrjen e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin Komunal.

Komiteti për Politikë dhe Financa, gjatë kësaj periudhe raportuese ka pasur një performancë të mirë duke e përmbushur obligimin e tij ligjor, që të mbajë takimet e rregullta, por edhe të trajtojë të gjitha dokumentet e rëndësishme para se ato të kalojnë për diskutim në Kuvend.

Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur gjithsej 11 (njëmbëdhjetë) mbledhje për periudhën: **janar –dhjetor**, gjatë këtyre seancave ka diskutuar pika të ndryshme duke qenë në kompetencë të saj, ajo ka diskutuar dhe ka rekomanduar Kuvendit për të gjitha çështjet që i ka pasur në rend të ditës.

KOMITETI PËR KOMUNITETE

Komiteti për Komunitete është komiteti i dytë obligativ i Kuvendit të Komunës, detyrë e të cilit është:

- Shqyrtimi i përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim.
- Shqyrtimi i të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se respektohen plotësisht të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- I rekomandon Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

Fetoshi.

- së Rahovecit, z. Masar Popaj dhe zyrtarit të komunës së Rahovecit, z. Nehat mbledhje këto të mbajtura me rastin e vdekjes së ish kuvendarit të komunës
- 2 (dy) mbledhje komemorative më datë 10.02.2022 dhe më datë 31.10.2022 , së Rahovecit.
 - 2 (dy) mbledhje soleme, ma datë 05.03.2022 për nderë të manifestimit të Epopes së UÇK-së dhe 14.06.2022 për nder të ditës së çlirimit të Komunës së Rahovecit.
 - 1 (një) mbedhje të jashtëzakonshme, e mbajtur me 16.12.2022;
 - 12 (dymbëmbëdhjetë) mbledhje të rregullta;

nenit 43.2 të LVL-ës, ku në përfundim janar- dhjetor 2022 ka mbajtur:

Bazuar në këtë, Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka përmbyshur obligimin ligjor sipas pesë mbledhje në gjashtëmuorin e dytë.

Kuvendit të Komunës, ku pesë mbledhje duhet të mbahen në gjashtëmuorin e parë dhe të Komunës. Ky ligj ka normuar mbajtjen e së paku dhjetë (10) seancave në vit të Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka përcaktuar rregullat e mbajtjes së takimeve të Kuvendit

MBLEDHJET E KUVENDIT TË KOMUNËS DHE KOMITETEVE

Auditim të Brendshëm.

Poastu në Komunën tonë nga ana e kryetarit është i themeluar edhe i Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

tyre. Në Komunën tonë është janë themeluar Komiteti për Arsim dhe Komiteti për konsultative për të cilat konsideron se janë të nevojshme për kryerjen e përgjegjësiëve të Komitetit e Tjera ose Konsultative - Kuvendi i Komunës themelon komitete të tjera ose

KOMITETET E TJERA OSE KONSULTATIVE

gjastë (6) mbledhje të rregullta.

në mënyrë të rregullit dhe në përbërje të plotë, dhe gjatë këtij viti ka mbajtur gjithsej Komiteti për Komunitete si komitet i përhershëm në këtë dymbëdhjetë muor ka vepruar komuniteteve brenda komunës.

fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të të avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor,

Të gjitha mbledhjet kanë qenë të hapura për publikun duke përfshirë edhe mbledhjet e komiteteve. Si rregull, mbledhjet e komiteteve mbahen para mbledhjeve të Kuvendit. Duke marrë parasysh përgjegjësitë e dhëna me Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale Nr.03/L-040, komitetet shqyrtojnë agjendën nga Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit, ofrimi i rekomandimeve, shqyrtimi i propozim-akteve. Vlen të theksohet se në 11 (njëmbëdhjet) mbledhjet e Kuvendit Komunal në Rahovec për vitin 2022, ka qenë prezent, Kryetari i Komunës së Rahovecit, kurse drejtorët kanë qenë prezent në të gjitha mbledhjet e kuvendit

MBLEDHJET E KUVENDIT

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen të dhënat statistikore për zhvillimet dhe ecuritë e punimeve të Kuvendit të Komunës së Rahovecit dhe komiteteve, për periudhën një veçare. Në tabelë janë të paraqitura numri i seancave të mbajtura dhe lloji i mbledhjeve për periudhën janar-dhjetor 2022.

Seancat e Kuvendit Komunal	Seanca të rregullta	Seanca jashtëzakonshme	Seanca të tjera(solemne, komomorative)	Nr. i seancave për muaj	Pika në rend dite
Janar	1			1	6
Shkurt	1		1	2	13
Mars	1		1	2	14
Prill	1			1	13
Maj	1			1	13
Qershor	1		1	2	18
Korrik	1			1	5
Gusht	1			1	10
Shtator	1			1	8
Tetor	1		1	2	13
Nëntor	1			1	10
Dhjetor	1		1	2	21
Gjithsesj:	12		5	17	144 pika të rendit të ditës

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

VENDIMET E KUVENDIT PËR VITIN 2022

Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjet e mbajtura në vitin 2022 i ka aprovuar gjithsej 100 (njëqind) vendime.

Në tabellat e mëposhtme i keni të cekur të gjitha vendimet që janë aprovuar nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit për vitin 2022.

Emërtimi i Vendimit	Data e aprovimit
1	Vendim për Themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
2	Vendim për themelimin e komitetit të përbërës
3	Vendim për themelimin e komitetit për Komunitete
4	Vendim për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa
5	Vendim i Kuvendit - Për mbulimin e shpenzimeve të varimit për vitin 2022.
6	Vendim i Kuvendit - Për bartjen e mjeteve velanake të pasqepëzuar nga viti 2021 në vitin 2022.
7	Vendim i Kuvendit - për caktimin e komitetit për përzgjedhjen e drejtoreve të shkollave.
8	Vendim i Kuvendit - Për emërimin e komitetit komunal të aksionarëve KRM Ekoregjioni në Rahovec.
9	Vendim i Kuvendit - për emërimin e komitetit komunal të aksionarëve Stacioni i Autobusëve në Rahovec.
10	Vendim i Kuvendit - Për emërimin e komitetit për shqyrtimin e ankesave për zgjedhjen e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane.
11	Vendim i Kuvendit - Për emërimin e komitetit për zgjedhjen e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane.
12	Vendim i Kuvendit - Për formimin e komitetit për vlerësimin e performancës së kontratës për dhënie të shfrytëzimit të pronës komunale.
13	Vendim i Kuvendit - Për shpalljen në interes të përgjithshëm të parcelave në Rahovec për ndërtimin e çerdhës.
14	Vendim i Kuvendit - Për shpalljen në

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

	interes të përgjithshëm të pjesës së parcelës në Rahovec për zgjerimin e rrugës publike.	
15	Vendim për themelimin e Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe.	28.02.2022
16	Vendim për caktimin e komisionit ad hoc për shqyrtimin e kërkesave të kandidatëve për Këshillin e fshatit Hoçë e Madhe.	30.03.2022
17	VENDIM I KUVENDIT-Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e morgut në fshatin Hoçë e Vogël	30.03.2022
18	Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit në fshatin Çifllak.	30.03.2022
19	Vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të dhënies në shfrytëzim të pronës së komunës.	30.03.2022
20	Vendim për këmbimin e pronës komunale me pronën private	30.03.2022
21	Vendim për miratimin e Strategjisë për informim dhe komunikim 2022 - 2025.	30.03.2022
22	Vendim për plotësim dhe ndryshimin e vendimit për iniciimin e procedurave për themelimin e Këshillit për Fshatin Hoçë e Madhe	30.03.2022
23	Vendim për shpalljen në interes të përgjithshëm të parcelave për ndërtimin e parkut energjetik.	30.03.2022
24	Vendim për shpalljen në interes të përgjithshëm të parcelës në Rahovec për ndërtimin e parkut rekreativ.	30.03.2022
25	Vendim për shpalljen në interes të përgjithshëm të pjesës së parcelës në Pastasellë për aktivitete kulturore.	30.03.2022
26	Vendim për themelimin e Çmimit Ukshin Hoti	30.03.2022
27	Vendim për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2021 në vitin 2022.	29.04.2022
28	Vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale për blegtori.	29.04.2022
29	Vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale për bujqësi.	29.04.2022
30	Vendim për formimin e komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër.	29.04.2022
31	Vendim për formimin e komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër	29.04.2022
32	Vendim për formimin e komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave, parqeve, shesheve dhe lagjeve	29.04.2022
33	Vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për emërtimin e rrugëve	29.04.2022

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

34	Vendim për miratimin e Planit komunal për integritet 2022 2026	29.04.2022
35	Vendim për shpalljen në interes të përgjithshëm të parcelës në Xërxë P- 71510033-00527-1	29.04.2022
36	Vendim për shpalljen në interes të përgjithshëm të parcelës në Xërxë P- 71510033-00527-2	29.04.2022
37	Vendim për vazhdimin e kontratës për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës në bazë të performancës	29.04.2022
38	Vendim për bartjen e mjeteve rezervë në kuadër të investimeve kapitale - 2022	31.05.2022
39	Vendim për caktimin e lokacionit për hapësira për biznesë	31.05.2022
40	Vendim për miratimin e listës së anëtarëve të zgjedhur të Këshillit të Fshatit Hogë e Madhe	31.05.2022
41	Vendim për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Arsim	31.05.2022
42	Vendim për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale	31.05.2022
43	Vendim për plotësimi dhe ndryshimi i vendimit 295 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit në Çifllak	31.05.2022
44	Vendim për plotësimi dhe ndryshimi i vendimit 296 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e morgut në Hogë të Vogel	31.05.2022
45	Vendim për plotësimi dhe ndryshimi i vendimit për formimin e komisionit për emërtimin dhe rënietimin e rrugëve	31.05.2022
46	Vendim për shpalljen në interes të përgjithshëm të parcelës në Krushë të Madhe	31.05.2022
47	Vendim për themelimin e Komitetit për Arsim dhe Shëndetësi	31.05.2022
48	Vendim për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale - Parku i gytetit	26.06.2022
49	Vendim për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale - Parku i gytetit	26.06.2022
50	Vendim për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale në Xërxë - Te depoja (2)	26.06.2022
51	Vendim Për formimin e komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pr (3)	26.06.2022
52	Vendim Për formimin e komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pr (5)	26.06.2022
53	Vendim Për formimin e komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale	26.06.2022

54	Vendim Për këmbimin e pronës komunale me pronën e institucionit qendror - Ekonomia e Pyjeve	26.06.2022
55	Vendim Për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore (KAB) 2023-2025	26.06.2022
56	Vendim për shfuqizimin e vendimit për formim të komisionit për emërtimin e rrugëve	26.06.2022
57	vendim për shfuqizimin e vendimit për shpalljen me interes publik në Krushë të Madhe	26.06.2022
58	Vendim për shpalljen në interes të përgjithshëm të pjesës së parcelës në Mrasor	26.06.2022
59	Vendim për shpalljen në interes të përgjithshëm të pjesës së parcelës në Retijë	26.06.2022
60	Vendim i Komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së komunë P-05864-0.	30.08.2022
61	Vendim i komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së komunë	30.08.2022
62	Vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale në Dobidol P- 00010-100010-2	30.08.2022
63	Vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale në Rahovec P - 05864-0	30.08.2022
64	Vendim për formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve	30.08.2022
65	Vendim për shfuqizimin e vendimit 01 Nr. 337.22 i datës 29.06.2022 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës	30.08.2022
66	Vendim për shfuqizimin e vendimit 01 Nr. 339.22 i datës 29.06.2022 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës	30.08.2022
67	Vendim për shpalljen në interes të përgjithshëm të pjesës së parcelës në Rahovec	30.08.2022
68	Vendim Për lirim nga taksa komunale për bujqit për shkak të vërshimeve	23.09.2022
69	Vendim Për miratimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave	23.09.2022
70	Vendim Për miratimin e Programit komunal tre vjeçar për banim 2022 - 2024.	23.09.2022
71	Vendim Për shpalljen në interes të përgjithshëm të parcelës në Xerxe	23.09.2022
72	Vendim për miratimin e buxhetit për vitin 2023	23.09.2022
73	Vendim - për caktimin e normave tatimore për vitin 2023	28.10.2022

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

74	Vendim - për këmbimin e pronës komunale me pronën private në Rahovec	28.10.2022
75	Vendim - për miratimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2022-2027	28.10.2022
76	Vendim - për miratimin e Planit për trashëgimi kulturore 2022-2025	28.10.2022
77	Vendim - për miratimin e Programit komunal tre vjeçar për banim 2022 - 2025	28.10.2022
78	Vendim - për ri-alokim dhe transfer të mjeteve buxhetore për vitin 2022	28.10.2022
79	Vendim i komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimit e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtyr të pronës së komunës	25.11.2022
80	Vendim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë 99 vite të pronës Komunale në Rahovec - Fondacionit ADRIAN ORLLATI	25.11.2022
81	Vendim për lirim nga pagesa e Mamografisë për të gjitha femrat e Komunës së Rahovecit	25.11.2022
82	Vendim për plotësimi dhe ndryshimi i vendimit për gëminin Sulejman Krasniqi	25.11.2022
83	Vendim për shfuqizimin e vendimit për Shpalljen me interes të përgjithshëm publik parcelën P-71510033-01041-1 në Zonën Kadastrale Xërxe	25.11.2022
84	Vlerësimi i nevojës nga Falkeqësitë natyrore dhe falkeqësitë e tjera për Komunën e Rahovecit	25.11.2022
85	Vendim për mbulimin e shpenzimeve të varitimit për vitin 2023	28.12.2022
86	Vendim për miratimin e Planit të Punës të KKS-së për vitin 2023	28.12.2022
87	Vendim për miratimin e planit të punës të Kryetarit të Komunës për vitin 2023.	28.12.2022
88	Vendim për miratimin e Planit të Punës të Kuendit të Komunës për vitin 2023.	28.12.2022
89	Vendim për miratimin e Planit të transportit rrugor lokal në Komunën e Rahovecit 2022-2027.	28.12.2022
90	Vendim për miratimin e Raportit mbi regjistrimin dhe vlerësimin e dëmeve në amvisëti	28.12.2022
91	Vendim për miratimin e vendimit për Lulëkuqja me katër petale	28.12.2022
92	Vendim për ndryshimin dhe plotësimin për formimin e komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimit e ofertave	28.12.2022
93	Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për dhënie në shfrytëzim afatshkurtyr të pronës - Xërxe	28.12.2022

94	Vendim për ndryshimin dhe plotësimin për formimin e komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave	28.12.2022
95	Vendim për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete	28.12.2022
96	Vendim për shpalljen në interes të përgjithshëm të parcelës në Xerxe	28.12.2022
97	Vendim plotësimi dhe ndryshimi i vendimit për themelimin e KPF	28.12.2022
98	Vendim për miratimin e Planit të vlerësimit të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për Komunën e Rahovecit	28.12.2022
99	Vendim për miratimin e Planit të Mobilitetit Urban për Komunën e Rahovecit 2022-2027	28.12.2022
100	Vendim për hapjen e shqyrtimit publik për Planin Zhvillimor Komunal	16.12.2022 Mbledhja e Jashtëzakonshme

RREGULLORET DHE PLANT PËR VITIN 2022

Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjet e mbajtura në vitin 2022 i ka aprovuar gjithsej 2(dy) rregullore, 9 (nëntë) plane, 1 (një) Statut dhe 1 (një) program.

Në tabelaqarqin e mëposhtëm i keni të cekur të gjitha vendimet që janë aprovuar nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit për vitin 2022.

	Emërtimi i Rregulloreve, Planeve	Data e aprovimit
1	Rregullore për Menaxhimin e Pasurisë jo financiare dhe inventari i papërdorshëm i komunës	30.03.2022
2	Rregullore për dhenien e titujve të nderit-mirënjohjeve dhe dekoratave të Komunes së Rahovecit	30.03.2022
3	Programi komunal tre vjeçar për banim 2022 - 2024.	23.09.2022
4	Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2022-2027	28.10.2022
5	Planit për trashëgimi kulturore 2022-2025	28.10.2022
6	Programi komunal tre vjeçar për banim 2022 - 2025	28.10.2022
7	Statuti i QKMF-së	28.10.2022
8	Planit të Mobilitetit Urban për Komunën e Rahovecit 2022-2027.	28.12.2022
9	Planit të Punës të KKS-së për vitin 2023	28.12.2022
10	Planit të punës të Kryetarit të Komunës për vitin 2023.	28.12.2022

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC



Në vijim të raportit do të gjeni edhe fotografi të realizuara gjatë mbajtjes së Kuvendit të Komunes të kryesuar nga Kryesuesi i Kuvendit z. Defrim Kafexhiu;

Kuvendi i Komunes sëR ahovecit gjithsej i ka aprovuar 100 vendime, të gjitha vendimet pas aprovimit janë dërguar nga ana e sekretarisë për shqyrtim të ligjshmërisë në Ministrinë e Administratës dhe Poushtetit Lokal (MAPL), Numri i konfirmimeve të ligjshmërisë së vendimeve nga ana e MAPL-së kanë qenë: 71 vendime, ku prej tyre 8 vendime kanë qenë në rishqyrtim.

KONFIRMIMET E LIGJSHMERISËDHE RISHQYRTIMET E VENDIMEVE NGA ANA E MAPL-SË PËR VITIN 2022

11	Planit të Punës të Kuvendit të Komunes për vitin 2023.	28.12.2022
12	Planit të transportit rrugor lokal në Komunën e Rahovecit 2022-2027.	28.12.2022
13	Planit të vlerësimit të pezigeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera	28.12.2022

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Komiteti për Politik dhe Financa është themeluar me datë 25.01.2022.

Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur gjithsej dymbëdhjetë (11) mbledhje për periudhën: janar – dhjetor 2022.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen të dhënat statistikore për zhvillimet dhe ecuritë në Komitetin për Politikë dhe Financa të Komunës së Rahovecit për periudhën janar - dhjetor të vitit 2022. Në tabelë janë të paraqitura numri i seancave të mbajtura dhe lloji i mbledhjeve për periudhën janar- dhjetor 2022.

Komiteti Politikë Financa	për dhe	Mbledhje rregullta	të	Nr.i mbledhjeve për muaj	Pika në rend dite
Janar					
Shkurt		1		1	14
Mars		1		1	15
Prill		1		1	17
Maj		1		1	12
Qershor		1		1	11
Korrik		1		1	5
Gusht		1		1	11
Shtator		1		1	8
Tetor		1		1	13
Nëntor		1		1	7
Dhjetor		1		1	18
Gjithsesj:		11		11	131 pika të rendit të ditës

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

Njëra ndër parimet bazë për një qeverisje të mirë është zotimi se do të mbahen konsultime publike. Arsyeja pse është përzgjedhur ky zotim është që të fuqizohet qeverisja e mirë, bazë e së cilës është pjesëmarrja qytetare në draftim të politikave lokale përfshirë buxhetin, për një qeverisje gjithëpërfshirëse.

Ligji për Menaxhimin e Financave Publike, neni 61 e obligon Kuvendin Komunal pas pranimi të propozim buxhetit të mbajë dëgjime buxhetore dhe më pas ta shqyrtojë dhe ndryshojë (sic e sheh të arsyeshme) draft buxhetin sipas inputit të qytetarëve, ndërsa Udhëzimi Administrativ për Transparencë në Komuna ofron detaje se si duhet të informohen qytetarët për takime publike, përfshirë dëgjimet buxhetore, dhe detajon procedurat për mbarrëvajtjen e tyre.

Në bazë të neni 68, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, neni 61 paragrafi 2 Të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit Nr.03/L-048, neni 17, 18 pika 1.7 dhe 19 i Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryesuesi i Kuvendit në koordinim me Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, organizojnë dëgjime publike rreth përgatitjes së buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2023.

DËGJIMET BUXHETORE PËR VITIN 2022



Rahovec 2, Defrim Kafexhiu.

Në vijim të raportit do të gjeni Fotografi të paraqitura gjatë mbajtjes së mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa të kryesuara nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal

INFORMIMI RRETH MBAJTJES SË DËGJIMEVE BUXHETORE

Një nga sfidat kryesore të dëgjimeve buxhetore është mënyra e informimit të qytetarëve. UA për transparencë i obligon komunat që paralajmërimin e publikut për mbajtje të takimeve publike ta bëjnë përmes shpalljeve publike, mediave, ueb faqes dhe rrjeteve sociale të komunës 14 ditë para mbajtjes së dëgjimit. Komuna e Rahovecit ka bërë njoftimin për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore 14 ditë para mbajtjes së takimeve përmes shpalljeve publike, mediave, ueb faqes dhe rrjeteve sociale të komunës. Njoftimi ka përfshirë informata si data, koha dhe vendi i takimit,

Komuna e Rahovecit I ka mbajtur gjithsej 5 degjime publike, ekzekutivi 4 (katër) nga data 15-18 gushtë 2022 dhe 1 (një) dëgjim mpublik KPF-ja me datë 14 shtator 2022.

Dëgjimet buxhetore janë mbajtur në disa vendbanime, duke përfshirë edhe lagjet urbane në qytetin e Rahovecit, përpos Lagjjes së Epërme ku banon komuniteti jo shumicë, arsyeja është mos interesimi i banorëve të asaj lagjeje.

Dëgjimet publike publike për përgatitjen e buxhetit për vitin 2023, janë përcjellur edhe nga Zyra e Kuvendit Komunal Rahovec, si dhe Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, nga zyrtari për informim çdo ditë pas mbajtjes së dëgjimit publik në ueb faqen zyrtare të komunës së Rahovecit, janë publikuar të dhënat e mbajtjes së dëgjimeve me fotografi dhe të dhëna tjera të nevojshme.

Gjatë mbajtjes së dëgjimeve publike me qytetarë për përgatitjen e buxhetit për vitin 2023 Komiteti për Politikë dhe Financa i kryesuar nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal z.Defrim Kafexhiu, Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa z.Afrim Limani kanë përcjellur vazhdimisht ecurinë e dëgjimeve publike me qytetarë të Komunës së Rahovecit për përgatitjen e buxhetit për vitin 2023, Komiteti për Politikë dhe Financa konsiderohet si organi kryesor i Kuvendit të Komunës, i cili shqyrton paraprakisht pothuajse të gjitha çështjet që parashihen të shqyrtohen në Kuvendin e Komunës.

Komiteti për Politikë dhe Financa, posaçërisht, dhe Kuvendi i Komunës në përgjithësi, kanë përgjegjësi të madhe në fazat e planifikimit dhe mbikëqyrjes së financave komunale. Në fazën e planifikimit, Komiteti për Politikë dhe Financa shqyrton dokumente të rëndësishme si buxheti komunal, korniza afatmesme buxhetore komunale, plani i prokurimit dhe i jep rekomandimet për veprime Kuvendit të Komunës.

Kuvendi i Komunës duke marrë parasysh edhe rekomandimet nga komiteti për politikë dhe financa, do të shqyrtojë, dhe në rast pajtimi, të miratojë, dokumentet kyçe të komunës që lidhen me menaxhimin e financave komunale.

Kryesuesi i KK-Rahovec z. Dëftim Kafexhiu, pasuar më pas nga drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa z. Afrim Limani i cili në secilin degjim të mbajtur ofroi informacionet e nevojshme lidhur me ndajen e kategorive të buxhetit në ; Paga dhe Medite, Mallra dhe Shërbime, Shërbime Komunale, Subvencione e transfere dhe Investime Kapitale, të pranishmit në secilin degjim publik të mbajtur patën mundësi të informoheshin nga drejtori i DBF-së edhe për totalin e buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2023 e që në tërësi është: 17,548,240.00 €

MONITORIMI I MBLLEDHJEVE

Monitorimi i mbledhjeve edhe gjatë këtij viti ka qenë i vazhdueshëm, puna dhe angazhimi ynë është monitoruar nga OSBE-ja, SHL-Kosova –Rahovec, KFOR-i, OJQ-të lokale si dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e cila vazhdimisht përcjell punën, aktivitetet dhe verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve tona. Gjithashtu, mbledhjet e Kuvendit Komunal Rahovec, janë regjistruar (xhiruar) rregullisht dhe janë transmetuar online për qytetarët e Komunës së Rahovecit.

RAPORTIMI I KRYETARIT TË KOMUNËS

Sistemi i qeverisjes lokale është një njësi e gjere e cila përfshin edhe bashkëpunimin në mes të Ekzekutivit të komunës dhe Kuvendit me qëllim të realizimit të politikave publike në dobi të qytetarëve. Për këtë qëllim, mbikëqyrja dhe raportimi përbëjnë një proces mjaft të rëndësishëm të qeverisjes lokale, përmes të cilit mundësohet përcjellja sistematike e ngjarjeve dhe aktiviteteve brenda komunës. Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka përcaktuar përgjegjësinë e Kryetarit të Komunës për të raportuar në baza të rregullta ose atëherë kur kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Kryetari i Komunës së Rahovecit i paraqet me shkrim raportet në Kuvendin e Komunës. Formë tjetër e raportimit është edhe ajo verbale, ku anëtarët e Kuvendit parashitrojnë pyetje të drejtpërdrejta apo me shkrim, varësisht nga natyra e çështjes. Praktika të tilla, janë parë si mundësi e mirë e llogaridhënies së Ekzekutivit para Kuvendit të komunës dhe ofrimit të përgjigjeve për shumë çështje.

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

NJOFTIMET PËR MBLEDHJE DHE MATERIALET PËRCJELLËSE

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës, Planit të Punës së Kuvendit të Komunës, Rregullores së Punës së Kuvendit për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës, edhe për mbledhjet e të gjitha komiteteve të Kuvendit të Komunës, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët e Komunës së Rahovecit janë njoftuar me kohë, shtatë (7) ditë pune para mbledhjeve të rregullta, përmes shpalljes së njoftimeve publike në vendet e frekuentuara, si dhe përmes faqes zyrtare të komunës në internet.

Gjatë njoftimit dhe ndarjes së materialeve të mbledhjes është respektuar Ligji për Përdorimin e Gjuhëve. Njoftimet dhe materialet gjithashtu u janë dërguar edhe Ministrisë së Administrimit Lokal (MAPL) konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

ÇËSHTJET E DISKUTUARA NË KUVEND- AKTET E KUVENDIT TË KOMUNËS

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2022, Kuvendi Komunal Rahovec ka zhvilluar 12 seanca të rregullta. Në kuadër të këtyre seancave është diskutuar për çështje të ndryshme me gjithsej 144 pika të rendit të ditës. Nga çështjet të cilat janë diskutuar në Kuvend, vërehet që për këtë periudhë dymbëdhjetë mujore kemi disa akte të ndryshme komunale qofshin ato rregullore, vendime, plane, raporte, informata të ndryshme. Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhëna për llojin dhe numrin e akteve komunale që ka miratuar Kuvendi i Komunës nga fushëveprimtaria e vet.

Siç mund të shihet nga tabela, për periudhën: janar - dhjetor 2023 Kuvendi i Komunës ka nxjerrur këso lloj aktesh:

AKTE	NR.
RREGULLORE	2
STATUT	1
PLANE	9
VENDIME	100
RAPORTE	13
INFORMATA	3
GJITHSEJ:	128

PUBLIKIMI I AKTEVE NË UEB-FAQEN ZYRTARE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT

Si mjet kryesor për të ofruar qasjen e publikut në këto të dhëna, janë faget zyrtare elektronike. Gjatë kësaj periudhe raportuese, të gjitha aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës janë publikuar në fagen elektronike të Komunës së Rahovecit.

SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE

Ministria e Pushtetit Lokal është autoritet mbikqyrës i komunave për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve, andaj gjatë periudhës janar - dhjetor 2022 të gjitha aktet apo vendimet që janë marrë në Kuvendin e Komunës së Rahovecit, i janë dërguar nga zyra e kuvendit për shqyrtimin e ligjshmërisë, Ministrisë së Pushtetit Lokal. Numri i Konfirmimit të ligjshmërisë së vendimeve të kihyera nga MAPL-ja është gjithsej 71.

Nga 71 konfirmime, për 8 (tete) vendime është rishqyrtimi i tyre bazuar në rekomandimet e dhëna nga ta. Bazuar në këto rekomandime, vendimet janë rishqyrtuar dhe janë miratuar në përputhje me rekomandimet e MPL-së.

Më poshtë e gjeni tabelarin me vendimet të cilat janë kthyer për rishqyrtim nga MAPL-ja.

N	r	Emri i aktit	Emri i Komunës	Data e dërgimit ne Ministri	Data e kthimit te kërkesës për rishqyrtim nga MPL ne komunë	Data e rishqyrtimit dhe harmonizimit nga kuvendi i komunës
1.		Vendimi Nr. 01/272/22 Për iniciimin e procedurave themelimit e Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe	KK - Rahovec	03.03.2022	25.03.2022	30.03.2022
2		Vendimi Nr.01/296/22 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e morgut për nevojat e komunitetit të fshatit	KK - Rahovec	05.04.2022	12.05.2022	31.05.2022

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

	Hoçë e Vogel				
3	Vendimi Nr. 295/22 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Çifllak	KK – Rahovec	05.04.2022	12.05.2022	31.05.2022
4	Vendimi Nr.334/22 për ndryshim dhe plotësimin e vendimit Nr.306/22 për formimin e komisionit për riemërtimin e rrugëve, rrugicave, çarqeve, shesheve dhe lagjeve në Komunën e Rahovecit	KK - Rahovec	06.06.2022	17.06.2022	29.06.2022
5	Vendimi Nr.332/22 për caktimin e lokacionit për hapësira për biznese	KK – Rahovec	06.06.2022	17.06.2022	29.06.2022
6	Vendim Nr.372/22 për miratimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave	KK- Rahovec	26.09.2022	06.10.2022	28.10.2022
7	Vendim Nr.374/22 për miratimin e Programit komunal tre vjeçar për banim 2022-2024	KK – Rahovec	26.09.2022	06.10.2022	28.10.2022
8	Vendim Nr.375/22 për shpalljen me interes të përgjithshëm P-01041-1 zona kadastrale Xerxe	KK- Rahovec	26.09.2022	06.10.2022	28.10.2022

Ky raport përmbledhës paraqet aktivitetet që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.

Raporti i punës i Kuvendit Komunal- Rahovec, është dëshmi e respektit ndaj Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, në frymën e transparencës, llogaridhënies dhe performances sa më të mirë komunale dhe i dedikohet të zgjedhurve nga qytetarët, monitoruesve dhe publikut të gjerë.

Mirëpresim kontributin e secilit që përmes vërejtjeve, këshillave, plotësimeve apo të dobësive eventuale, që t'i bëjnë bashkërisht përmirësimet e nevojshme, në mënyrë që në të ardhmen ta bëjnë sa më mirë punën tonë.

Ju falënderim!

01 Nr. ____/23
Datë: 00.01.2023

Udhëheqës për punë të Kuvendit

Skender Hamza

Kryesuesi i Kuvendit

Defrim Kafexhiu



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly of Rahovec



Këshilli i fshatit Hoçë e Madhe

Raporti vjetor i punës së Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe

Janar 2023

Përmbajtja

Raporti vjetor i punës së Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe	1
Hyrje:.....	3
Themelimi i Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe:.....	3
Puna e këshillit të fshatit Hoçë e Madhe:	4
Mbledhja e parë konstituive është mbajtur me 14. Korrik 2022, me këtë rend dite:	4
Mbledhja e dytë e rregullt është mbajtur 03. Gusht 2022, me këtë rend dite:	4
Mbledhja e tretë urgjente është mbajtur me 01. Shtator 2022, me këtë rend dite:.....	4
Mbledhja e katër e rregullt është mbajtur me 05. Tetor 2022, me këtë rend dite:	5
Mbledhja e pestë e rregullt është mbajtur me 03. Nëntor 2022, me këtë rend dite:.....	5
Mbledhja e gjashtë e rregullt është mbajtur me 01. Dhjetorë 2022, me këtë rend dite:	6
Përfundimi:	6

Hyrje:

Këshilli për fshatin Hoçë e Madhe është këshill i cili themelohet nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-62 për fshatin Hoçë e Madhe si dhe Udhëzimin e Administrativë Nr. 11/2014 për themelimin, zgjedhjen, përgjegjësit dhe funksionimin e Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe.

Qëllimi i themelimit të Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe është në radhë të parë thellimi i bashkëpunimit të institucioneve lokale dhe atyre qendrore me qëllim të lehtësimit dhe ofrimit të mundësive sa më të mira në provimin e monumenteve kulturore, fetare, brenda zonës së veçant të mbrojtur. Po ashtu qëllimi i miratimit të ligjit Nr. 04/L-62 është përcaktimi i rregullave për mbrojtjen, administrimin dhe zhvillimin bashkëkohor i fshatit Hoçë e Madhe.

Themelimi i Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe:

Këshilli për fshatin Hoçë e Madhe themelohet nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit duke i respektuar dispozitat Ligjore të Ligjit Nr. 04/L-62 për fshatin Hoçë e Madhe si dhe dispozitat e Udhëzimit të Administrativë Nr. 11/2014 për themelimin, zgjedhjen, përgjegjësit dhe funksionimin e Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe.

Procesi i zgjedhjes së anëtarëve të ri të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe është iniciuar dhe përfunduar nga ana e Kuvendit të Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.05.2022, duke nxjerr Vendim nr 328/22 me të cilin janë emëruar anëtarë të ri të këtij Këshilli dhe të cilët do të shërbejnë me kohëzgjatje si mandati i anëtarëve të ri të Kuvendit të Komunës së Rahovecit.

Pas përfundimit të procesit të zgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të ri të Këshillit gjegjësisht themelimit të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, Kryesuesi i Kuvendit fton anëtarët e ri në mbledhje me qëllim të themelimit, zgjedhjes dhe informimit të kryesuesit për punën dhe përkrahjen në vazhdimësi të institucioneve lokale dhe qendrore.

Puna e këshillit të fshatit Hoçë e Madhe:

Pas themelimit dhe mbledhjes së parë konstituive, Këshilli i fshatit në krye me kryesuesin e Këshillit të fshatit organizon mbledhje me qëllim të shqyrtimit të kërkesave të anëtarëve të Këshillit apo të institucioneve dhe qytetarëve në fushën e planifikimit, mbrojtjes, promovimit të monumenteve historike e kulturore në zonën e veçantë të mbrojtur të fshatit Hoçë e Madhe.

Në periudhën kohore 14. Korrik deri me 01. Dhjetor janë mbajtur gjithsej 6 mbledhje dhe atë: 1. Mbledhje konstituive, 1 mbledhje urgjente dhe 4 mbledhje të rregullta.

Mbledhja e parë konstituive është mbajtur me 14. Korrik 2022, me këtë rend dite:

1. Emërimi i Kryesuesit të Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe.

Këtë mbledhje e Kryesoi Kryesuesi i Kuvendit i cili fillimisht ju uroj anëtarëve të ri pranimin e detyrës së re dhe pas konstatimit të kuorimit vazhdoj me procesin e propozimit dhe përzgjedhjes së Kryesuesit të Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe.

Gjatë këtij procesi, të pranishmit propozuan dhe në mënyrë unanime zgjodhën kryesuesin e Këshillit **z. Bojan Nakallamiq**, ndërsa për zëvendës kryesues është propozuar dhe zgjedhur **z. Miroslav Llukiq**.

Mbledhja e dytë e rregullt është mbajtur 03. Gusht 2022, me këtë rend dite:

1. Zgjidhja e çështjes së punësimit të punëtorit të riadministrativ pran zyrës së Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe
2. Të ndryshme.

Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i mbledhjes, i cili konstatoj kuorumin, prezantoi dhe aprovoi rendin e ditës, më pastaj kaloi tek pika e parë e rendit të ditë nga e cila u arrit pajtimi i të gjithë anëtarëve të Këshillit që me kërkesë t'ju drejtohen Kryetarit të komunës (ekzekutivit) dhe Kryesuesit të Kuvendit të Komunës (legjislativit) me qëllim të zgjedhjes, emërimit të administratorit të zyrës i cili do ti kryej të gjitha punët e nevojshme administrative për funksionimin sa më të mirë të vetë Këshilli.

Mbledhja e tretë urgjente është mbajtur me 01. Shtator 2022, me këtë rend dite:

1. Shqyrtimi i mjeteve të parapara në kuadër të Kornizës Afatmesme Buxhetore, për zyrën e Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe.
2. Të ndryshme

Kjo mbledhje është ftuar dhe kryesuar me urgjencë nga ana e Kryesuesit të Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe me qëllim të shqyrtimit dhe destinimit të mjeteve të ndara për funksionimin e zyrës dhe realizimit të aktiviteteve të nevojshme të Këshillit.

Gjatë mbledhjes anëtarët janë pajtuar dhe kanë rekomanduar që Drejtorisë për Financa dhe Buxhet ti ofrohet plani i shpenzimeve të mjeteve financiare, në formë të tabelarit, ku janë të parapara dhe të caktuara shpenzimet e mjeteve për funksionimin e zyrës dhe realizimit të aktiviteteve të Këshillit.

Mbledhja e katër e rregullt është mbajtur me 05. Tetor 2022, me këtë rend dite:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
2. Shqyrtimi i projekteve infrastrukturore në fshatin Hoçë e Madhe.
3. Të ndryshme.

Kjo mbledhje e rregullt është ftuar me qëllim të identifikimit të hapësirave pranë monumenteve kulturore e historike, hapësira këto të cilat kanë nevojë për intervenime infrastrukturore me qëllim të ofrimit të qasjes sa më të mirë pranë monumentit. Gjatë shqyrtimit të kësaj pike, anëtarët janë pajtuar dhe kanë konstatuar që është më se i nevojshëm bashkëpunimi i denjë me të gjitha institucione relevante në hartimin e planit të konservimit i cili në hollësi do ti parasheh investimet e nevojshme në hapësirat e caktuara brenda zonës së veçantë të mbrojtur.

Mbledhja e pestë e rregullt është mbajtur me 03. Nëntor 2022, me këtë rend dite:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
2. Shqyrtimi i projekteve ideore nga fusha e trashëgimisë kulturore,
3. Të ndryshme.

Kryesuesi i mbledhjes, pas aprovimit të rendit të ditës dhe procesverbalit të mbledhjes së kaluar, nga të pranishmit ka kërkuar sqarime shtesë lidhur me iniciativën dhe procesin e shqyrtimit të projekteve ideore në fushën e konservimit, mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore e historike në fshat.

Gjatë kësaj mbledhje zyrtari i OSBE-së është shprehur i gatshëm që të organizohet një seminar i cili do ti mundësoj anëtarëve të ri të Këshillit që të informohen për kompetencat e anëtarëve dhe funksionimin sa më të mirë të Këshillit.

Mbledhja e gjashtë e rregullt është mbajtur me 01. Dhjetorë 2022, me këtë rend dite:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
2. Konkluzionet lidhur me seminarin e organizuar nga OSBE -ja,
3. Të ndryshme.

Kjo mbledhje është ftuar me qëllim të informimit të anëtarëve të Këshillit të cilët nuk kanë marr pjesë në seminarin e organizuar. Gjatë mbledhjes, të gjithë anëtarë të Këshillit e falënderuan OSBE-në për përkrahjen e ofruar dhe shprehën nevojën për mbajtjen e seminareve dhe trajnimeve të cilët e sqarojnë kompetencat dhe rolin e tyre si anëtarë.

Përfundimi:

Roli i Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe është promovimi, mbrojtja si dhe konservimi i monumenteve kulturore e fetare brenda zonë së veçantë të mbrojtur, e cila përkufizohet në Ligjin Nr. 03/L-039/2008 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura.

Në këtë drejtim ne si anëtarë të zgjedhur të Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe shprehim gatishmëri dhe jemi të hapur për bashkëpunim me të gjithë institucione çofshin ato lokale apo ato qendrore, duke ofruar i të gjitha informatat dhe rekomandimet e nevojshme me qëllim promovimit të monumenteve kulturore historike e fetare si dhe zhvillim ekonomikë e turistik në nivel të komunës.

Në fund shfrytëzojmë rastin të falënderojmë të gjithë për kontributin, bashkëpunim dhe ndihmë e dhënë në realizimin e qëllimeve tona si Këshill.

Me respekt!

**Kryesuesi i Këshillit
për fshatin Hoçë e Madhe**

Bojan NAKALLAMIQ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSJEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR'S CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 26 Nr. i faq./Br.str./No pg 97

Data/Datum/Date 10 / 1 / 23

RAHOVEC/ORAHOVAC



**INFORMATË RRETH AKTIVITETEVE TË KKSBB-SË PËR VITIN
2022**



JANAR – 2023

HYRJE

Të nderuar kuvendarë/e të Kuvendit Komunal të Rahovecit,

Bazuar në ligjin Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, dispozitave të neneve 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB- 03/2012 MAPL dhe Statutin e Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës: 29.03.2017, kemi kënaqësinë të paraqesim para jush raportin vjetor lidhur me aktivitetet, punët, angazhimet dhe arritjet e Këshillit Komunal për Siguri Në Bashkësi përgjatë periudhës janar- dhjetor 2022.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është themeluar me vendim të Kuvendit Komunal me datë 25.01.2022, ku anëtarët e këtij këshilli janë përzgjedhur sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB- 03/2012 MAPL, ku është bërë shpallje publike, në këtë shpallje janë përcaktuar kriteret të cilat duhet t'i plotësoj një kandidat për të qenë pjesë e këtij këshilli.

QËLLIMI I INFORMATËS

Përmes kësaj informate jemi munduar të krijojmë një pasqyrim të qartë për kuvendarët/et dhe qytetarët, lidhur me aktivitetet e dhe punët që janë kryer në Këshillin Komunal Për Siguri në Bashkësi. Kjo informatë ka për qëllim që të rrit transparencën dhe llogaridhënien e Kuvendit të Komunës së Rahovecit karshi qytetarëve.

FUNKSIONIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI NË KOMUNËS E RAHOVECIT

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi funksionon në bazë të legjislacionit i cili është në fuqi në Republikën e Kosovës, ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, dispozitave të neneve 3 dhe 4, udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB- 03/2012 MAPL dhe vendimit të Kuvendit Komunal me datë 25.01.2022

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi udhëhiqet nga Kryetari i Komunës z. Smajl Latifi dhe Koordinatori i KKSB-së z. Skender Hamza.

ANËTARËT E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI JANË:

- 1.1 Fazli Morina - Komandanti i stacionit të Policisë;
- 1.2 Nysret Abazibra - Bashkësia Islame – Rahovec;
- 1.3 Ylvi Shehu - Teqja e Madhe "Shejh Sylejmanit";
- 1.4 Sabahudin Durguti - Teqja e "Haxhi Shej Iliaz Shehu";
- 1.5 Milan Stanojevic - Kisha Ortodokse serbe;
- 1.6 Biljana Nakalamic – Komuniteti serb;
- 1.7 Egzon Hamza - Komuniteti Egjiptian;
- 1.8 Valon Berisha - Komuniteti Romë;
- 1.9 Bujar Morina - Komuniteti Ashkali;
- 1.10 Bajram Morina, Kryesuesi i Komitetit për Komunitete;
- 1.11 Abestrim Rexhepi - përfaqësues i FSK-së;
- 1.12 Alban Gashi - Zyrtar/e për barazi gjinore;
- 1.13 Avni Morina - Drejtor i Drejtorisë për Arsim;
- 1.14 Erseka Cana - Kryetar i Këshillit të Prindërve;
- 1.15 Enis Berisha - KLSP;
- 1.16 Beqir Hamza - KEVSB;
- 1.17 Shani Hoti – Ratkoc, KLSP- Sektori C.
- 1.18 Besmire Bytyqi - Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim;
- 1.19 Vjollca Gurguli - SHL-Kosova;
- 1.20 Lendrit Qelaj - ZKKK;
- 1.21 Shaip Shala - Media lokale;
- 1.22 Fadil Sylka - Komuniteti i bizneseve;
- 1.23 Lulzim Krasniqi- Përfaqësues i Komunitetit të personave me aftës të kufizuar.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSIT E KKSË-SË

Përgatitja e planit vjetor të punës dhe zhvillimi i projekteve për rritjen dhe përmirësimin e sigurisë në bashkësi, identifikimi i dukurive negative, që mund të prishin sigurinë publike dhe rekomandojnë planet e veprimit, bashkëpunojnë me policinë për parandalimin e veprimeve të cilat e kërcënojnë sigurinë në bashkësi. bashkëpunojnë me institucionet qendrore, që merren me sigurinë publike, me qëllim të krijimit të një ambienti më të sigurt në bashkësi. Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me KKSË-të, të komunave fqinje për çështjet e sigurisë në bashkësi, që i tejkalojnë kufijtë e komunës së tyre. Sigurimi i financimit të projekteve nga Kuvendi i Komunës që kanë të bëjnë me sigurinë në bashkësi. Përmes komunës, kërkon nga ndonjë organizatë jo-qeveritare, financimin e projekteve që lidhen me sigurinë në bashkësi, fton në takimet e tyre përfaqësuesit nga MPB dhe institucione tjera gjegjëse, kërkon nga policia përgjigje për rastet që janë me rëndësi për sigurinë në bashkësi, duke mos ndërhyrë në procesin e hetimeve policore. Mbajtja e takimeve të rregullta, bëhet sipas nenit 11, të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012MPB-03/2012 MAPL.

Kuvendi i Komunës, ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të këtij vendimi të anëtareve të KKSË-së.

Anëtarët e KKSË-së kanë mandat të njëjtë me anëtarët e Kuvendit Komunal.

AKTIVITETET E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2022

Në vitin 2022 kryetari i komunës i ka mbajtur gjithsej 7 mbledhje të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, ku të gjitha këto mbledhja janë mbajtur sipas planit të aprovuar për vitin 2022, pra janë respektuar të gjitha pikat e rendit të ditës të planit, gjithashtu ka pasur edhe ndonjë pikë shtesë, kjo është varur nga gjendja dhe situata e cila ka qenë në kohën kur është mbajtur takimi.

Përpos diskutimeve dhe debateve që janë bërë në këto takime sa i përket pikave të rendit të ditës, gjithmonë në fund të takimeve janë marr rekomandimet dhe konkluzat.

Më poshtë do iu paraqesim të gjitha takimet nga mbledhjet e Këshillit për Siguri në Bashkësi: Si dhe pikat e rendit të ditës, poashtu edhe konkluzat që kanë dalë nga këto takime.

Mbledhjet e mbajtura për vitin 2022 nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi janë:

Pikat e rendit të ditës nga Mbledhja e KKSB-së e mbajtur me 21.02.2022

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Informatë rreth situatës së krijuar nga pandemia Covid – 19;
3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;
 - Analizë e sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit për vitin paraprak,
 - Siguria në Trafik,
 - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla,
 - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit,
4. Të ndryshme.

Për të gjitha pikat ka pasur diskutime, por si pikë më me rëndësi dhe që ka pasur më shumë interesim ka qenë pika Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit, në këtë pikë gjithmonë ka raport të detajuar nga Komandanti i Policisë së Stacionit në Rahovec, ku njoftohen anëtarët e KKSB-së rreth situatës së sigurisë në Komunën e Rahovecit.

Konkluzion nga takimi i KKSB-së i datës 21.02.2022

Konkluzioni rreth pikës së dytë: I bëjë thirrje qytetarëve të pa vaksinuar që të vaksinohen, sepse ne si komunë i kemi të gjitha kushtet e përshtatshme që vaksinimi të vazhdoj.

Konkluzioni rreth pikës së tretë: Do të vazhdojmë me zgjerimin e projektit të kamerave të sigurisë, jemi të interesuar që këto kamera të instalohen në çdo fshat të komunës së Rahovecit.

Me instalimin e kamareve rastet janë duke u zbuluar, harroi të cekë komandanti se rreth 30 raste janë zbuluar kjo falë edhe ndihmës të kamerave, inkurajoj policin dhe organet komunale, poashtu edhe anëtarët e KKSB-së që ta risim angazhimin tonë në mënyrë që siguria e përgjithshme e jetës, pronës publike dhe private të jetë në nivelin e duhur.

Organet tona të mos bëjnë kompromise, por të zbatojnë rendin dhe ligjin në mënyrë që të kemi më shumë siguri për qytetarët tanë. Kalojmë në pikën e radhës



Pikat e rendit të ditës nga mbledhja e KKSB-së e mbajtur me 21.03.2022

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
6. Informatë rreth situatës së krijuar nga pandemia Covid – 19;
7. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit,
 - Trotualet, liri i tyre dhe shenjat sinjalizuese.
 - Qentë endacak.
 - Siguria në trafik,
 - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkollë dhe zbatimin e planit për siguri në shkollë,
 - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në komunën e Rahovecit,
8. Organizimi i takimit publik me qytetarët dhe kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane
9. Të ndryshme.

Konkluzion nga takimi i KKSBB-së i datës 21.03.2022

Konkluzioni rreth pikës së dytë: *Lusim qytetarët që të kenë ende kujdes sepse ende jemi në pandemi edhe pse janë zbutur masat, qytetarët të jenë të kujdesshëm në ato vende ku ka qarkullim të madh të njerëzve. Poashtu lusim qytetarët që të vazhdojnë me marrjen e vaksinës, gjithashtu ata që nuk kanë mundësi të lëvizin për arsye të sëmundjeve le të lajmërohen që të shkojë ekipi mobil tek shtëpitë e tyre.*

Konkluzioni rreth pikës së tretë: *Kërkesë për stacionin e policisë në Rahovec që ti shtojë patrullimet, poashtu qytetarët duhet të dinë se policia nuk jep dënime për ata që parkojnë në mënyrë të rregullt makinat. Trotualet dhe hapësirat publike të vazhdojnë të lirohen, nuk ka kompromise sa i përket kësaj teme. Anëtarët e KKSBB-së të japin kontributin e vetë në planin e ndërygjësimit dhe të vetëdijesimit të qytetarëve për gjërat negative.*

Në 11 lokacione që i ka përcaktuar drejtoria e shërbimeve publike janë 373 parkingje, këto parkingje do ja propozojmë kuvendit komunal dhe përmes një ankandi do ja japim ndonjë operatori në shfrytëzim.

Sa i përket pyetjes për DKA-në, besoj në mbledhjen e ardhshme do ta kemi në pikë sa i përket efikasitetit dhe punët e bëra nga ana e psikologëve dhe pedagogëve të angazhuar qoftë edhe me kontrata të përkohshme në shkollat e komunës sonë. Ne jemi të interesuar që ta risim numrin e psikologëve në shkollat që ta risim vetëdijësimin e nxënësve dhe të mos kemi fenomene në shkollat tona sa i përket drogës dhe veprimet që janë të ndaluara me ligje.



Pikat e rendit të ditës nga mbledhja e KKSBB-së e mbajtur me 19.05.2022

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;
 - Shqyrtimi i dukurive negative, me theks të veçantë trajtimi i objekteve jo të sigurta në Komunën e Rahovecit,
 - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla,
 - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit,
3. Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për parandalimin nga zjarri gjatë sezonit veror;
4. Identifikimi i çështjeve problematike që ndikojnë në sigurinë publike ndëretnike;
5. Të ndryshme.

Konkluzion nga takimi i KKSBB-së i datës 19.05.2022

Konkluzioni rreth pikës së dytë: *Gjendja e Sigurisë në Komunën e Rahovecit është e qetë dhe stabile, pa ndonjë incident i cili duhet veçuar.*

programet që ndikojnë në rritjen e sigurisë në shkolla nga ana e policisë do të vazhdojnë dhe do të ketë aktivitete të ndërthurura me organizata të tjera; S.H.L Kosova por edhe komuna do të bëjë punën e vet në bashkëpunim në mënyrë që të kemi siguri më të madhe nëpër shkolla.

Do të vazhdohet me instalimin e kamerave të sigurisë sepse janë një mekanizëm jashtëzakonisht i rëndësishëm që ndikojnë në rritjet e sigurisë në shkolla.

Konkluzioni rreth pikës së tretë: *Në bashkëpunim me drejtorinë, njësinë e zjarrfikësve dhe policinë do të përpiqemi të përballemi me këtë situatë në mënyrë më të suksesshme të mundshme, uroj të mos kemi zjarre. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim apo njësia e zjarrfikësve ka pajisje dhe përgatitje të mjaftueshme për përballje me zjarre.*



Pikat e rendit të ditës nga mbledhja e KKSBB-së e mbajtur me 05.07.2022

10. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
11. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;
 - Prishja e rendit publik nga lokalet e natës dhe personat e pandërgjegjshëm,
 - Masat e parandalimit të lëmsho kërkuësve,
 - Plani operativ për sezonin e pushimit të bashkatdhetarëve tanë dhe dasmave,
 - Siguria në Trafik,
 - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkollë dhe zbatimin e planit për siguri në shkollë,
 - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit,
12. Sensibilizimi i qytetarëve për rëndësinë dhe promovimin e bashkëpunimit ndëretnik, ndërfetarë dhe multi – kulturor.
13. Të ndryshme.

Konkluzion nga takimi i KKSBB-së i datës 05.07.2022

Konkluzioni rreth pikës së dytë: *Situata e sigurisë e cila është në zonën tonë të përgjegjësisë vlerësohet që është e qetë dhe stabile, pa ndonjë indikacion për prishje të qetësisë dhe ndonjë incidenti të mundshëm.*

Nuk do të lejojmë që lokalet e natës të vazhdojnë veprimtarin pas orës 23:00, është një vendim në fuqi, propozimi ka ardhur po nga ky këshill dhe duhet respektuar.

I bëjë thirrje qytetarëve të komunës së Rahovecit pa asnjë dallim që mos të keqpërdorin ujën e pijes në mënyrë që mos të kemi në kohë vape reduktive, të përdoret vetëm për qëllime të pijes e jo edhe për ujitje të kopshteve ose perimeve të ndryshme që i kanë nëpër kopshte të tyre.

Trotualet duhen të lirohen dhe do të lirohen shumë shpejtë sepse nuk bënë më të vazhdoj kështu, prandaj kërkoj nga policia dhe inspektorati të veprojnë edhe me gjopa në mënyrë që trotualet të jenë të lira. Ju falënderoj shumë, kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës.

Konkluzioni rreth pikës së dytë: *Komunën tonë shumica e madhe janë shqiptar, por ka edhe egjiptian, romë, ashkali dhe serb, ky është promovimi më i mirë në këtë mozaik dhe asnjëherë nuk e besoj që duhet të kemi probleme të natyrës ndëretnike, probleme të cilat kanë të bëjnë me aspektet kulturore edhe pse ka kultura të ndryshme por ne jemi qytetar, por edhe bashkëpunimi ndër fetar, ndërkulturor dhe ndëretnik besoj se të gjitha janë të pranishme në komunën tonë dhe nuk ka arsye që dikush këtë ta shoh ndryshe sepse çdo tentativë që mundohet të shoh ndryshe është jo reale.*

Munden të parashihen poashtu edhe aktivitete sportive, e mirëpresim edhe ndihmën e OSBE-së, si në futboll, basketboll krejt që është sportive, jam i pajtimit që ku dëshironi ju të zgjidhni vendin

dhe kohën ne do jemi aty me ju. Ne e kemi kuptuar shumë mirë promovimin, sensibilizimin dhe bashkëpunimin ndër- etnik me qytetarët e komunës sonë, këtë nuk ka nevojë askush të na tregoj ne jemi të vetëdijshëm për këtë.



Pikat e rendit të ditës nga mbledhja e KKSBB-së e mbajtur me 29.08.2022

14. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
15. Informatë rreth situatës së krijuar nga pandemia Covid – 19;
16. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit;
 - Prishja e qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e pa përgjegjshëm,
 - Trajtimi i mbrojtjes së pyjeve nga dëmtuesit ilegalë,
 - Vetëdijesimi nga minat dhe mjeteve të tjera të pashpërthyer nga lufta,
 - Identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevoja të veçanta,
 - Siguria në trafik,
 - Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje,
 - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në komunën e Rahovecit,
17. Informatë rreth përgatitjes së Festës së vjeljes së rrushit (Hardh Fest);
18. Të ndryshme.

Konkluzion nga takimi i KKSBB-së i datës 29.08.2022

Konkluzioni rreth pikës së dytë: *Situatës rreth pandemisë covid – 19, situata është e qetë dhe e menaxhueshme. Situata me pandeminë nuk e shohim si problem serioz tani pandeminë për shkak sigurisht që vaksinimi ka mundësuar që të kemi një organizëm më të përgatitur dhe t'a luftojmë virusin korona.*

Konkluzioni rreth pikës së tretë: *Gjendja e sigurisë në komunën tonë ka qenë stabile dhe mbetet stabile. Për t'a forcuar edhe më shumë sigurinë në komunën tonë duhet të angazhohemi me ekipet tona, në bashkëpunim me policinë dhe inspektoratin.*

Konkluzioni rreth pikës së katërt: *Policia e Kosovës duhet të përgatit një plan operativ që të shkoj gjithçka në rregull me datë 2,3,4 shtator sepse pritet të ketë shumë njerëz vendorë e ndërkombëtarë, ministra, deputetë, ambasadorë, diplomatë. Besoj që ne do t'i marrim të gjitha masat edhe si komunë që ngjarja të shkoj si është më së miri.*



Pikat e rendit të ditës nga mbledhja e KKSBB-së e mbajtur me 08.11.2022

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit,
 - Menaxhimi i parkingjeve në qytet dhe ndriçimit publik,
 - Lirimi i trotuareve dhe hapësirave publike,
3. Plani i kursimeve të energjisë elektrike dhe përdorimi i përgjegjshëm i lëndëve djegëse;
4. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla,
4. Të ndryshme.

Konkluzion nga takimi i KKSBB-së i datës 08.11.2022

Konkluzioni rreth pikës së dytë: Gjendja e sigurisë në komunën tonë është stabile dhe e qetë, përkundër faktit që ka sfida, shkelje të caktuara dhe probleme të ndryshme që ndodhin çdo ditë, por që janë të natyrave të lehta dhe të cilat nuk e cenojnë sigurinë në qytetin tonë.

Konkluzioni rreth pikës së tretë: Kursimi i energjisë është vendim i qeverisë me masa në fuqi sepse paraprakisht dihet se ka një krizë të thellë të energjisë – prodhim të energjisë e që është bërë krizë globale dhe ky vendim duhet të respektohet nga punonjësit të cilët punojnë në institucione shtetërore, apelojmë të gjithë qytetarët që maksimalisht të mundohen të kursejnë energjinë elektrike.

Rrjedhimisht një kursim i energjisë elektrike si masë efektive që mund ta zbus gjendjen e dimrit që po vjen. Duhet të shpërndahet fuqishëm ky mesazh që të kemi një përdorim sa më të arsyeshëm të lëndëve djegëse. Ne si komunë ndoshta do ta ndalim ndriçimin publik në ato zona ku nuk cenohet siguria.



Pikat e rendit të ditës nga mbledhja e KKSBB-së e mbajtur me 09.12.2022

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
6. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;
 - Vetëdijesimi për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike,
 - Menaxhimi i trafikut – parkingjeve në qytet dhe lirimi i trotuareve,
 - Mlikpritja e bashkatdhetarëve për festat e fundvitit,
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës së KKSBB-së për vitin 2023;
5. Të ndryshme.

Konkluzion nga takimi i KKSBB-së i datës 09.12.2022

Konkluzioni rreth pikës së dytë: *Ne jemi të bindur që zhvillimet dhe lajmet e fundit, nuk e cenojnë rendit kushtetues, sundimin e ligjit dhe sigurinë publike të qytetarëve të komunës së Rahovecit. Sipas përvojës që kemi, gjatë festave të fundvitit përdorimi i mjeteve piroteknike është evident. Komuna e Rahovecit do ta nxjerr një urdhëresë për mospërdorimin e mjeteve piroteknike në mjedise publike apo në hapësira ku mund ta prishin klimën publike.*

Situata e sigurisë, në zonën tonë të përgjegjësisë po e ritheksojmë edhe në këtë mbledhje që, është qetë dhe stabile pa ndonjë ndryshim të theksuar.

Konkluzioni rreth pikës së tretë: *Është miratuar Plani i Punës së Këshillit Komunal për Siguri për vitin 2023, nga anëtarët e këtij Këshilli, ku më pas ky plan do të shkoj për aprovim në Kuvendin Komunal.*


Skender Hamza
Koordinatori i KKSBB-së


Shafiq Latifi
Kryetari Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSIEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 92 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 29 Nr. i faq./Br.str./No.pp 97
Data/Datumi/Date 11 / 1 / 2017
RAHOVEC/ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13, nenit 14.1, nenit 17 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008"), nenit 74 paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit i:

PROPOZON

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik parcelën P-71510069-01240-0 në Zonën Kadastrale Retijë

1. Kryetari i Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit i propozon iniciimin e procedurës për shpalljen me interes të përgjithshëm publik parcelën P-71510069-01240-0 në Zonën Kadastrale Retijë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2312m² (dymijë e treqind e dymbëdhjetë metra katror) në vendin e quajtur Ispod sela-ura, me kulturë Kullosë e klasës 2, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të P.SH.E KOSOV.K.K.RAHOVEC-SHFRY.N.B.I.RAHOVECI.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës të cekur në pikën 1 të këtij propozimi do të jetë "Inicimi i procedurave për shpronësimin e parcelës".
3. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronave në Librin kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
4. Për zbatimin e këtij Propozimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
5. Ky propozim hyn në fuqi pas miratimit paraprak nga Kuvendi i Komunës.

Të njoftohen:

- Kuvendi i Komunës,
- Sekretaria e Kuvendit,
- Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësiror dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510069-01240-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	08-942/03-0001552/23
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	11.01.2023 - 08:18
Komuna / Opština / Municipality:	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Reliçe / Relimje / Relimje
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71510069-01240-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		2312			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
ISPOD SELA-URA				

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Superfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Kullësor/Pashnjac/Pasture	Kullësë E Klasës 2/Pasnjak 2 Klasse/2nd Class Pasture	2312

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licenç broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Postanski kod Postal code	Hollësi të c adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posëdm individual / Individualna Druzavina / Single possessor	P.S.H.E KOSOV/K.K.RAHOVEC- SHFRY.N.B.I.RAHOVECI	KCID1502325	RAHOVEC / ORALIOVAC / RAHOVEC /			1/1		



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Retijë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71510069-01240-0	Parcelë / Parcela / Parcel	2312



Shkalla/Razmera/Scale: 1:539

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 11.01.2023

Koha/ Vreme/ Time: 08:27:16

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Aprovoi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019"), nenit 17 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 00.01.2023 merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. Me këtë vendim formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 10 (dhjetë) vite të pronës së paluajtshme të komunës duke u bazuar në vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 191/21 i datës 29.04.2021 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës P-71510081-00251-0.
2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, si në vijim:
 - 2.1. _____, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
 - 2.2. _____, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
 - 2.3. _____, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
 - 2.4. _____, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
 - 2.5. _____, përfaqësues nga sektori joqeveritar.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 10 (dhjetë) vite të pronës së paluajtshme të komunës janë: shpallja e njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të përcaktoj çmimin fillestar, të caktojë kushtet dhe kriteret e ankandit publik etj.
4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.



5. Obligohet Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, ti zhvillojë procedurat e ankandit publikë dhe vlerësimin e ofertave.
6. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
7. Kuvendi i Komunës së Rahovecit e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdo herë që kërkohet.
8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Zyra e Prokurimit.
9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Komisionit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së dhe*
- *Arkivi*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr. ____/23
Datë: 00.01.2023

Defrim Kafexhiu

Kryesues i Kuvendit





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/191 Nr. ifaq./Br.str./No.pg 2

Data/Datum/Date 29 / 04 / 2021

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë:29.04.2021 merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës 02 Nr. 271/21 i datës 07.04.2021 dhe merret vendimit paraparak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.
2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, e cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është në zonën kadastrale Cifllak, në vendin e quajtur Mala – Shuma, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510081-00251-0 në emër të Komuna e Rahovecit, me kulturë Mal i Klasës 4, në sipërfaqe të përgjithshme prej 114230 m² (njëqind e katërmëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë metra katror).
2. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale dhe dhënia e mundësisë qytetarëve për zhvillimin dhe kultivimin e bujqësisë dhe blegtorisë si dhe dhënia e mundësisë qytetarëve të vetëpunësohen.
3. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatshkurtër në periudhën prej dhjet (10) vite.
4. Komuna e Rahovecit e ruan të drejtën kur do herë që sipas nevojës, për realizimin e interesave publike të Komunës të ndryshoj kontratën me përfituesin e pronës së dhënë në shfrytëzim.
5. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

6. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga komisioni vlerësues i ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01 Nr. 80/20 e datës 29.06.2020 për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit.
7. Obligohen Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë që të zhvilloj procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
8. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktoj me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
9. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.
10. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.

Vendimi u dërgohet:

- Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01 Nr.191/21
Me datë: 29.04.2021

